REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN
Nr. / Br. 6977/26
Nr. i fq. / Br. st. -1-
Data: / Datum: 13.02.2026
VUSHTRRI - VUČITRN

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova – Republic of Kosovo
**Komuna e Vushtrrisë**
Opština Vučitrn – Municipality of Vushtrri

**Kuvendi i Komunës**

**01 Nr. PB 28/26 13/02/2026**

Në bazë të nenit 43.1 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 28 paragrafi 1 i Statutit 01.Nr-209/22 të Komunës së Vushtrrisë dhe nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores për Punën e Kuvendit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë:

**Ju fton**

Të merrni pjesë në mbledhjen e Kuvendit të Komunës, e cila do të mbahet më datë **26 shkurt 2026 (e enjte), me fillim në ora 10:00.** Mbledhja do të mbahet në sallën e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë.

Për këtë mbledhje propozohet ky:

**R E N D D I T E**

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 29 janar 2026;
2. Informatë për gjendjen e sigurisë në Komunën e Vushtrrisë për vitin 2025;
3. Propozim – vendim për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit të kuvendit të komunës nr. 01.189/23, datë 28.07.2023;
4. Propozim–vendim për emërimin e delegatëve të Komunës së Vushtrrisë në Kuvendin e përgjithshëm të Asociacionit të Komunave të Kosovës.
5. Informatë për shërbimet shëndetësore për vitin 2025 në Komunën e Vushtrrisë;
6. Informatë lidhur me lejet ndërtimore, kushte ndërtimore dhe leje rrënimi për vitin 2025;
7. Raporti i sistemit të menaxhimit të performancës për vitin 2024.
8. Pyetje dhe përgjigje.

**Melihate Basholli-Latifi**

**Kryesuese e Kuvendit të Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS • KOMUNA E VUSHTRRISË • OPŠTINA VUČITRN • REPUBLIKA KOSOVA

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova – Republic of Kosovo
**Komuna e Vushtrrisë**
Opština Vučitrn – Municipality of Vushtrri

**Kuvendi i Komunës**

**01 Nr. PB-31/26 26.02.2026**

# P R O C E S V E R B A L
# NGA MBLEDHJA E RREGULLT E KUVENDIT TË KOMUNËS SË VUSHTRRISË, MBAJTUR MË: 29 JANAR 2025

*Mbledhja është mbajtur në sallën e "Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, duke filluar në orën* ***09:20.*** Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë: Behar Duraku, Berat Sadiku, Betim Grabanica, Blerina Shala, Diellza Pllana, Drita Dibrani, Edmond Hyseni, Fakete Dushi, Fatmire Cecelia, Fidan Bejta, Gentiana Rama, Gresa Muli, Hava Mlinaku, Isak Uka, Kushtrim Hyseni, Kushtrim Veseli, Leonora Gërguri, Lorik Maxhuni, Mek Selaci, Melihate Basholli Latifi, Mensur Kastrati, Mentor Ferizi, Nasuf Aliu, Pllumb Maliqi Ramadan Parduzi, Refik Maloku, Rrahim Ajeti, Stefan Markovic, Vlerë Tahiri, Xhon Gubetini dhe Ymer Haradinaj.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe Kryetari i komunës z. Ferit Idrizi, përfaqësuesit e MAPL-së, përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Melihate Basholli-Latifi, - Kryesuese e Kuvendit, e cila konstatoi se në sallë janë prezentë 31 anëtarë të kuvendit, kuorum i plotë për zhvillimin e punimeve të mbledhjes plenare dhe për marrje të vendimeve të plotfuqishme, andaj procedoi me rendin e ditës.

**Mentor Hasani, para kuvendit dha betimin duke u bërë anëtarë i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me të drejta të plota.**

**Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e kuvendit-**pasi konstatoi kuorumin, ceku se materialet për të gjitha pikat e rendit të ditës janë dorëzuar sipas afateve ligjore, kërkoj nga anëtari i kuvendit z. Ramadan Parduzi, që të prononcohet para kuvendit lidhur me pozitën e tij si anëtar i kuvendi, pasi që i njëjti ka dorëzuar një dorëheqje tek kryesuesja e kuvendit, nga pozita e anëtari të kuvendit, por që më pas ai nuk ka vazhduar me plotësimin e procedurës para KKZ-së për zëvendësimin e tij. Po ashtu ajo kërkoj nga të gjithë ata anëtarë të kuvendit që pozitat e tyre bien ndesh me ligjin dhe që kanë konflikt interesi që deklarohen se cilën nga pozita do ta mbajë ashtu që të shmanget konflikti i interesit, dhe njoftoj se për të gjitha këto përgjegjësin e mban secili që identifikohet se ka vepruar në kundërshtim me ligjin.
**Ramadan Parduzi, anëtar i kuvendit-**sqaroi se ai ka dorëzuar një dorëheqje tek kryesuesja e kuvendit, për arsye se nuk i është ruajtur vendi i punës aty ku aktualisht është duke punuar, në këtë rast njoftoi se është duke e pritur një përgjigje nga Drejtoria e Arsimit dhe nga institucionet qendrore, pasi ta merr këtë përgjigje atëherë konform rrethanave do të vendos se si do të veprojë.

**Leonora Gërguri, anëtare e kuvendit-**në fillim të diskutimit të saj përshëndeti drejtorët e rijnë të emëruar, duke ju dëshiruar suksese. Ajo shtoj se ekzekutivi në mandatin e kaluar, ka treguar suksese të dobët dhe si rezultat i kësaj nuk ka arritur asnjëherë të jetë përfitues i granit të performancës, prej të cilit komunat e tjera kanë fituar qindra mijëra euro. Po ashtu raportet e auditorit kanë qenë për çdo vit e më të këqija duke spikatur dhe duke u shtuar të gjeturat. Në qeverisjen e kaluar gati çdo i dyti apo i treti vendim janë kthyer nga MAPL si të kundërligjshme dhe me të njëjtin avaz ka filluar edhe ky mandat, ku në seancën e kaluar keni anuluar disa vendime të kuvendit për shkak të shkeljeve ligjore, ku edhe këtë seancë kemi disa vendime për t'i korrigjuar. Ngjashëm ka ndodhur edhe me buxhetin, ku është ndryshuar për secilën seancë të kuvendit dhe vitin që lëmë pas ai është aprovuar jashtë afatit ligjor, sepse nuk është sjellë në kuvend në muajin shtator siç parasheh ligji. Shpresoj që në këtë mandat Kryetari i Komunës dhe ekzekutivi i tij të reflektojnë dhe të punojnë më mirë.
**Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-**tha se, qeveria e re komunale është duke e u marrë me probleme të vjetra që i ka lënë qeveria e kaluar në gjysmë ose nuk është marrë fare me to. Ditëve të fundit kemi mjaft shumë ankesa nga qytetarët që lidhen me qeverisjen komunale. Kjo për faktin se shumica e lagjeve në qytet dhe fshatra nuk kanë ndriçim publik, kjo si pasojë e borxheve të shumta që ka komuna ndaj kompanisë KESCO dhe KEDS. Në bazë të informatave që i posedon komuna, këtyre kompanive iu ka rreth 100.000 € borxhe. Shumë fshatra të komunës kanë mungesë të ujit të pijes si Gracë, Druar, Sfaraçk, Stroc, Mihaliq, Gllavatin, Bivolak e shumë fshatra tjera. Punëtoret e NPL "Përparimi" të cilët punojnë në kushte të vështira, pagat e tyre të vogla i marrin me disa ditë vonesë, dhe për më tepër se gjatë muaj këtyre punëtorëve nuk iu është paguar trusti pensional. Kryetari i komunës dhe qeverisja e tij nuk kanë bërë pagesën e subvencioneve 6 centë për litër të qumështit për fermerët për vitet 2023,2024 dhe 2025, edhe pse këto kanë qenë të rregulluar me buxhetet e këtyre viteve, por një gjë e tillë nuk është bërë. Shumë mësimdhënës që punësohen për herë të parë ata punojnë për disa muaj pa i marrë pagat e tyre, nuk e dimë se cili është problemi po kemi ankesa të vazhdueshme nga këtë mësimdhënës. Qeveria e kaluar komunale nuk ka bërë pagesën e subvencioneve për fëmijët e porsalindur edhe pse edhe kjo çështje ka qenë e rregulluar me buxhetin e vitit 2025. Nuk keni bërë pagesën e këshillave lokalë. Prandaj për të gjitha këto mangësi dhe lëshime kërkoj që këto çështje të adresohen pasi që jemi në fillim të mandati. Ai konstatoj se të gjitha këto problem janë pasojë e keq menaxhimit dhe paaftësisë së kryetari të komunës dhe qeverisë së tij.
**Berat Sadiku, anëtar i kuvendit-**pasi i përshëndeti të pranishmit, deklaroi se në këtë seancë do të ishte mirë të jetë i pranishëm edhe Kryetari i Komunës, pasi kemi disa pyetje dhe tema për t'ia adresuar atij. Tutje shtoi se, është e papranueshme sjelljet dhe praktika që janë ndërtuar që nga viti 2021, kur po peshkohen disa asamblistë nga LDK dhe LVV, kjo është kontra-produktive dhe e dëmshme për zhvillimet demokratike në Komunën e Vushtrrisë. Për të gjitha këto pasojat do ti bartni vetë si pushtet dhe kjo do të ju hakmerret. Të gjitha këto shkarje dhe devijime të qëllimshme me ndërhyrje në propozime qoftë në KPF apo Komitet për Komunitete janë shumë të dëmshme dhe ne jemi kundër tyre. Si rezultat i këtyre devijimeve po ndodh që vetëm në seancën e kaluar patëm disa vendime që është dashur të anulohen e ngjashëm po ndodhë edhe këtë seancë, kjo po ndodh sepse nuk kemi koordinim mes qeverisë dhe kuvendit të komunës. Njëri ndër vendimet që është anuluar është edhe vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e lapidarit për dëshmorin Basri Beqiri, kur nëse është shikuar me kujdes del se MAPL nuk ka kërkuar që ky vendim të shfuqizohet dhe nuk e kupton se përse një vendim i tillë është sjellë për shfuqizim.
**Fatmire Cecelia, anëtare e kuvendit-** pasi i përshëndeti të pranishmit, ngriti shqetësimin e saj lidhur me punën e edukatoreve dhe mungesës së asistenteve për nxënësit me nevoja të veçanta. Më tej kërkoi nga drejtoresha e Arsimit që ta respektoj Udhëzimin Administrativë të nxjerr nga MASHT, që të gjitha edukatoret që janë me fakultet shtetëror duhet me qenë në shkolla publike

me jep mësim në shkolla, ndërsa ato që kanë përfunduar në fakultetet privat duhet të angazhohen në çerdhe. Ky është një diskriminim që po iu bëhet edukatoreve tash e disa vite. Kjo pyetje i adresohet direkt Drejtoreshës së Arsimit. Pastaj shtoi se një fëmijë në shkollën fillore “Naim Frashri” është përjashtuar nga shkolla me vendim të drejtoreshës, me arsyetimin se bënë zhurmë në procesin mësimor (fëmija është në grupin parashkollor dhe ky fëmijë është me nevoja të veçanta), ky veprim përpos që është i papranueshme është edhe i kundërligjshëm. Ajo paralajmëroi se këtë çështje do ta ngrit edhe në instancat tjera kompetente për të ndërmarr veprimet e nevojshme. Më tej vlerësoi se në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, u kërkua që bëhet ndryshimi i orarit të mbledhjes së kuvendit nga ora 10:00 në ora 9:00, për të qenë prezent Kryetari i Komunës dhe kryetari përsëri nuk është prezent.
**Fidan Bejta, anëtar i kuvendit-**pasi i përshëndeti gjithë të pranishmit ai uroj drejtoret që i kanë marrë pozitat e reja, duke ju dëshiruar suksese në punë! Në këtë kontekst vlerësoi se për gjitha punët e mira dhe në interes qytetarë do ta kenë përkrahjen gjithherë, ndërsa për punë jo të mira do të jenë përherë opozitë e fuqishme. Tutje shtoi se diskutimet e anëtarëve të kuvendit nuk duhet të jenë vetëm sa për thënë diçka, sepse Vushtrria vuan nga mungesa e njerëzve me ide të mira. Ai ftoj për bashkëpunim ndërpartiak duke ofruar më të mirën për qytetar dhe lënë me një anë simbolet partiake po duke ofrua gjithsecili ekspertizën e tij për interes kolektiv pa dallime partiake e politike.
**Gresa Muli, anëtare e kuvendit-** pasi i përshëndeti gjithë të pranishmit ajo uroj drejtorët që i kanë marrë pozitat dhe përgjegjësitë për ti drejtuar proceset. Më tej shtoi se sipas Statutit të Komunës, kuvendi është organi më i lartë i Komunës dhe përgjegjës duhet të jemi para këtij kuvendi, por kjo si duke nuk i bënë përshtypje disa prej drejtorëve, sepse prej 14 drejtori sa i ka komuna, sot i kemi prezent vetëm 7 prej tyre dhe kjo tregon seriozitetin e kësaj qeverie. Pastaj vlerësoi se është akoma më gabim që kryetari i komunës nuk merr pjesë në seancat e kuvendit, sidomos në pjesën paraprake të saj kur zhvillohen diskutimet e përgjithshme për t’i dëgjuar e shqyrtuar hallet e qytetarëve. Për më tepër është obligim i kryetarit të komunës që të prezantoj para kuvendit por edhe për qytetare kabinetin e tij qeveritar.
**Betim Grabanica, anëtar i kuvendit-**ngriti çështjen e thirrjeve publike për bujqit, ku ceku se Komuna e Vushtrrisë i ka 1530 fermerë dhe për këta fermerë është marr vendim nga kuvendit që të përkrahen me thirrej publike për vitin 2023, 2024 viti 2025 mungon. Ai pyeti se vendime e kuvendit a janë legjitime në raport me Kryetarin e Komunës dhe Drejtorinë e Bujqësisë lidhur me thirrjet dhe mbështetjen financiare për fermerët e komunës së Vushtrrisë. Kjo për faktin se është e pa tolerueshme dhe papranueshme të mos përkrahen këta fermer kur dihet fakti se Komuna e Vushtrrisë shquhet si komunë bujqësore. Ai bëri thirrej që të zbatohen vendimet e kuvendit për sa i përket mbështetjes për bujqit e Komunës së Vushtrrisë. Në fund ai kërkoj që të gjitha pronat publike të shfrytëzohen në të mirën e përgjithshme dhe jo për individ dhe biznese të caktuara.
**Ramadan Parduzi, anëtar i kuvendit-**kërkoj nga Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, që të rritet mbështetja financiare për sportin, sidomos për klubet e hendboll F dhe Klubi i Hendbolli M, të cilat dështuan si pasoj e mungesës së mjeteve financiare nga super liga në ligen e parë.
**Mek Selaci, anëtar i kuvendit-**shtroj çështjen e emërimeve në kabinetin qeveritar ku nga 14 drejtori sa ka Komuna e Vushtrrisë, kemi vetëm tri gra të emëruar, që në përqindje është vetëm 18%, dhe kjo pak sepse është dashur që minimum të jetë 50% kota gjinore.
**Refik Maloku, anëtar i kuvendit-**pyeti kryesuesen e kuvendit se kjo mbledhje e kuvendit a është duke u mbajtur në harmoni me ligjin për faktin se mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa është mbajtur vetëm dy ditë para seancës së Kuvendit.

Pas diktimeve, të anëtarëve të kuvendit, kuvendi pas votimit me 30 vota "për" aprovoj për rend dite kërkesën për rishqyrtimin e vendimit Nr.65277/25 i datës 30.12.2025 për themelimin e Komitetit për Komunitete.

**Pas shqyrtimit të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me vota "unanime", aprovoi këtë:**

## R E N D D I T E

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja inauguruese e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 12 dhjetor 2025;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e jashtëzakonshme e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 30 dhjetor 2025;
3. Raporti për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore, për vitin 2025;
4. Propozim-vendim për formimin e komisionit të aksionarëve në NPL. "Përparimi" në Vushtrri;
5. Propozim-vendim për formimin e komisionit të aksionarëve në KRM. "Uniteti" në Vushtrri;
6. Propozim-vendim për ndryshimin dhe plotësimin e tabelave buxhetore 4.1 dhe 4.2 të Buxhetit të Komunës së Vushtrrisë, për vitet 2026-2028;
7. Shqyrtimi dhe aprovimi i kërkesës për nismën e ndryshimit dhe plotësimit të Statutit të Komunës së Vushtrrisë;
8. Draft – Rregullore për Transparencë në Komunën e Vushtrrisë;
9. Draft – Plani i veprimit për transparencë komunale, 2026-2029;
10. Rishqyrtimi i vendimit Nr.65281/25 i datës 30.12.2025 për publikimin e listës së pronave të Komunës së Vushtrrisë për dhënin në shfrytëzim për vitin 2026;
11. Rishqyrtimi i vendimit Nr.65277/25 i datës 30.12.2025 për themelimin e Komitetit për Komunitete.
12. Pyetje dhe përgjigje.

**1.** Miratimi i procesverbalit nga mbledhja inauguruese e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 12 dhjetor 2025;

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi me vota "unanime" miratoi Procesverbalin nga mbledhja inauguruese e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 12 dhjetor 2025.**

**2.** Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e jashtëzakonshme e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 30 dhjetor 2025;

**Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-**diskutimi i tij u përqendrua tek procesverbali i komitetit dhe tek rekomandimet e mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa, konkretisht te pika e 4-të në procesverbal thuhet: *për këtë pikë të rendit të ditës KPF-ja rekomandoi: që të bëhet blerja e veturave për administratë komunale Vushtrri, ku projekti hynë në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, kurse mjetet financiare merren nga projektet me bashkëfinancim me donator në Drejtorinë e Bujqësisë, shuma prej 70.000 € nga granti qeveritar, ndërsa 10.000.00 € nga të hyrat vetnake të këtij projekti.* Ai pretendon se kjo pjesë e këtij diskutimi fare nuk është diskutuar dhe nuk qenë temë e debati, por kjo është shtuar qëllimisht nga ana e procesmbajtësit apo kryesueses së kuvendit.
**Isuf Jashari, drejtor i DBF-së-** konfirmoj se pretendimi i parafolësit nuk është i qëndrueshëm sepse ai rekomandim është diskutuar dhe ai mund të provohet edhe përmes audioincizimit.

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi me vota "unanime" miratoi Procesverbalin nga mbledhja e jashtëzakonshme e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 30 dhjetor 2025.**

**3.** Raporti për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore, për vitin 2025;

**Gresa Muli, anëtare e kuvendit-**deklaroi se nëse i referohemi raportit për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore, për vitin 2025, atëherë të krijohet përshtypja se gjithçka ka shkuar në rregull se fondet buxhetore janë shpenzuar në masën mbi 90% të tyre, ndërsa punët dhe projektet nuk janë përfunduar. Kjo argumentohet se trotuar i filluar tek fshati Sfarçak akoma nuk ka përfunduar, në ndërkohë përgjigja e komunës është se nuk kemi mjete financiare sepse ato i ka marrë përmbaruesi. Ajo vlerësoi se shumë mirë ka vepruar kryetari që e ka ndërruar Drejtorin e Bujqësisë, sepse ai drejtor që ishte mandatin që shkoj nuk ka pasur sukses, ndërsa presim që drejtori aktual të jetë më i suksesshëm, kur dihet edhe fakti se Vushtrria është vend bujqësor.
**Refik Maloku, anëtar i kuvendit-**tha se përveç se Drejtori i Financave është mjeshtër i kamuflimit të shifrave, ai ka filluar që edhe formatin e raporti ta zvogëloj ashtu që shifrat mos të shihen fare. Pastaj kërkoj sqarime lidhur me kodin buxhetor 13460 shërbime kontraktues tjera 4,13,497.00 € çka janë dedikuar këto mjete, kodi buxhetor 13509 pajisje tjera më pak se njëmijë euro vlera 94,380.00 €, çfarë është blerë më këto mjete, kodi buxhetor 14410 vlera 897,000 € vendime gjyqësore, prej tyre kodi 13200 vlera për vendim gjyqësore 251,000 € dhe kodi vlera 580,000.00 € për vendime gjyqësore dhe cili është sqarime për këto mjete financiare. Lidhur me mjetet për pagesën e mësueseve kërkoj që kjo të sjellët në mënyrë të deshifruar saktësisht duke e përcaktuar se sa mjete i kanë takuar avokati, përmbaruesit sa shpenzime të gjykatë dhe sa i kanë takuar vet mësimdhënësit. Pastaj tek bujqësia fondi me bashkëfinancim me donator vlera 1,120.000.00 €, por nuk e dimë se cilat projekte janë realizuar përmes këtij fondi. Tutje pyetje për Drejtorin e Urbanizmit, ku thuhet se për fshatrat Mihaliq, Druar, Reznik dhe Shallcë janë ndarë 10,000.00 € për asfaltimin e rrugëve, dhe pyetja është se sa metra asfalt janë shtuar me këto mjete financiare të ndara, dhe nga sa metra janë shtruar për secilin prej këtyre fshatrave të përmendura.
**Berat Sadiku, anëtar i kuvendit-**tha se referuar raporti duhet përgëzuar Drejtorinë e Urbanizimit, ku realizimi buxheti është 99.7%, gjë që nuk ka ndodhur asnjëherë mandateve të kaluara, sepse nga 2,500.000 € kanë shkuar në suficit vetëm 6000 € por këtu ka dyshime të bazuar se si janë shpenzuar këto mjete financiare, apo janë kryer pagesat pa u përfunduar punët për projektet që kanë qenë të planifikuara, në këtë drejtim duhet pasur kujdese që gjëra të tilla të mos na ndodhin komunës sonë.
**Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-**referuar raporti, mund të thuhet se shpenzimet janë realizuar por projektet dhe punët nuk janë kryer dhe kjo parqet shqetësim real. Këto shqetësime ai i ka ngritur edhe në mbledhjen e komiteti, dhe përgjigjja e Drejtori të Financave, ka qenë se buxheti është shpenzuar dhe projektet janë realizuar, dhe tani kanë mbetur vetëm ato projekte që janë dy dhe tri vjeçare. E vërteta natyrisht së është ndryshe për faktin se jemi dëshmitar që komuna ka dështuar të bëj pagesat e ndriçimit publik, mjete për fëmijët, ato për bujqit, nuk është përfunduar uji, rrugët, kanalizimi dhe shumë e shumë pagesa të tjera për projekte që kanë mbetur të pa përfunduara. Vërtet nëse shikohet shpenzimi i buxhetit atëherë të krijohet përshtypja se gjithçka ka shkuar për mrekulli sepse buxheti është shpenzuar por qytetarët nuk kanë përfituar sepse nuk janë kryer punët. Më tej u ndal tek furnizimi me lëndë djegëse-dru për shkolla vlera 147,811 € për vitin 2024, ndërsa për vitin 2025 207,000.00 € që i bie një dallim prej 60,000.00€, kjo si pasoj e blerjes së druve me çmim astronomik jashtëzakonisht i lartë. Tek mirëmbajtja e rrugëve lokale është ditur që kemi një planifikim të tillë sepse diku me një e diku me dy kamion është shpërndarë zhavorr për shtrim të rrugëve në këmbim të votave, dhe

pyeti se ku kanë shkuar mbi 541,000.00 € për mirëmbajtën e rrugëve lokale, duke sjell një raport të detajuar se cilat rrugë lokale janë shtruar me këto mjete. Sa i përket qirave nga 4400.00 € kemi rritjen në 26,688 € në vitin 2025. Ajo çka bënë përshtypje është fakti se qiraja tek rastet sociale 18,900 € në vitin 2024, në vitin 2025 janë vetëm 600€, a janë zvogëluar rastet sociale në Komunën e Vushtrrisë apo nuk janë paguar fare këto qira.
**Isuf Jashari, drejtor i DBF-së-**paraqiti sqarime të hollësishme lidhur me raportin për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore, për vitin 2025, duke u përgjigjur në çështjet e ngritura nga anëtarët e kuvendit. Ai njoftoj se edhe përkund vështirësive financiare për shkak të vendimeve gjyqësore përmbarimore, asnjë projekt nuk është ndal, dhe edhe ato projekte që kanë mbetur në gjysmë do të përfundohen gjatë këtij fiti fiskal. Tek kategoria mallra dhe shërbime obligimet kontraktuese, që pyeti anëtari i kuvendit z.Maloku, ai sqaroi se për këto kode funksionale, do të ofroj përgjigje me shkrim për faktin se në kuadër të kësaj janë realizuar një mori projektesh që ngërthejnë në vete shumë shifra dhe shënime. Sa i përket listës së vendimeve gjyqësore përmbarimore dhe shumave financiare ai kishte raportuar edhe vitin e kaluar. Këto lista dërgohen nga Departamenti i Thesarit nga Ministria e Financave dhe janë të parapara se mjete i takojnë mësimdhënësit, sa avokatit sa janë shpenzime përmbarimore dhe shpenzimet e gjykatës, këto shënime janë publike dhe legale, dhe për qasje në këto duhet të i drejtohesh me shkrim Drejtorisë së Financave të Komunës së Vushtrrisë.

**Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës kuvendit pas votimit me 21 vota "për" aprovoj Raportin për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore, për vitin 2025.**

**4.** Propozim-vendim për formimin e komisionit të aksionarëve në NPL. "Përparimi" në Vushtrri;

**Vlerë Tahiri, anëtare e kuvendit-** në emër të grupit kuvendar të PDK-së propozoi për anëtar të komisionit të aksionarëve në NPL. "Përparimi" në Vushtrri z. Mentor Ferizi.
**Fatmire Cecelia, anëtare e kuvendit-** në emër të grupit kuvendar të LVV-së propozoi për anëtar të komisionit të aksionarëve në NPL. "Përparimi" në Vushtrri z. Edmond Hyseni.
**Drita Dibrani, anëtare e kuvendit-** në emër të grupit kuvendar të LVV-së propozoi për anëtar të komisionit të aksionarëve në NPL. "Përparimi" në Vushtrri z. Mek Selaci.

Pas propozimeve, kryesuesja e kuvendit në mënyrë individuale i hodhi në votim propozime-emrat për anëtarë të komisionit të aksionarëve në NPL. "Përparimi" në Vushtrri,

Nga votimi rezulton me sa vijon:

Mentor Ferizi mori 22 vota "për"
Edmond Hyseni mori 18 vota "për"
Mek Selaci mori 8 vota "për"

**Lidhur me këtë pikët të rendit të ditës u vendos me sa vijon:**

**1.** Me këtë vendim emërohen anëtarët e Komisionit Komunal të Aksionarëve në NPL "Përparimi" SH.A në Vushtrri, si në vijim:

**1.1** Mentor Ferizi, anëtar i Kuvendit të Komunës;
**1.2** Edmond Hyseni, anëtar i Kuvendit të Komunës.

**2.** Komisioni Komunal i Aksionarëve do të i ushtroj detyrat dhe përgjegjësitë e tij në pajtim me dispozitat e Ligjit në fuqi për Ndërmarrjet Publike si dhe Statutin e NPL "Përparimi" në Vushtrri.

**3.** Mandati i Komisionit Komunal të Aksionarëve është i njëjtë me mandatin e tanishëm të kuvendit të Komunës.

**4.** Ky vendim hynë në fuqi tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) dite pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**5.** Propozim-vendim për formimin e komisionit të aksionarëve në KRM. "Uniteti" në Vushtrri;

**Vlerë Tahiri, anëtare e kuvendit-** në emër të grupit kuvendar të PDK-së propozoi për anëtar të komisionit të aksionarëve në KRM. "Uniteti" në Vushtrri z. Mentor Hasani.
**Refik Maloku, anëtar i kuvendit-** në emër të grupit kuvendar të LVV-së propozoi për anëtare të komisionit të aksionarëve në NPL. "Përparimi" në Vushtrri znj. Drita Dibrani.
**Berat Sadiku, anëtar i kuvendit-** në emër të grupit kuvendar të LDK-së propozoi për anëtar të komisionit të aksionarëve në KRM. "Uniteti" në Vushtrri z. Isak Uka.

Pas propozimeve, kryesuesja e kuvendit në mënyrë individuale i hodhi në votim propozime-emrat për anëtarë të komisionit të aksionarëve në KRM. "Uniteti" në Vushtrri,

Nga votimi rezulton me sa vijon:

Mentor Hasani mori 29 vota "për" 1 votë "abstenim"
Drita Dibrani mori 8 vota "për"
Isak Uka mori 19 vota "për"

**Lidhur me këtë pikët të rendit të ditës u vendos me sa vijon:**

**1.** Me këtë vendim emërohen anëtarët e Komisionit Komunal të Aksionarëve në KRM "Uniteti" SH.A Mitrovica në Mitrovicë, si në vijim:

**1.1** Mentor Hasani, anëtar i Kuvendit të Komunës
**1.2** Isak Uka, anëtar i Kuvendit të Komunës

**2.** Komisioni Komunal i Aksionarëve do të i ushtroj detyrat dhe përgjegjësitë e tij në pajtim me dispozitat e Ligjit në fuqi për Ndërmarrjet Publike si dhe Statutin e NPL "Përparimi" në Vushtrri.

**3.** Mandati i Komisionit Komunal të Aksionarëve është i njëjtë me mandatin e tanishëm të kuvendit të Komunës.

**4.** Ky vendim hynë në fuqi tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) dite pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**6.** Propozim-vendim për ndryshimin dhe plotësimin e tabelave buxhetore 4.1 dhe 4.2 të Buxhetit të Komunës së Vushtrrisë për vitet 2026-2028;

**Isuf Jashari, drejtor i DBF-së-** paraqiti sqarime të hollësishme lidhur me Propozim-vendimin për ndryshimin dhe plotësimin e tabelave buxhetore 4.1 dhe 4.2 të Buxhetit të Komunës së Vushtrrisë për vitet 2026-2028, duke shtuar se në totalitet kategoritë ekonomike në shumat komunaltive nuk ndryshohet por vetëm bëhet ndryshimi dhe harmonizimi i tabelave buxhetore në kontekst të disa projekteve siç edhe janë cekur në propozim-vendim, me theks të veçantë ndërtimi i shtëpisë për të moshuarit. Pastaj sqaroi se në propozim-vendim në mënyrë tekstuale, janë prezantuar shumta e mjeteve financiare, kodet dhe drejtoritë se ku do të merren mjete për financimin e projektit <ndërtimi i shtëpisë për të moshuarit>, nga granit qeveritar dhe nga të hyrat vetanake por edhe për projekt tjera. Po ashtu ai sqaroi se ndryshimet konsistojnë edhe në një projekt të ri <blerja e një automjeti të ri, mjetet merren nga fondi me bashkëfinancim me donator, 70.000.00 € nga granti qeveritar, dhe 10.000.00 € nga të hyrat vetnake shuma totale 80.000.00 € baret në tabelën 4.2 Drejtorinë e Shërbimeve Publike>.
**Fatmire Cecelia, anëtare e kuvendit-**deklaroi se i ka krahasuar tabelat buxhetore nga buxheti i komunës që është aprovuar më datën 30.10.2025, dhe ato që tani janë sjell sot në kuvend për ndryshim dhe plotësim. Tutje shtoj se komuna nuk ka buxhet më shumë se sa është ndarë sipas qarkores buxhetor, dhe nuk mund të marrim më shumë buxhet për t'i prishur kornizat aktuale buxhetore. Secilin projekt që e keni propozuar për ndryshim e ka analizuar dhe krejt kjo është bërë me qëllim që të financohen dy apo tri projekte. Ajo njoftoj se edhe në muajin nëntor kishte deklaruar se jeni duke vepruar gabim dhe pikërisht për këtë ka ndodhur që është kthyer buxheti nga ana e ministrisë sepse nuk keni vepruar sipas afateve ligjore. Tani prapë ka mundësi që ky vendim por edhe buxheti për vitin 2026 të kthehet si paligjshëm dhe komuna jonë do të rrezikonte të futej në kolaps financiar. Pastaj shtoi se u përmend këtu rr. "Lidhja e Lezhës" por për këtë projekt nuk është paraparë fare buxhet as për vitin 2026 dhe as për vitin 2027. Më tej shtoj se nuk qëndron konstatimi se Ministria e Financave e ka detyruar komunë për inicimin e zhvillimit të projektit <ndërtimi i shtëpisë për komunitetin e të moshuarve>, dhe vlerësoi se ministria mund të rekomandoj por as si ajo nuk mund ta detyroj komunën për ndonjë projekt. Lidhur me projektin ndërtimi i stacionit të autobusëve, kërkoj të bëhet e ditur se ku e ka caktuar komuna lokacionin për ndërtimin e këtij stacioni, e po ashtu ku dhe kur do të ndërtohet shtëpia e komuniteti për të moshuarit, e që për ne ky projekt është tepër i mirëseardhur.
**Berat Sadiku, anëtar i kuvendit-**tha se sa i përket tabelave 4.1 dhe 4.2 dhe shpjegimeve që i dha Drejtori i Financave jemi dakord. Por ajo çka nuk pajtohen është mënyra se si është bërë planifikimi i këtyre projekteve, sepse nëse i shohim projekt nga fusha e planifikimi shumica e tyre është dashur të përfundojnë maksimumi brenda afatit prej tri viteve, ndërsa ne kemi projekt siç është ndërtimi i rrugës "Bekim Berisha-Abeja" që është viti i katër që ky projekt planifikohet në buxhet dhe akoma nuk ka përfunduar, vlera 194,000.00 € e planifikuar për vitin 2026, pastaj është rr."Lumni Surdulli" vlera e planifikuar 72,000.00 €, ajo çka është shqetësues është rikonstruktimi i bulevardit "Adem Jashari" dhe shfrytëzimi i parkut të qytetit për zgjerimin e këtij sheshi dhe për këtë pyeti se si është menduar lidhja e parkut të qytetit me bulevardin "Adem Jashari". Kjo për faktin se Komuna e Vushtrrisë zyrtarisht ka 61,000.00 banorë, dhe ka vetëm një parak të vetëm dhe jemi dëshmitar se me projektin rikonstruktimi i bulevardit "Adem Jashari" e ka marr rreth 30% edhe parkun e qyteti si parka i vetëm në Vushtrri. Kjo është jashtëzakonisht e dëmshme, për faktin se ne duhet të tentojmë të kemi sa më shumë hapësira të gjelbëruara brenda hapësirave urbane dhe kjo nuk i kontribuon kësaj. Projekti rikonstruktimi i bulevardit "Adem Jashari" ka kushtuar mbi 3 milion euro, ndërsa për vitin 2026 janë planifikuar 1.7000.00 €, që është një vlerë alarmante, prandaj pyeti se si do të sigurohen këto mjete, kur dihet se Komuna e Vushtrrisë është në borxhe jashtëzakonisht të mëdha. Po ashtu shqetësues është edhe planifikimi i mjeteve për rrugët Smrkomicë, Dobërlluk, Banjësk, vlera vetë prej 40,000.00 €, ndërsa vetëm për fshatin Prelluzhë dhe Gracë janë planifikuar mbi 750,000.00 €.

**Ramadan Parduzi, anëtar i kuvendit-**tha se nuk është planifikuar asnjë mjetë financiar për rr. "Jeton Tërsten" ku ajo rrugë ka nevojë për një trotuar, por edhe disa mermetime tjera që janë shumë të nevojshme.
**Leonora Gërguri, anëtare e kuvendit-**deklaroi se fakti që ne po merremi me buxhet në janar të vitit 2026, kur buxheti është dashur të përfundoj në shtator të viti 2025, kjo tregon për aftësinë e kësaj qeverie komunale për ti shtyrë proceset përpara. Pastaj pyeti Drejtorin e Financave se sa është shuma e mjeteve financiare që janë marrë për vendim gjyqësore nga investimet kapitale dhe a janë përfshirë në buxhetin e këtij viti këto mjete, nëse po në cilat projekte janë bartur mjetet, pasi që kjo është dashur të sqarohet tek tabela 4.2 kategoria investimet kapitale-shpalosja e buxhetit.
**Ferit Idrizi, kryetar i komunës-**duke ju adresuar qytetarëve të komunës dhe anëtarëve të kuvendit, paraqiti sqarime për anëtarë e kuvendit ku ndër të tjera deklaroi: se për të gjitha projekte fillimisht planifikohet buxheti e më pas nisin procedurat tjera për zhvillimin e tyre. Në këtë kontekst shtoj se për projektin ndërtimi i stacionit të autobusëve në njërën nga seancat e ardhshme do të vjen propozimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e stacionit të autobusëve. Më tej shtjelloj se me Agjencinë e Pronave ka qenë në vizitë dhe ka diskutuar, për fillimin e procedurave për shpronësim të parcelave ku do të ndërtohet stacioni i autobusëve dhe shtëpia për të moshuarit. Lidhur me disa projekte tjera si rrugët: "Lumni Surdulli", Rr. "Bekim Berisha-Abeja", por edhe projekti rikonstruktimi i bulevardit "Adem Jashari, ku u përmendin disa shifra, por e vërteta është se shumë mjetet financiare i janë marrë komunës së Vushtrrisë me proceduar përmbarimore vetëm në vitin 2025 na janë marrë afër 3.5 milion euro, që në substancë e ka dëmtuar komunën dhe zhvillimin e projekteve. Prandaj planifikim i buxhetit për këto projekt është bërë për faktin se operatoret ekonomik i kanë kryer punët por pagesat nuk i'u bërë. Sa i përket parkut të qytetit, ceku se sheshi i qytetit ka qenë i ndarë me një rrugë dhe ne atë rrugë e kemi mbyll, pjesa ku ka qenë shtatorja e "Adem Jasharit" në pjesën harkore nuk është prekur asgjë, në anën e majtë është zgjatur pak për shkak të parkingut nëntokësor, por mundem me matë saktësisht këtë përqindje do të dalin shumë më të vogla sepse 30% është përqindje shumë e madhe dhe nuk beson se del në realitet, por vetëm mund të flasim me hamendësime. Në pyetjen se si do të bëhet lidhja mes bulevardit "Adem Jashari, dhe parkut të qytetit, ceku se lidhja është bërë përmes shkallëve është ndërtuar edhe sheshi dhe do të vazhdohet edhe me rikonstruktimin e pjesës tjetër të sheshit të qytetit. Ai vlerësoi se më punën që është bërë në parkun e qytetit mund të thuhet se për herë të parë ai park është bërë i shfrytëzueshëm. Lidhur me rr. "Jeton Tërsten" ka kërkuar nga kompani për hartimin e projekteve që të hartoj një projekt ngjashëm sikurse në rr."Lumni Surdulli" për rregullimin dhe zgjerimin e asaj rruge. Lidhur me trotuarin në Nedakoc, ceku se ai trotuar është dashur të përfundoj, por kanë qenë disa problem me operatorin kontraktues por shpreson se posaçërisht do të merret me këtë problematikë.
**Berat Sadiku, anëtar i kuvendit-**pyeti se kontrata për rregullimin e parkut të qytetit a është pjesë e kontratës për rikonstruktimin dhe ndërtimin e bulevardit "Adem Jashari" apo është lidhur kontratë e re. Më tej shtoj se shfrytëzimi i hapësirës së parkut për parking nëntokësor dhe ndërtimi i vetë këtij parkingu në fillim të sheshit dhe në qendër të qyteti në aspektin e planifikimit urbanë është gabim, sepse garazhet nëntokësore zakonisht bëhen në periferi të qytetit. Kjo u dëshmua gjatë muajve të verës kur patëm fluks të bashkatdhetarëve kur kishim bllokim të rrugëve në qendër të qytetit. Sa i përket stacionit të autobusëve tha se ju përgëzoj për iniciativën, dhe sugjeroi që fillimisht të bëhet një studim i fizibilitetit për këtë projekt e më tej të vazhdohet me caktimin e lokacionit.

**Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës kuvendit pas votimit me 20 vota "për" vendosi me sa vijon:**

**1.** Me këtë vendim ndryshohen dhe plotësohen tabelat buxhetore 4.1 dhe 4.2 të buxhetit të Komunës së Vushtrrisë për vitet 2026-2028 në kategoritë si në vijim:

**1.1** Në kategorinë investime kapitale, nga këto projekte, në drejtoritë:

**Drejtoria për Shërbime Publike, Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim**

- Ndërtimi i kanalizimeve në Vushtrri, Samadrexhë, Maxhunaj, Stanoc - shuma totale nga granti qeveritar është 120.000.00€. Nga kjo shumë barten 20.000.00€.

**Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural**

- Projektet në bashkëfinancim me donatorë - shuma totale e projektit është 768.796.00€. Nga kjo shumë barten 30.000.00€ nga granti qeveritar.
-

**Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit**

- Ndërtimi i rr. "2 Maji" me infrastrukturë përcjellëse - shuma totale e projektit është 200.000.00€, nga kjo shumë barten 20.000.00€ nga granti qeveritar.

- Ndërtimi i rrugëve lokale në Dumnicë, Maxhunaj, Stanoc , Lumadh, Vilanc, Ropicë, Pestovë - shuma totale e projektit është 317.700.00€, nga kjo shumë barten 40.000.00€ nga granti qeveritar.

- Ndërtimi i rrugëve lokale në Gracë, Prelluzhë - shuma totale e projektit është 120.000.00€, nga kjo shumë barten 40.000.00€ nga granti qeveritar.

- Rindërtimi dhe zgjerimi i rrugëve me infrastrukturë përcjellëse (Rr."Bahri Kuqi", Smrekonicë, Dobërllukë, Maxhunaj, Sllatinë, Pasomë, Shtitaricë, Dolak, Vërnicë, Nadakoc, Pestovë, Bukosh - shuma totale e projektit është 120.000.00€, nga kjo shumë barten 75.000.00€ nga granti qeveritar.

- Rindërtimi dhe zgjerimi i rr. Lidhja e Lezhës dhe infrastrukturë përcjellës - shuma totale e projektit është 20.000.00€, nga kjo shumë barten 15.000.00€ nga granti qeveritar.

**Drejtoria për Arsim (Arsimi Fillor)**

- Ndërtimi i shkollës fillore e SHFMU "Emin Duraku" - shuma totale e projektit është 20.000.00€, nga kjo shumë barten 10.000.00€ nga granti qeveritar.

- Ndërtimi i çerdheve (Qytet, Lumadh, Smrekonicë, Maxhunaj, Bukosh, Pestovë) - shuma totale e projektit është 20.000.00€, nga kjo shumë barten 10.000.00€ nga granti qeveritar.

- Ndërtimi i shkollës fillore SHFMU "7 Marsi" Bukosh - shuma totale e projektit është 20.000.00€, nga kjo shumë barten 10.000.00€ nga granti qeveritar.

**2.** Shuma totale e mjeteve të bartura nga projektet e sipërcekura është 270.000.00€, mjete financiare të cilat barten për financimin e projekteve: Rehabilitimi i rrugëve në Smrekonicë, Dobërllukë, Sllatinë, Pasomë (Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit) – 40.000.00€, si dhe projekti: Ndërtimi i shtëpisë të komunitetit për të moshuar (Shërbimet rezidenciale) – 230.000.00€.

**3.** Nga tabela 4.1 – kategoria e pagave, mallra dhe shërbime, komunali, subvencione, harmonizimi është bërë sipas vendimit për aprovimin e buxhetit për vitet 2026-2028.

**4.** Në kategorinë e subvencioneve dhe transfereve projekti: Renovimi, izolimi, fasadimi, rikonstruimi i çative dhe bodrumeve të objekteve kolektive dhe komunale shuma 2.715.335.29 €, në vitin 2026 shuma 1.357.667.65 €.

**5.** Për zbatimin e këtij vendimi obligohet: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe drejtoritë tjera kompetente komunale.

**6.** Pjesë përbërëse të këtij vendimi janë tabela 4.1 dhe 4.2, të cilat janë aprovuar në kuadër të vendimit për aprovimin e buxhetit të komunës për vitet 2026-2028.

**7.** Ky vendim hynë në fuqi tridhjetë (30) ditë pas protokollimit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**7.** Shqyrtimi dhe aprovimi i kërkesës për nismën e ndryshimit dhe plotësimit të Statutit të Komunës së Vushtrrisë;

**Refik Maloku, anëtar i kuvendit-**pyeti se cila është arsyeja dhe cila është nevoja për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës së Vushtrrisë, kur dihet fakti se statuti aktual është miratuar para 3 viteve dhe kjo është një kohë relativisht e shkurtër për të ndryshuar sërish. Kërkoj të di se si është ideuar të bëhen ndryshime para se të votohet.
**Ferit Idrizi, kryetar i komunës-**tha se për shkak të dinamikës dhe ndryshimi të rrethanave dhe disa ligjeve, ka lindur nevoja për ndryshimin dhe plotësimin e dokumentit kryesor Statutit të komunës. Ai njoftoi se do të ndryshohen edhe një mori e rregulloreve komunale me qëllim që ato t'i përshtaten nevojave të qytetarëve. Ai shtoj se pasi të themelohet komisioni do të filloj punën dhe do të sjellë një draft të plotësim-ndryshimit dhe më pas do të pasojnë edhe ndryshimet tjera të rregulloreve komunale.

**Lidhur me kërkesën për nismën e ndryshimit dhe plotësimit të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, kuvendi pas votimit me 30 vota "për" vendosi me sa vijon:**

**1.** Me këtë vendim miratohet nisma e Kryetarit të komunës për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës së Vushtrrisë 01Nr. 209/22, i miratuar më datë 06.09.2022.

**2.** Tekstin e ndryshim-plotësimeve të Statutit të komunës do ta përgatitë komisioni, i themeluar me vendim të Kuvendit të komunës.

**3.** Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: anëtarët e Komisionit për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës së Vushtrrisë.

**4.** Ky vendim hynë në fuqi tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) dite pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Në kuadër të kësaj pike të rendit të ditës u formua komisioni për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës, kuvendi pas votimit me 30 vota "për" vendosi me sa vijon:**

**1.** Me këtë vendim formohet komisioni për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës së Vushtrrisë në këtë përbërje:

**1.1. Rrahim Ajeti, anëtar i Kuvendit (PDK);**
**1.2. Refik Maloku, anëtar i Kuvendit (LVV);**
**1.3 Betim Grabanica, anëtar i Kuvendit (LDK);**
**1.4 Fatime Haziri, (Zyra Ligjore e Komunës) dhe**
**1.5 Edona Pushkolli, (Zyra Ligjore e Komunës).**

**2.** Për zbatimin e këtij vendimi obligohet komisioni i cekur në pikën 1 të këtij vendimi, i cili ka për obligim që t'i hartojë ndryshimet statutare dhe të njëjtat duhet t'ia ofrojë Kuvendit të komunës për aprovim.

**3.** Komisioni i cekur në pikën 1 të këtij vendimi ka për detyrë të mbajë takime, dhe në përbërjen e tij duhet të zgjedh kryesuesin e komisionit dhe procesmbajtësin, ashtu që të evidentojë ndryshim-plotësimet e dispozitave statutare dhe të përgatitë draftin <Propozim-ndryshimet e Statutit bazë të Komunës së Vushtrrisë>.

**4.** Ky vendim hynë në fuqi tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) dite pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**8.** Draft – Rregullore për Transparencë në Komunën e Vushtrrisë;

**Lidhur me këtë pike të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me 28 vota "për" 1 votë "kundër" aprovoj Rregulloren për Transparencë në Komunën e Vushtrrisë.**

**9.** Draft – Plani i veprimit për transparencë komunale 2026-2029;

**Lidhur me këtë pike të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me 28 vota "për" 2 vota "abstenim" vendosi me sa vijon:**

**1.** Me këtë vendim aprovohet Plani për Transparencë Komunale në Komunën e Vushtrrisë për periudhën 2026-2029.

**2.** Qëllimi i aprovimit të këtij plani është konsolidimi i infrastrukturës juridike me qëllim të arritjes së objektivave të transparencës të administratës të Komunës së Vushtrrisë.

**3.** Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kuvndi i Komunës, Kryetari i Komunës dhe drejtoritë komunale në Komunën e Vushtrrisë.

**4.** Pjesë përbërëse e këtij vendimi është dokumenti me emërtimin Plani për Transparencë Komunale në Komunën e Vushtrrisë për periudhën 2026-2029.

**5.** Ky vendim hynë në fuqi tridhjetë (30) ditë pas protokollimit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**10.** Rishqyrtimi i vendimit Nr.65281/25 i datës 30.12.2025 për publikimin e listës së pronave të Komunës së Vushtrrisë për dhënin në shfrytëzim për vitin 2026;

**Refik Maloku, anëtar i kuvendit-**tha se kur është aprovuar rendi i ditës nuk është përmendur fare kjo pikë e rendit të ditës që lidhet me rishqyrtimin e vendimit Nr.65281/25 i datës 30.12.2025 për publikimin e listës së pronave të Komunës së Vushtrrisë për dhënin në shfrytëzim për vitin 2026, dhe kjo mund të konstatohet edhe nga video-incizimi i seancës së kuvendit i cili mund të rishikohet. Me fjalë tjera kjo pikë e rendit të ditës fare nuk është përmendur dhe votuar dhe si tillë konsiderohet se nuk ka hi në rendin e ditës.
**Melihate Basholli-Latifi, Kryesuese e Kuvendit-**deklaroi duke arsyetuar, se kjo pikë e rendi të ditës që lidhet me rishqyrtimin e vendimit Nr.65281/25 i datës 30.12.2025 për publikimin e listës së pronave të Komunës së Vushtrrisë për dhënin në shfrytëzim për vitin 2026, është proceduar si pikë e rregullt e rendit të ditës, dhe se e njëjta është trajtuar nga ana e Komitetit për Politikë dhe Financa, dhe është rekomanduar të procedohet për shqyrtim dhe aprovim në kuvendin e komunës, dhe kësisoj është dërguar edhe materiali në kopje fizik dhe elektronike. Fakti se kjo pikë nuk u përmend fare është sepse kjo pikë është proceduar si pikë e rregullt e rendit të ditës, jo sikurse është rasti me Rishqyrtimi i vendimit Nr.65277/25 i datës 30.12.2025 për themelimin e Komitetit për Komunitete, pikë kjo e cila ka ardhur pas është mbajtur mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe ajo është dashur të votohet në formë të veçantë. Duke u nisur nga këto premisa dhe konsideron se kjo pikë duhet të shqyrtohet dhe aprovohet sepse duhet të respektohet afati ligjor 30 ditor për rishqyrtimin e saj sipas vlerësimeve të MAPL-së.
**Fatmire Cecelia, anëtare e kuvendit-** tha se pak më herët kur e patë një pyetje një nga anëtarët e kuvendit, kryesuesja e kuvendit deklaroi se materiali në KPF ju ka ardhur me kohë dhe materiali për seancë të rregullt ju ka ardhur shumë më përpara, po ajo i rikujtoj kryesuese së kuvendit që kjo lista komplet kjo pikë ka ardhur në KPF aty për aty në tavolinë nuk ka ardhur më herët, kështu që s'ka ardhur as në emali 7 dite pune siç parashihet me ligj. Lista ka ardhur në KPF aty për aty e para, e dyta me plotësimet që kanë ardhur me numër të parcelave dallon lista e pronave mes afateve prej kur është mbajtur mbledhje e KPF-së deri tek seanca e kuvendit, kjo i bie se i kemi dy lloj të listave të pronave. Po ashtu kemi shkelje të afateve ligjore sepse MAPL-ka kërkuar respektim të afatit ligjor sepse këtu është cekur saktë që duhet brenda afatit ligjor në muajin dhjetor deri me 31 dhjetor me dalë këto prona në shfrytëzim me dal si thirrje në afat ligjor deri në përfundim të vitit kalendarik nuk ka ndodh kjo prapë i keni sjell me vonës për shkak që ju janë kthyer nga MAPL-ja me vendim dhe arsyetimin e keni të qarte të gjithë d.m.th nuk e keni pasur në KPF pjesën e parcelave kështu që është mirë me kompletuar lëndën me sjell për aprovim në kuvend për shkak se edhe ashtu jeni vonë ka kaluar afati. Prandaj kjo pikë të shtyjmë edhe 2-3 jave mos ta kthej prapë MAPL-ja sepse nuk është e kompletuar, sepse tani kanë ardhur parcelat tash në këtë mbledhje.
**Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e kuvendit-** ta kemi parasysh secilin diskutim po e marr si të mirëqenë për me hedh në sipërfaqe qysh duhet vazhduar, ju lutem nuk ka ardhur me herët

sepse është pikë e rendit të ditës e cila është shqyrtuar në mbledhjen paraprake të kuvendit, mandej është kthyer në atë kohë menjëherë si është kthyer ne e kemi sjell në KPF, prandaj s'kemi pasur mundësi të veprojmë më herëte pa pasur përgjigje nga MAPL. Megjithatë prej KPF-së ka hy drejtpërdrejt në kuvend dhe tjetra është afati ligjor që ne nuk mundemi me tejkaluar përtej 30 ditësh. Kështu konsideroj që kjo përmes KPF-së është proceduar dhe nuk është hera e parë që kemi vepruar kësisoj, si rekomandim është në rend dite. Ky është një vendim që duhet të rishqyrtohet që është kthyer është diskutuar një here në kuvend është në tjetër nivel kjo kërkesë. Është diskutuar në seancën paraprak të kuvendin dhe është ardhur pak para mbledhjes së KPF-së dhe menjëherë e kemi sjell për rishqyrtim në po atë mbledhje të ashtu që mos ta lëshojmë afatin 30 ditor që është obligim për të vepruar dhe ndërmarrë veprime.
**Nasuf Aliu, anëtar i kuvendit**- pyeti se të gjitha këto prona që janë në këtë listë a janë të pastra në aspektin juridik? Kjo e konteston komplet çështjen p.sh po flas për zonën kadastrale në Terllabuq ku është një padi e datës 2 mars 2022 dhe është në procedurë gjyqësore për ato parcela. Seanca e parë është mbajtur para dy javësh, dhe ato parcela krejt janë në procedurë kontestimore gjyqësore. Ato parcela sot i ke në listën që janë sjell para anëtarëve të kuvendit. Anëtarët e kuvendit nuk guxojnë me votuar ose me i dhënë në shfrytëzim parcela të cilat janë në kontest gjyqësorë.
**Bedri Dobra, drejtor i DGJKP-së-** pasi i përshëndeti të pranishmit deklaroi: shpresoj që këto 4 vite kemi me kaluar mirë së bashku dhe transparent çdo gjë. Sa i përket listës se pronave kjo liste është votuar ne vitin e kalur ne seancën e pare, e njëjta listë është prapë kjo listë është votuar njëherë MAPL-ja e ka kthyer vetëm me i bë plotësimet të kolonave afatet, destinimin, sips Planit Zhvillimor Komunal janë në përputhje periudhën e këto për shkak të afatit ligjor që është kthyer prej MAPL-se, propozuesi ato vërejtjet që janë ardhur prej MAPL-së i ka plotësuar dhe i ka dorëzuar përmes KPF-se dhe janë ardhur këtu. Sa i përket kontesteve ju keni mundur kur i keni votuar herën e parë i keni pas në gjeoportal secili ku është me numër me të gjitha ato janë bërë vërejtjet, kjo është votuar njëherë , nuk me është dhënë mundësia të hulumtoj dhe me shikuar edhe për shkak të afatit kohor dhe për shkak që është votuar njëherë, në këtë pike kemi vetëm plotësime , plotësime MAPL-ja çfarë ka kërkuar ajo nuk ka thënë të largohen kjo pronë ose të lihet në listë kjo pronë, vetëm të plotësohen ato vërejtje çfarë i ka dhen ato janë plotësuar, kur të vijmë në hapin e dytë që e ceket që është kontest këto lista vetëm janë të propozuara kur të vjen koha për shpallje atëherë ne duhet me pas kujdes secilën prone veç e veç kur t'i qesim në shpallje në ankand publik ofertat ato që shkojnë përmes ligjit atëherë ne i ndalim edhe pse janë votuar ne jemi të vetëdijshëm që nuk e shtyjmë procesin me përpara mirëpo kjo është një listë e votuar, vetëm a janë plotësuar kriteret të cilat i ka kërkuar MAPL-ja , ku të gjitha në periudhën e fundit , për çka përdoret afati kohor, është fat që këto kanë kërkuar për Plan Zhvillimore besoj që këtë vit shumë shpejt edhe Plani Zhvillimor është në proces e sipër të përfundimit, dhe dhënia e këtyre pronave në shfrytëzim dhe investimet do të bëhen konform këtij plani.
**Fatmire Cecelia, anëtare e kuvendit-** kemi një mos përputhje tek tabelat, neve na ka ardhur diçka tjetër në KPF ndërsa këtu na ka ardhur, krejt diçka tjetër dhe nuk e di tash gjithë këto parcela nëse i ka komuna e Vushtrrisë, unë me të vërtet jam shumë e lumtur nëse i ka gjithë këto parcela Komuna e Vushtrrisë për t'i dhënë në shfrytëzim. Ndërsa këtu kemi keqkuptime dhe lajthitje të qëllimshme. Ne e kemi miratuar vetëm këtë liste. Në këtë listë janë vetëm dy prona në komunën e Vushtrrisë. Çuditërisht këto dy prona që jepen në shfrytëzim në komunën e Vushtrrisë janë për 99 vite edhe janë vetëm pronat në Stanoc d.m.th në Lumnadh dhe në Stanoc janë për 99 vite, tri prona në Stanoc, një në Lumardh, Smrekonice, Gllavotin dhe

Vushtrri janë për 99 vite. Ndërsa të gjitha pronat tjera që janë në këtë listë në fshatrat si: Studime, Prelluzhë, Ceceli, Bukosh, Gumnishtë të gjitha të tjerat janë për 25 vite. Këtu janë vetëm 51 prona të cilat i keni sjell në kuadër të kësaj liste, 3 prona në Stanoc të Poshtëm, Smrekonicë 2 prona, Gllavatin 2 prona, 1 pronë në Lumadh, 3 në Studime dhe 2 në Vushtrri, por kjo prapë nuk po përputhet me këtë që është dërguar neve në KPF është miratuar në KPF ,është aprovuar një listë tjetër ndërsa një liste tjetër na ka ardhur sot në mbledhjen e kuvendit. A ka mundësi vetëm me i bë të qartë ashtu që me i bë bashkë këto dhe me i sjellë të gjitha në një vend për aprovim. Këtë listën që e ke sjellë drejtor përmes emalit është dashur që ligjërisht të aprovohet para datës 31 dhjetor të vitit paraprak për vitin vijues.
**Leonora Gërguri, anëtare e kuvendit-**tha se sipas diskutimit të Drejtorit të Pronës, i cili deklaroi e meqë kjo pikë është kthyer nga MAPL-ja atëherë ne mund ta aprovojmë shpejt e shpjet pa përfillur procedurat ligjore, por kjo çështje nuk mund të bëhet kështu. Pastaj këtu e njëjta po shënon kërkesë për rishqyrtimin e vendimit, që tregon se kjo pikë duhet të i nënshtrohet një rivotimi për ta korrigjuar e që rrjedhimisht edhe duhet të jetë në rendin e ditës, përmes votimit të saj, gjë që nuk ndodhu kur u aprovua rendi i ditës. Kjo është dashur të bëhet ose kur është aprovuar rendi i ditës ose si pikë shtesë por që kështu nuk u vepruar dhe konsiderojmë se kjo pikë nuk është futur fare në rendin e ditës.
**Melihate Basholli-Latifi, Kryesuese e Kuvendit-**tha se dallimi mes këtyre pikave mes asaj për rishqyrtimin e vendimit për Komitetin për Komunitete dhe listës së pronave është fakti se kjo e fundit ka kaluar në mbledhjen e KPF-së dhe e kemi proceduar për kuvend si pikë e rregullt. Më tej vlerësoi se pas këtyre gjitha diskutimeve, ka dy rrugë të cilat duhet t'i ndjek për ta përfunduar këtë çështje. Ky material është i harmonizuar me dispozitat e legjislacionit në fuqi ashtu siç ka kërkuar Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal. Dhe konsideroj se më që ka kaluar nga komiteti tek kuvendi si pikë e rregullt në rend dite, prandaj nuk ka pasur nevojë të votohet. Andaj mund ta procedojmë në këtë mënyrë dhe mori përsipër që të hartoj një shkresë përcjellëse njoftues lidhur me procedurën e votimit dhe aprovimit të kësaj pike të rendit të ditës.
**Refik Maloku, anëtar i kuvendit-**tha se kjo pikë e rendit të ditë nuk është për tu shqyrtuar sot në këtë mbledhje sepse e njëjta nuk e ka asnjë element që është futur si pikë e rendit të ditës, as nuk është dorëzuar si pikë me rendin e ditës e as që është votuar kjo pikë për të qenë pjesë e rendit të ditës.
**Vlerë Tahiri, anëtare e kuvendit-**tha se sipas propozimeve dhe rekomandimeve të Komitetit për Politikë dhe Financa, pika gjashtë, shqyrtimi i këtij vendimi i datës 30.12.2025 për publikimin e listës së pronave të Komunës së Vushtrrisë për dhënin në shfrytëzim për vitin 2026, KPF-ja ka rekomanduar që kjo pikë të procedohet për kuvend për shqyrtim në mbledhjen e radhës. Duke marrë për bazë rekomandimet e cekur grupi kuvendar i PDK-së mendon se duhet të vazhdohet me shqyrtimin dhe aprovimin e kësaj pike të rendit të ditës sipas vlerësimeve të dhëna nga MAPL-ja.
**Kushtrim Veseli, anëtar i kuvendit-**tha se nëse kjo pikë e rendit të ditës është diskutuar dhe rekomanduar nga Komitetit për Politikë dhe Financa, atëherë mendon se kjo çështje duhet të shqyrtohet dhe aprovohet në këtë mbledhje sepse janë afate ligjore që e kërkojnë një gjë të tillë. Duke marrë për bazë që është interes i komunës që këto prona të publikohen atëherë duhet vazhduar me shqyrtimin dhe aprovimin e kësaj pike të rendit të ditës.
**Refik Maloku, anëtar i kuvendit-**tha se për këtë pikë që jemi duke diskutuar akoma nuk po e dimë a është në rendin e ditës dhe për këtë duhet një konstatim nga kryesuesja e kuvendit se kjo pikë a është në rendin e ditës apo jo. Nëse konstatohet se kjo pikë është në rendin e ditës atëherë vazhdojmë me diskutim dhe në fund me votim.
**Berat Sadiku, anëtar i kuvendit-**tha se në numër rendor 52 Parcela kadastrale P-06003-0 sipërfaqe 30.24 ha, gjendet përballë kalasë, nuk e kemi të qartë cilën pjesë e përfshinë pjesën

tek banesat e kuqe, nuk e dimë se çfarë kemi me dhënë në shfrytëzim aty. Njëjtë është gjendja edhe në fshatin Lumadh, tek zona ekonomike P-435-2 sipërfaqe 2000$m^2$ , nuk kemi mundur të gjejmë se ku gjendet kjo pronë. Më tej pyeti për parcelat në fshatrat Studime e Poshtme dhe Gumnishtë. Lidhur me këtë ceku se për projekte që janë në mirë të përgjithshme të gjithë do t'i përkrahim pa rezervë dhe pyeti si disa parcela në ZK-Studime e Poshtme me sipërfaqe të përgjithshme prej 112 hektar tokë, çfarë do të bëhet me këto prona dhe cili është interesi që këto prona të jepen në shfrytëzim çfarë përfiton komuna, a do të ketë ndonjë investitor. Ngjashëm është gjendja edhe tek ZK-Gumnishtë ku janë pesë parcela kadastrale me sipërfaqe të përgjithshme prej 155 hektar tokë, për këto duhet të ketë transparencë, cilat do të jenë investimet, a do të ketë ndërtime dhe për çfarë destinimi do të jepen në shfrytëzim këto prona. **Ferit Idrizi, kryetar i komunës-**tha se fillimisht publikim i listës së pronave për dhënien në shfrytëzim është obligim ligjor që derivon nga ligji. Ky proces përmes një vendim të kuvendit ka për qëllim mundësin potenciale për zhvillim ekonomik, ku komuna do të shikoj këto mundësi për ta dhënë në shfrytëzim pronën e saj për nevoja e biznes dhe për ta maksimizuar vlerën e saj dhe për të dhënë mundësi zhvillimit ekonomik të komunës. Ai ceku dhe njoftoj se ky proces është transparent dhe nuk e favorizon askënd sepse i njëjti do t'i nënshtrohet konkurrencës dhe apriori nuk dihet se kusht do të jetë përfitues i pronës për zhvillim ekonomik.

**Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës kuvendit pas votimit me 15 vota "për" 14 vota "kundër" vendosi me sa vijon:**

**1.** Me këtë vendim aprovohet propozimi i Kryetarit të Komunës së Vushtrrisë për publikimin e Listës së pronave të Komunës së Vushtrrisë për dhënien në shfrytëzim për vitin 2026.

**2.** Pronat e përshkruara në listë mund të jepen në shfrytëzim vetëm pas plotësimit të kushteve ligjore dhe planifikimit në bazë të Planit Zhvillimor Komunal dhe dokumenteve të tjera të planifikimit.

**3.** Me qëllim të nxitjes të zhvillimit ekonomik, rritjen e vlerës së pronës si dhe shtimin e vendeve të punës në harmoni me planifikimet e komunës, Komuna e Vushtrrisë në të ardhmen planifikon të jep në shfrytëzim pronën e komunës dhe në varësi nga interesi publik të zhvillon procedurat për dhënien në shfrytëzim të pronës së komunës.

**4.** Pjesë përbërëse e këtij vendimi është lista e pronave të Komunës së Vushtrrisë për dhënien në shfrytëzim për vitin 2026.

**5.** Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i Komunës si dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.

**11.** Rishqyrtimi i vendimit Nr.65277/25 i datës 30.12.2025 për themelimin e Komitetit për Komunitete.

**Melihate Basholli-Latifi, Kryesuese e Kuvendit-**tha se kjo pikë e rendit të ditës është kthyer nga MAPL, sepse sipas dispozitave ligjore nuk është respektuar kuota gjinore dhe po ashtu nga ministria është kërkuar që përbërja shumicë e komitetit për komunitet duhet të jetë nga anëtarë e kuvendit. Më që është kështu bazuar edhe në dispozitat e statutit të komunës së Vushtrrisë, ku përcaktohet se numri i anëtarëve të kuvendit duhet të jetë 9 anëtarë propozoi që të rritet numri i anëtarëve nga 7 anëtarë në 9, sipas statutit të komunës. Prandaj përbërja e komitetit do të jetë dy anëtarë nga PDK-ja, nga një anëtar LVV-ja LDK-ja, Nisma Socialdemokrate një anëtar, kurse katër anëtarë do të jenë nga komunitetet pakicë.

**Vlerë Tahiri, anëtare e kuvendit-** në emër të grupit kuvendar të PDK-së propozoi për anëtar të Komitetit për Komunitete z. Behar Duraku.
**Xhon Gubetini, anëtar i kuvendit-**propozoi për anëtar të të Komitetit për Komunitete z. Mentor Hasani.

Pas propozimeve, kryesuesja e kuvendit i hodhi në votim propozime-emrat për anëtarë të Komitetit për Komunitet Behar Duraku dhe Mentor Hasani morën 17 vota "për" duke bërë anëtarë të Komitetit për Komunitete.

**Fatmire Cecelia, anëtare e kuvendit-** në emër të grupit kuvendar të LVV-së propozoi për anëtare të Komitetit për Komunitete znj. Gresa Muli dhe vlerësoi se si grup i dytë në kuvend për nga fuqia e votës i takojnë dy pozita në Komitetin për Komunitete.

Pas votimit znj. Gresa Muli, mori 27 vota "për" duke u bërë anëtare e Komitetit për Komunitete.

**Berat Sadiku, anëtar i kuvendit-** në emër të grupit kuvendar të LDK-së propozoi për anëtar të Komitetit për Komunitete z. Isak Uka. Ai konsideron se si grup kuvendar iu takojnë dy pozita në Komitetin për Komunitete.
**Gentiana Rama, anëtare e kuvendit-**propozoi për anëtare të Komitetit për Komunitete znj.Fakete Dushi nga radhët e LDK-së.

Pas këtyre propozimeve, kryesuesja e kuvendit i hodhi në votim propozime-emrat për anëtarë të Komitetit për Komunitet z. Isak Uka mori 14 vota "për", Fakete Dushi mori 15 vota "për" duke bërë anëtarë të Komitetit për Komunitete, nga radhët e LDK-së.

**Kushtrim Veseli, anëtar i kuvendit-** propozoi për anëtare të Komitetit për Komunitete znj.Diellza Pllana nga radhët e Nismës Socialdemokrate.

Pos votimi anëtarja e kuvendit znj. Diellza Pllana nga radhët e Nismës Socialdemokrate, mori 19 vota "për" duke bërë anëtarë të Komitetit për Komunitete.

**Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës kuvendit pas votimit me 22 vota "për" 5 vota "kundër" dhe 2 vota "abstenim" vendosi me sa vijon:**

**1.** Me këtë vendim themelohet Komiteti për Komunitete, i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, në këtë përbërje:

**1.1 Behar Duraku, anëtar i Kuvendit të Komunës;**
**1.2 Mentor Hasani, anëtar i Kuvendit të Komunës;**
**1.3 Gresa Muli, anëtare e Kuvendit të Komunës;**
**1.4 Fakete Dushi, anëtare e Kuvendit të Komunës;**
**1.5 Diellza Pllana, anëtare e Kuvendit të Komunës;**
**1.6 Miljan Bojković, përfaqësues i komunitetit serb;**
**1.7 Fahrije Burgazi, përfaqësuese e komunitetit rom;**
**1.8 Adem Hoti, përfaqësues i komunitetit ashkali;**
**1.9 Berat Maloku, përfaqësues i komunitetit turk.**

**2.** Komiteti për Komunitete, detyrat dhe përgjegjësitë do t'i ushtrojë në pajtim me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Udhëzimin Administrativ për Procedurën e Themelimit

Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve të Përhershme dhe Komiteteve tjera Komunë, Statutin e komunës, akteve tjera si dhe rregulloren e punës.

**3.** Mandati i anëtarëve të Komitetit për Komunitete është i njëjtë me mandatin e anëtarëve të Kuvendit të komunës, përveç nëse ky mandat i pushon në rastet e parapara me legjislacionin në fuqi.

**4.** Zgjedhja e Kryesuesit të Komitetit për Komunitete bëhet në mbledhjen e parë të komitetit, me shumicën e votave të anëtarëve të Komitetit për Komunitete.

**5.** Kryesuesi i Komitetit për Komunitete zgjedhet nga radhët e komuniteteve joshumicë.

**6.** Anëtarët e Komitetit për Komunitete, për pjesëmarrje në mbledhje do të kompensohen në bazë të legjislacionit në fuqi në Kosovë.

**7.** Për zbatimin e këtij vendimi obligohen anëtarët e Komitetit për Komunitete si dhe Zyra për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore.

**8.** Ky vendim hynë në fuqi tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) dite pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Mbledhja u ndërpre në ora 12:15**

| | |
|---|---|
| **Bastri Duraku** | **Melihate Basholli-Latifi** |
| ____________ | ________________________ |
| **Procesmbajtës** | **Kryesuese e Kuvendit** |

**MEMORANDUM ZYRTAR - SLUZBENI MEMORANDUM - OFFICIAL MEMORANDUM**

| | | | |
|---|---|---|---|
| **PËR:**<br>**ZA:**<br>**TO:** | Z.nj Melihate Basholli/Latifi<br>Kryesuese e kuvendit komunal Vushtrri | **Data:**<br>**Datum:**<br>**Date:** | 10.02.2026 |
| **PËRMES:**<br>**PREKO:**<br>**THROUGH** | Direkt | **Nr. i Referencës:**<br>**Br. Referencije:**<br>**Reference No:** | 05-03-02/VSH-K / 12/ 25 |
| **PREJ:**<br>**OD:**<br>**FROM:** | Kapiten Reshat Kovaçi<br>Komandant i Stacionit<br>Stacioni Policor Vushtrri | | |
| **LËNDA:**<br>**PREDMET:**<br>**SUBJECT:** | Informatë mbi gjendjen e sigurisë në zonën e pëgjegjesisë së komunës së Vushtrrisë për vitiin 2025 | | |

## E nderuar Kryesuese, znj. Basholli/Latifi,

Në vijim ju paraqesim informatën lidhur me gjendjen e sigurisë në zonën e përgjegjësisë së Stacionit Policor Vushtrri për vitin 2025.

---

## Gjendja e përgjithshme e sigurisë

Gjatë gjithë vitit 2025, situata e sigurisë në zonën e përgjegjësisë së Stacionit Policor Vushtrri ka qenë e mirë dhe e qëndrueshme. Policia e Kosovës ka arritur që disa nga shqetësimet më serioze t'i minimizojë përmes masave konkrete hetimore dhe operative, duke i orientuar rastet drejt procedurave ligjore efikase dhe duke parandaluar incidente më të mëdha ndërmjet disa familjeve në zonën tonë të përgjegjësisë.

Gjatë këtij viti janë regjistruar dy raste të vrasjes. Natyra e këtyre rasteve ka qenë e vështirë për t'u parandaluar, pasi Policia nuk ka pasur informacione paraprake. Pavarësisht kësaj, Stacioni Policor Vushtrri ka vazhduar të jetë aktiv në parandalimin dhe hetimin e rasteve, duke e përmbyllur vitin me rezultate të kënaqshme në trajtimin e incidenteve të raportuara.



Adresa: Rr. „Bedri Pejani" pn. 42000 Vushtrri, Kosovë
Stacioni Policor Vushtrri, Mitrovicë

## Statistikat e përgjithshme të incidenteve

Gjatë vitit 2025 janë raportuar gjithsej **1098 raste**, që paraqet një **ulje prej 4.3%** krahasuar me vitin 2024. Në tabelën e mëposhtme paraqitet krahasimi i përgjithshëm i rasteve ndërmjet viteve 2024 dhe 2025, ndërsa tabela e dytë pasqyron veprat dhe incidentet më serioze dhe më të shpeshta për vitin 2025.

| | 2024 | 2025 | Te transferuara ne njësi tjera | Përqindja krahasuese | Zbulueshmëria e përgjithshme |
|---|---|---|---|---|---|
| Raste | 1194 | 1098 | 52 | -4.3% | 75.6% |
| Vepra penale | 810 | 685 | 49 | -15.4% | 70.1% |
| Incidente | 337 | 413 | 3 | 22.6% | 84.1% |

| Vepra/ incidenti | 2024 | 2025 |
|---|---|---|
| Vrasje | 0 | 2 |
| Tentim Vrasje | 3 | 4 |
| Dhuna ne familje | 104 | 95 |
| Lëndim i rend trupor | 4 | 10 |
| Lëndim i lehte trupor | 138 | 106 |
| Kanosja | 86 | 69 |
| Sulmi | 37 | 40 |
| Dhunim | 1 | 1 |
| Sulmi Seksual | 2 | 1 |
| Posedim i paautorizuar i narkotikeve dhe substancave psikotropike ose analoge | 41 | 24 |
| Vjedhje e rende | 59 | 50 |
| Vjedhje | 87 | 83 |
| Zjarrëvënia | 10 | 5 |
| Vjedhje e pyllit | 7 | 6 |
| Shkaktim i rrezikut te përgjithshëm | 24 | 13 |
| Mbajtja në pronësi, kontroll, ose posedim të paautorizuar të armëve | 69 | 56 |
| Përdorimi i armës | 24 | 26 |
| Aksidente me fatalitet | 6 | 2 |
| Aksidente trafiku me lëndime | 124 | 137 |
| Aksidente me dema materiale | 178 | 248 |



Adresa: Rr. „Bedri Pejani" pn. 42000 Vushtrri, Kosovë
Stacioni Policor Vushtrri, Mitrovicë

## Masat e ndërmarra

Stacioni Policor Vushtrri gjatë vitit 2025 ka zbatuar gjithsej **30 plane operative** në fusha të ndryshme të sigurisë, duke përfshirë parandalimin dhe zbulimin e veprave penale, luftimin e narkotikëve dhe vjedhjeve, sigurinë në trafik, parandalimin e aksidenteve të trafikut, sigurinë në shkolla, si dhe sigurinë në sheshe gjatë sezonit veror dhe në prag të festave.

Gjatë këtij viti janë menaxhuar me sukses **katër procese zgjedhore**, përfshirë edhe balotazhin gjatë zgjedhjeve lokale, duke kontribuar ndjeshëm në mbarëvajtjen e këtyre proceseve demokratike.

Në përgjithësi, Stacioni Policor ka realizuar një numër të konsiderueshëm arrestimesh, konfiskimesh të armëve dhe municioneve, pika kontrolli, patrullime me automjete dhe patrullime këmbësore, si dhe asistime për gjykatat, komunën, përmbaruesit, KEDS-in, kompaninë e ujësjellësit dhe institucione të tjera.

Trafiku në përgjithësi është zhvilluar pa pengesa të mëdha, pavarësisht punimeve në rrugë dhe sheshe në qytet dhe rrethinë. Megjithatë, problematika e parkimeve të parregullta vazhdon të mbetet shqetësuese, pavarësisht angazhimit të Policisë. Gjatë vitit 2025 janë shqiptuar **7136 gjoba në trafik**, rreth **5.6% më shumë** krahasuar me vitin 2024.

Bashkëpunimi me qytetarët dhe institucionet, veçanërisht me Komunën dhe institucionet arsimore, ka qenë i vazhdueshëm dhe konstruktiv.

Gjithashtu janë realizuar **19 fushata vetëdijësuese** në parandalimin e dhunës në familje, përdorimit të narkotikëve, ngacmimeve të ndryshme, sigurisë në trafik, parandalim te zjarreve .

Siguria në shkolla ka qenë prioritet i vazhdueshëm. Viti shkollor është përmbyllur pa probleme shqetësuese, falë planeve operative për sigurimin e perimetrit të shkollave dhe mbajtjes së ligjëratave edukative në tema të ndryshme, gjithsej **2588 orë mësimore** në shkollat fillore dhe të mesme të qytetit.

## Rekomandime

Angazhimi i Kuvendit dhe Qeverisë Komunale për funksionalizimin e sistemit të kamerave të sigurisë në qytet, gjë që do të lehtësonte ndjeshëm punën e Policisë.
Vazhdimi i punës në krijimin e hapësirave të reja për parkim, riorientimi i rrugëve të qytetit dhe vendosja e pengesave fizike për të parandaluar parkimin e automjeteve në trotuare.

## Përfundim

Stacioni Policor Vushtrri do të vazhdojë angazhimin në të gjitha fushat e sigurisë edhe gjatë vitit 2026, me theks të veçantë në punën proaktive dhe në rritjen e bashkëpunimit me institucionet lokale.

**Me respekt,**
Kapiten Reshat Kovaçi
Komandant i Stacionit Policor Vushtrri

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova – Republic of Kosovo
**Komuna e Vushtrrisë**
Opština Vučitrn – Municipality of Vushtrri

**Kuvendi i Komunës**

**Për: KPF-në dhe Kuvendin e Komunës**

**Propozues: Kryetari i Komunës z.Ferit Idrizi** ____________

**Hartues:Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, Drejtori z. Lorik Maxhuni** ______

**Çështja për trajtim: Propozim-vendim**

Në bazë të nenit 12.2 "d" të Ligjit nr. 03/L-40/2008 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 4, 5, 6, dhe 21 pika 1.1 të Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr.06/L-092, nenit 25 të Rregullores (QRK) për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Ligjin Nr.04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, Planin Zhvillimor Komunal të Komunës të Vushtrrisë dhe nenit 19 paragrafi 2 pika 1.4 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e rregullt mbajtur më __________ **2026,** merr këtë:

**V E N D I M**
**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMIT TË KUVENDIT TË KOMUNËS NR.01.189/23DATË 28.07.2023**

**1.** Me këtë vendim ndryshohet dhe plotësohet pika 1 e vendimit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me numër të protokollit **Nr.01.189/23 i datës 28.07.2023 për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës,** Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës, që lidhet me financimin e projektit për ndërtimin e parkingut nëntokësor dhe zgjerimi i hapësirave të shërbimit të emergjencës për nevoja të spitalit të Vushtrrisë në Komunën e Vushtrrisë, ndërsa ndryshimet bëhen si në vijim:

**1.1.** Dhënia e pronës komunale parcela kadastrale P-70202016-02358-7 me sipërfaqe prej 7380 m2 ZK – Vushtrri pronë e Komunës së Vushtrrisë e evidentuar në emër PSH. Shtëpi e Shëndetit jepet në shfrytëzim Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës në afat prej **40** viteve, me qëllim të realizimit të projektit ndërtimi dhe zgjerimi i hapësirave të reja spitalore për nevoja të Spitalit "Sheikh Zayed" në Vushtrri.

**1.2.** Në kuadër të pikës 1 të vendimit bazë bëhet ristrukturimi i projekti, ku nuk parashihet ndërtimi i parkingut nëntokësor, por vetëm bëhet zgjerimi i hapësirave të reja spitalore për nevoja të Spitalit "Sheikh Zayed" në Vushtrri.

**2.** Pikat të tjera të vendimit bazë Nr.01.189/23 i datës 28.07.2023 mbeten të pandryshuara.

**3.** Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria e Shëndetësisë dhe Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë.

**4.** Ky vendim hynë në fuqi tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Melihate Basholli-Latifi**

___________________________

**Kryesuese e Kuvendit**

# Arsyetim

Bazuar në kërkesën e Spitalit "Sheikh Zayed", lidhur me zgjatjen e afatit për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, sqarojmë se investitori deri më tani ka qenë i angazhuar në përgatitjen e projektit dhe në sigurimin e fondeve. Për këtë arsye, afati i dhënë prej tre (3) vitesh është afër skadimit dhe Spitali "Sheikh Zayed" kërkon zgjatjen e tij, me qëllim të fillimit të realizimit të punimeve të projektit.

Ndryshimet në vendimin bazë konsistojnë në zgjatjen e afatit të dhënies së pronës në shfrytëzim, si dhe në ristrukturimin e projektit në aspektin ndërtimor.

Duke u mbështetur në dispozitat e Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, i propozohet Kuvendit Komunal që ta aprovojë këtë propozim vendim, ashtu siç është paraqitur në dispozitivin e tij.

**Vushtrri 06.02.2026**

**Lorik Maxhuni**

_______________________

**Drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë**
**dhe Përkujdesjes Sociale**

Republika e Kosovës

Komuna Vushtrri

**Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale**

| | |
|---|---|
| PËR/ZA/TO: | **Komitetin për Politikë dhe Financa – Kuvendin Komunal** |
| NGA /OD/FROM | **Z. Lorik Maxhuni, Drejtor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale** |
| PËRMES: | **Kryetarit të Komunës z. Ferit Idrizi** |
| TEMA/SUBKJEKAT/SUBJECT | **PROPOZIM VENDIM PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMIT TË KUVENDIT TË KOMUNËS NR.01.189/23DATË 28.07.2023** |
| DATË/DATUM/DATE | **06.02.2026** |

Të nderuar,

Ky propozim vendim ka për qëllim ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë Nr. 01.189/23, datë 28.07.2023, që ka të bëjë me dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale për nevoja të Spitalit të Vushtrrisë.

Ju faleminderit në mirëkuptim!

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN
01 Nr. / Br 189/23
Nr. i fq. / Br. st -1-
Data: / Datum 28.07.2023
VUSHTRRI - VUČITRN

**Republika e Kosovës** **Kuvendi i Komunës-Vushtrri**

Në bazë të nenit 12.2 "d" të Ligjit nr. 03/L-40/2008 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 4, 5, 6, dhe 21 pika 1.1 të Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr.06/L-092, nenit 25 të Rregullores (QRK) për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Ligjin Nr.04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, Planin Zhvillimor Komunal të Komunës së Vushtrrisë 2016-2024 dhe nenit 13 paragrafi 2 pika 1.4 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më **27 të vazhduar me 28 korrik 2023,** merr këtë:

**VENDIM**

**PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTËR TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS**

**1.** Me këtë vendim jepet në shfrytëzim afatshkurtër për tri (3) vite, me mundësi vazhdimi, pas realizimit të investimeve, parcela kadastrale P-70202016-02358-7, në sipërfaqe prej 7380m2, ZK-Vushtrri, pronë e Komunës së Vushtrrisë e evidentuar në emër të P.Sh. Shtëpi e Shëndetit, ashtu që përgjatë kësaj periudhe të realizohet investimi nga ana e Shërbimi Spitalor Klinik Universitar të Kosovës, që lidhet me financimin e projektit për ndërtimin e parkingut nëntokësor dhe zgjerimi i hapësirave të shërbimit të emergjencës për nevoja të spitalit të Vushtrrisë në Komunën e Vushtrrisë.

**2.** Paluajtshmëria e cekur në pikën 1 të këtij vendimi i jepet në shfrytëzimin, Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës për nevoja të zgjerimin e hapësirave infrastrukturore të Spitalit "Sheikh Zayed" në Vushtrri.

**3.** Për pronën e cila jepet në shfrytëzim, Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës obligohet që të financoj projektin për ndërtimin e parkingut nëntokësor dhe zgjerimi i hapësirave të shërbimit të emergjencës për nevoja të spitalit të Vushtrrisë në Komunën e Vushtrrisë.

**4.** Në rast të ndërrimit eventual të lokacionit/zhvendosjes së spitalit në një lokacion tjetër gjatë periudhës kohore për të cilën i jepet në shfrytëzim, prona e paluajtshme e komunës e cila i jepet në shfrytëzim i rikthehet Komunës së Vushtrrisë në shfrytëzim.

**5.** Autorizohet Kryetari i Komunës që pas plotfuqishmërisë së këtij vendimi të lidhë kontratë me përfaqësuesin MSH/SHSKUK për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale.

**6.** Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria e Shëndetësisë dhe Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë.

**7.** Pjesë përbërëse e këtij vendimi është certifikata e pronës dhe kopja e planit.

**8.** Ky vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Pushtetit Lokal si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Melihate Basholli-Latifi**

**Kryesuese e Kuvendit**

# Haki Maloku

**From:** Bujar Shatrolli
**Sent:** Friday, January 23, 2026 1:52 PM
**To:** Haki Maloku
**Subject:** FW: Kerklese
**Attachments:** SHZH FIRST FLOOR 22_1_26.pdf; SHZH GROUND FLOOR 22_1_26.pdf

Me respekt,


**Bujar Shatrolli**
**Shef i Kabinetit të Kryetarit**
**Komuna e Vushtrrisë**
**Republika e Kosovës**

PHONE MOBILE EMAIL
**+383 38 200 42459 +383 44 826 825 bujar.shatrolli@rks-gov.net**
Adresa: Sheshi "Ahmet Krasniqi", nr.10, 42000, Vushtrri
https://vushtrri.rks-gov.net/


---

**From:** Ferit Idrizi <Ferit.Idrizi@rks-gov.net>
**Sent:** Friday, January 23, 2026 1:51 PM
**To:** Bujar Shatrolli <bujar.shatrolli@rks-gov.net>
**Subject:** FW: Kerklese

Me respekt,


**Ferit Idrizi**
Kryetar i Komunës së Vushtrrisë
Komuna Vushtrri
Tel: +383 38 200 42 402
Adresa: Sheshi Ahmet Krasniqi nr 10, 42000, Vushtrri


---

**From:** Mursel Pllana <Mursel.Pllana@rks-gov.net>
**Sent:** 23 January 2026 13:18
**To:** Ferit Idrizi <Ferit.Idrizi@rks-gov.net>; Lorik.Maxhuni <Lorik.Maxhuni@rks-gov.net>; haki.maloku@rks.gov.net
**Subject:** Kerklese

Te nderuar,

Me kete kerkese po iu drejtohemi lidhur me vazhdimin e "**Vendimit per shfrytezim te prones se paluajtshme te Komunes**".

Ky vendim eshte leshuar per here te pare me Nr/P: 189/23 me 28.07.2023, por per arsye se Investitori deri tani eshte marre me pregaditjen e projektit dhe sigurimin e Fondeve, afati kohor i dhene eshte afer skadences dhe punimet nuk mund te fillojne pa e vazhduar kete Vendim. Lusim qe ky dokument te leshohet ne afat me te gjate se paku 10 vite.

Projekti **Zgjerimi i hapesirave te Spitalit Sheikh Zayed** ne Vushtrri per te cilin tashme e nje kohe te gjate po punojme se bashku, Projekti i eshte dhene Kompanise "Miftari" kompani kjo e cila eshte perzgjedhur nga **ICME e Emirateve te Bashkuara Arabe - kompani konsulente me seli ne AbuDhabi** dhe i shperndare edhe ne shume vende tjera te botes.

Momentalisht projekti detaj eshte ne finalizim nga Kompania Miftari dhe jemi ne pritje te konfirmimit perfundimtar nga donatori per te vazhduar me dorezimin e kopjeve ne Drejtorine e Urbanizmit ne Komunen e Vushtrrise.

ICME eshte sygjeruar dhe kontaktuar nga kompani relevante per ndertimin e objektit por ende nuk ka kontrate konkrete ne mes ICME dhe ndonje kompanie ndertuese lokale.
Vlen te ceket qe kosto e projektit eshte definuar gjate punes se projektit detaj, per te cilen jemi dakorduar se bashku me donatorin.

Ne jemi shume optimist dhe te gatshem per hapat e metejshem rreth realizimit te projektit.

Te bashkangjitur me poshte gjeni pdf planimetri te perdheses dhe katit te anex objektit.

Gjitha te mirat,

---

Dr. Mursel Pllana
Ud Drejtor Ekzekutiv
+38343707154

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

-VI- 020-628/1
03.10.2023

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administration*

| | | |
|---|---|---|
| Për : | Ferit Idrizi, Kryetar i Komunës së Vushtrrisë<br>Melihate Basholli Latifi, Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë | |
| Kopje: | Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL<br>Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë | |
| Përmes: | Elbert Krasniqi, Minister i MAPL-së<br>Jeton Qela, Zv. Sekretar i Përgjithshëm i MAPL-së | |
| Nga: | Besim Myrtezani, Zv. Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave | Datë:<br>21.08.2023<br>Nr. VI- 020-628 |
| Zyrtarët përgjegjës:<br>1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor<br><br>2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor | Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave<br><br>Ardita Latifi, Zyrtare e lartë për Monitorimin e Komunave | |
| Lënda: | Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë | |
| Lloji i aktit: | Vendim | |

I nderuar Kryetar,
E nderuara Kryesuese,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, si dhe Rregulloren nr. 06/2021 për ndryshim-plotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2021 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

| |
|---|
| Vendim nr 189/23 për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës |
| E miratuar më datë: 27.07.2023 (vazhduar me 28.07.2023) |
| E parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 01.08.2023 |

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës, është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Arsyetim

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur me datë 27.07.2023, ka miratuar **Vendimin Nr 189/23 për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës.**

MAPL, konstaton së akti i nxjerrë nga Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, është bazuar në nenin 12.2 të Ligjit për vetëqeverisje lokale, nenit 4,5,6 dhe 21 pika 1.1 të Ligjit Nr.06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës se paluajtshme të komunës dhe nenit 24 e 25 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës, (ku përcakohet se dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme të komunës për rastë të veçanta jepet pa zbatuar procedurat e konkurimit), si dhe bazuar në Ligjin Nr.04/L-174 për Planifikim Hapësinor dhe Planin Zhvillimor Komunal të Komunës së Vushtrrrisë 2016-2024.

**Vendimi Nr 189/23 për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës**, për 3 vite, si rast i veçantë, me mundësi vazhdimi, është miratuar me qëllim që pas realizimit të investimeve, parcela kadastrale P-70202016-02358-7, në sipëfaqe prej 7380 metra $^2$, ZK-Vushtrri, pronë e Komunës së Vushtrrisë e evidentuar në emër të PSH, Shtëpi e Shëndetit, ashtu që përgjatë kësaj periudhe të realizohet investimi nga ana e Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës, që lidhet me financimin e projektit për ndërtimin e parkingut nëntokësor dhe zgjerimi i hapësirave të shërbimit të emergjencës për nevojat e Spitalit të Vushtrrisë në Komunën e Vushtrrisë.

Akti në fjalë është miratuar në mbledhjen e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me datë 27.07.2023, me 13 vota "për", 7 vota "kundër" dhe asnjë "abstenim.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejmë lidhur me këtë vlerësim.

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*
*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture / Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

18/1697

# CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

## NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-70202016-02358-7

| | |
|---|---|
| Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number: | 18-1697/23 |
| Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission: | 12.07.2023 - 09:17 |
| Komuna / Opština / Municipality: | VUSHTRRI / VUĆITRN / VUSHTRRI |
| Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: | Vushtrri / Vushtrri / Vushtrri |
| Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office: | VUSHTRRI / VUĆITRN / VUSHTRRI |

## A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

| Numri i njësisë kadastrale<br>Broj katastarske jedinice<br>Cad. Unit. No. | Lloji i njësisë<br>Vrsta Jedinice<br>Unit Type | Lloji i pronës<br>Vrsta imovine<br>Property Type | Zona<br>U/R<br>G/S<br>U/R | Sipërfaqja<br>Površina<br>Area<br>(m²) | Përshkrim<br>Opis<br>Description | Krijuar më datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| P-70202016-02358-7 | PARCELË / PARCELA / PARCEL | Pronë shoqërore / Drushtvena Imovina / Socially owned Land | | 7380 | 00-2004 | | |

## A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE /CADASTRAL UNIT ADDRESS

| Vendi i quajtur<br>Mesto zvano<br>Called place | Kodi Postal<br>Poštanski Kod<br>Postal Code | Emri i rrugës<br>Naziv ulice<br>Street name | Krijuar më datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|
| LOZJE | | | | |

Printuar nga / Odštampani od / Printed by: Valon.Maxhuni | P-70202016-02358-7 |

Zyrtari përgjegjës / Odgovorno lice / Official person

## A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

| Numri<br>Broj<br>Number | Lloji i shfrytëzimit të parcelës<br>Vrsta koriscenja parcele<br>Parcel Type Of Use | Shfrytëzimi aktual i parcelës<br>Trenutno koriscenje parcele<br>Parcel Current Use | Kualiteti i klasës<br>Kvalitet klase<br>Quality Class | Sipërfaqja (m²)<br>Površina (m²)<br>Area (m²) |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Tokë Ndërtimore/Gradjevinsko zemljište/Construction land | Oborr/Dvorište/BackYard | | 5853 |
| 2 | Tokë Ndërtimore/Gradjevinsko zemljište/Construction land | Shtëpi-Ndërtese/Kuca-Zgrada/House-Building | | 1527 |

## B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

| Të drejtat<br>Prava<br>Rights | Emri<br>Ime<br>Name | Nr. personal<br>Licni broj<br>ID. No. | Vendbanimi<br>Prebivaliste<br>Resident | Kodi postal<br>Poštanski kod<br>Postal code | Hollësitë e adresës<br>Pojedinosti adrese<br>Address details | Pjesa e pronës<br>Deo imovine<br>Share quota | Pershkrimi<br>Opis<br>Description | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Posedim individual /<br>Individualna Drzavina /<br>Single possessor | **P SH. SHTËPI E SHËNDETIT** | KCID0204928 | VUSHTRRI / VUSHTRRI / VUSHTRRI / | | "SITNICËS" | **1/1** | 00-2004 | |

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

## KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : VUSHTRRI
Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Vushtrri

| Njësia/Jedinica/Unit | Tipi/Vrsta/Type | Sipërfaqja/Površina/Area m² |
|---|---|---|
| P-70202016-02358-12 | Parcelë / Parcela / Parcel | 41655 |




Shkalla/Razmera/Scale: 1:3355

Punoi/Obradio/Created:
Data/ Data/Date: 12.07.2023
Koha/ Vreme/ Time: 09:20:46
Nënshkrimi/Potpis/Signature:
Shënim/Beleška/Note: Mungon ndarja

Aprovoi/Usvojio/Aproved: Drejtori/Direktor/Director
Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës - SHSKUK
Univerzitetska Bolnička i Klinička Služba Kosova - UBKSK
Hospital and University Clinical Service of Kosovo - HUCSK

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| REFERENCË: | / | | | | |
| PËR/ZA/TO: | Kryesuesin/en e Kuvendit Komunal, Komunën e Vushtrrisë, Republika e Kosovës. | | | | |
| Cc/Njofim: | Dr.Arben Vitia – Ministër, Ministria e Shëndetësisë. z.Ferit Idrizi – Kryetar, Komuna e Vushtrrisë. | | | | |
| PËRMES/PREKO/THROUGH: | Dr.Aida Rexhepi – Kryesuese, Bordi Drejtues SHSKUK. | | | | |
| NGA/OD/FROM: | Dr.Narqize Arënliu-Hoxhaj – zv.Drejtor i Përgjithshëm, SHSKUK. | | | | |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | Kërkesë për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale për nevojat e Spitalit të Përgjithshëm "Sheikh Zayed" në Vushtrri. | | | | |
| Nr. i zyrës: Br. kancelarije: Room No.: | 10 | Lokacioni: Kucni: Extension: | QKUK Objekti i Administratës Kati II | Data: Datum: Date: | 27.02.2022 |
| PËR AKTIVITET/ZA AKTIVNOST/FOR ACTION | | | | | x |
| PËR INFORMIMIN TUAJ/ZA VASU INFORMACIJU/FOR YOUR INFORMATION | | | | | x |

I/e nderuar,

Ndërlidhur me diskutimet që kemi zhvilluar për dhënien në shfrytëzim të pronës së komunës së Vushtrrisë me qëllimin që të zgjerohen hapsirat infrastrukturore spitalore të Spitalit të Përgjithshëm "SHEIKH ZAYED" në Vushtrri, rrjedhimisht me qëllim të zgjerimit të gamës së ofrimit të shërbimeve shëndetësore për komunën tuaj, përmes kësaj letre distribuimi, kërkojmë nga Ju, që bazuar në Ligjin NR.06/L-092 Për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe Rregulloren QRK Nr.09/2020 për Përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe Këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës. të merrni vendim nga Kuvendi Komunal për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, për raste të veçanta nga Certifikata e pronësisë nr.p-70202016-02358-7 me sipërfaqe 7380 m2 me përshkrim 00-2004 me kohëzgjatje prej 99 vitesh për shkak të natyrës së investimit.

Për çdo sqarim shtesë ose informatë tjetër relevante, mund të na kontaktoni.

Bashkëngjitur gjeni certifikatën e pronës.

Me respekt.

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës Univerzitetska Bolnička i Klinička Služba Kosova-Hospital and University Clinical Service of Kosovo
**Spitali i Përgjithshëm Sheikh Zayed- Vushtrri**
General Hospital Sheikh Zayed- Vushtrri

| | | |
|---|---|---|
| DATA: | 20.12.2022 | |
| PËR/ZA/TO: | Dr. Pranvera Zejnullahu – Raci, U.d. drejtor i përgjithshëm i SHSKUK-së | |
| NGA/OD/FROM: | Dr. Shefkije Shatri – Drejtor Ekzekutiv i Spitalit "Shiekh Zayed" | |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | Kërkesë! | |
| PËR AKTIVITET/ZA AKTIVNOST/FOR ACTION | | X |

E nderuara znj. Drejtoresh,

Si menaxhment i Spitalit "Sheikh Zayed" në Vushtrri siç ju kemi njoftuar verbalisht e kemi vlerësuar së bashku me donatorët nga Emiratet e Bashkuara Arabe, se objekti aktual i Spitalit nuk i përmbush nevojat për planifikimin tonë për shërbime të reja dhe për organizim të ri të punës. Duke e analizuar gjendjen dhe planin e punës kemi ardhu në përfundim se objekti aktual i QKMF-së në pajtim me mundësitë buxhetore të siguruar nga donatorët e Emirateve të Bashkuara Arave, duhet të rrënohet dhe të ndërtohet objekt i ri me lidhje fizike me objektin aktual të Spitalit. Në objektin e ri planifikojmë të organizojmë Emergjencën e Spitalit, Pediatrinë dhe Laboratorin, ku lidhja dhe qasja e automjeteve do të jetë shumë me e lehtë dhe më efikase. Po ashtu kemi planifikuar që në objektin e ri të barten të gjitha ambulancat specialistike si dhe administrata e Spitalit. Po ashtu në pjesën planifikuese është propozuar të ndërtohet parkingu nëntokësor ku do të ketë vend të mjaftueshëm për automjetet e punëtorëve të Spitalit. Me këtë organizim objekti aktual i Spitalit do të shërbejë vetëm për pacientet e hospitalizuar ndërsa pjesa e re e objektit do të organizojë gjithë veprimtarinë ditore të Spitalit.

Në këtë plan tonin është pajtuar edhe komuna e Vushtrrisë në parim si dhe donatori ku tani më kanë nisur matjet dhe planifikimet projektuese ku në bazë të tyre dhe kostos financiare do të vendosin se si do të veprojnë donatorët.

[illegible] së procesit të këtij [illegible] Komunës për nisjen e procedurës së bartjes së pronësisë së pronës së Komunës [illegible] aktualisht është objekt i OKMF-së, por që në bisedë me kryetarin, kanë kërkuar që kërkesa për dhënien e pronës së komunës për nevojat e Spitalit të dërgohet nga SHSKUK si titullari më i lartë i të drejtave dhe detyrimet në kuadër të institucioneve dytësore dhe terësore të shëndetësisë

Me këtë rast ju lutemi që në pajtim me shkresën tonë të cilën e kemi dorëzuar në Komunës të parashtroni kërkesë ju si drejtor i përgjithshëm i SHSKUK te Komuna e Vushtrrisë për bartjen e pronës së komunës për nevojat e Spitalit.

Të bashkangjitur ju lutem gjeni shkresën e dorëzuar nga ana jonë te kryetari i Komunës së Vushtrrisë.

Me respekt!

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government

Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës Univerzitetska Bolnička i Klinička Služba Kosova-Hospital and University Clinical Service of Kosovo
Spitali i Përgjithshëm Sheikh Zayed- Vushtrri
General Hospital Sheikh Zayed- Vushtrri

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| PËR/ZA/TO: | Z. Ferit Idrizi, Kryetar i Komunës së Vushtrrisë | | | | |
| NGA/OD/FROM: | Dr. Shefkije Shatri – Drejtor ekzekutiv i Spitalit Vushtrri | | | | |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | Kërkesë | | | | |
| Nr. i zyrës: Br. kancelarije: Room No.: | | Lokacioni: Kucni: Extension: | Drejtoria e Spitalit | Data: Datum: Date: | 31.10.2022 |
| PËR AKTIVITET/ZA AKTIVNOST/FOR ACTION | | | | | x |

I nderuar z. Kryetar,

Fillimisht me lejoni të ju falënderoj në emër timin dhe të menaxhmentit të Spitalit për mbështetjen dhe bashkëpunimin e vazhdueshëm që kemi gjetur te ju. Si menaxhment i Spitalit jemi të përkushtuar të kemi bashkëpunim të vazhdueshëm me juve si Komunë për vet faktin se ju shërbejmë qytetarëve të njëjtit vend. Prandaj duke ju referuar qëllimeve të përbashkëta dhe nevojave që kanë qytetarët tonë më lejoni që në emër të institucionit që menaxhoj, Spitalit "Sheikh Zayed" në Vushtrri, të ju drejtohem me kërkesën si në vijim;

Spitali "Sheikh Zayed" në Vushtrri siç jeni të njoftuar ka të planifikuar 175 punëtorë të profileve të ndryshme specialistike, infermierike, administrative e teknike. Aktualisht kemi funksional repartin e Kirurgjisë, Gjinekologjisë, Maternitetit, Pediatrisë, Internos, Emergjencës, Radiologjisë, Laboratorit dhe ambulantat specialistike të reparteve të cekura. Përveç kësaj kemi ambulanta specialistike ditore për dermatovenerologji, fiziatri, endokrinologji, urologji, kardiologji, gastroenterologji, pulmologji dhe reumatologji. Po ashtu kemi funksional edhe kabinetin e Kardiologjisë dhe Gastroenterologjisë. Krahas njësive specialistike mjekësore në të njëjtin objekt e kemi edhe administratën, sterilizimin, lavanderin, kuzhinën dhe shërbimet teknike. Duke ju referuar hapësirës që kemi, shërbimeve që ofrojmë dhe numrit të madh të pacientëve që marrin shërbime në Spitalin tonë, jemi të detyruar të mendojmë për zgjidhje alternative me qëllim të zgjerimit të hapësirës së Spitalit.

Në bisedat e përbashkëta jemi njoftuar për arritjet e sukseseve në kujdesin primar dhe zgjerimin e hapësirave shëndetësore duke ndërtuar edhe objektin e ri të mjekësisë familjare. Objekt që sipas njoftimeve përmbush nevojat për organizimin e mirëfilltë të një objekti shëndetësor si dhe planifikimin për bartjen e

stafi të QKMF-së aktuale në objekt [illegible] zonë të [illegible] [illegible] dhe [illegible] [illegible] për [illegible] shëndetësore [illegible] për qytetarët [illegible] [illegible] të kësaj të arritura [illegible] ana e juaj dhe e nevojës për zgjerim [illegible] në këtë përfundim duke ju lutur dhe duke u mbështetur [illegible] Kuvendi i Komunës [illegible] në shfrytëzim objektin në të cilin deri më tani [illegible] QKMF ja [illegible]

Si menaxhment i Spitalit kemi vlerësuar se objekti aktual i QKMF-së në pajtim me mundësitë buxhetore të siguruar nga donatorët e Emirateve të Bashkuara Arabe, duhet të rrënohet dhe të ndërtohet objekti i ri me lidhje fizike me objektin aktual të Spitalit. Në objektin e ri planifikojmë të organizojmë Emergjencën e Spitalit, ku lidhja dhe qasja e automjeteve do të jetë shumë me e lehtë dhe më efikase. Po ashtu kemi planifikuar që në objektin e ri të barten të gjitha ambulancat specialistike në të cilat brenda ditës frekuentojnë objektin mbi 500 pacientë e shoqërues gjë që rrit rrezikun për bartje të infeksionit për pacientët e shtrirë dhe ata post-operativ. Po ashtu planifikohet të bartet edhe administrata e Spitalit, ku në të njëjtën hapësirë planifikohet të zgjerohet reparti i Pediatrisë për shkak të nevojave të mëdha dhe numrit të madh të pacientëve. Ndërsa në pjesën planifikuese të ndërtohet parkingu nëntokësor ku do të ketë vend të mjaftueshëm për automjetet e punëtorëve të Spitalit. Me këtë organizim objekti aktual i Spitalit do të shërbejë vetëm për pacientet e hospitalizuar ndërsa pjesa e re e objektit do të organizojë gjithë veprimtarinë ditore të Spitalit.

I nderuar z. Kryetar, jemi koshient për peshën e kërkesës dhe mbështetjen e madhe që po e kërkojmë nga ju dhe nga Kuvendi i Komunës por po aq jemi koshient se kjo do të jetë një ndër punët më të mëdha dhe më të mira që do të bëhen në Komunën tonë. Përfituesi më i madh dhe i pa kontestueshëm do të jetë qytetari, pacienti, për çka do të mbaheni mend gjithmonë për këtë punë aq të madhe që e keni mundësuar për ta.

Duke ju falënderuar për mbështetjen e deri tanishme, shpresojmë dhe besojmë se kjo kërkesën e jona do të gjejë mbështetjen tuaj!

Me respekt

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| REFERENCE: | / | | | | |
| PËR/ZA/TO: | Kryesuesin/en e Kuvendit Komunal, Komunën e Vushtrrisë, Republika e Kosovës. | | | | |
| Cc/Njofim: | Dr.Arben Vitia – Ministër, Ministria e Shëndetësisë. z.Ferit Idrizi – Kryetar, Komuna e Vushtrrisë. | | | | |
| PËRMES/PREKO/THROUGH: | Dr.Aida Rexhepi – Kryesuese, Bordi Drejtues SHSKUK. | | | | |
| NGA/OD/FROM: | Dr.Narqize Arënliu-Hoxhaj – zv.Drejtor i Përgjithshëm, SHSKUK. | | | | |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | Kërkesë për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale për nevojat e Spitalit të Përgjithshëm "Sheikh Zayed" në Vushtrri. | | | | |
| Nr. i zyrës: Br. kancelarije: Room No.: | 10 | Lokacioni: Kucni: Extension: | QKUK Objekti i Administratës Kati II | Data: Datum: Date: | 27.02.2022 |
| PËR AKTIVITET/ZA AKTIVNOST/FOR ACTION | | | | | x |
| PËR INFORMIMIN TUAJ/ZA VASU INFORMACIJU/FOR YOUR INFORMATION | | | | | x |

I/e nderuar,

Ndërlidhur me diskutimet që kemi zhvilluar për dhënien në shfrytëzim të pronës së komunës së Vushtrrisë me qëllimin që të zgjerohen hapsirat infrastrukturore spitalore të Spitalit të Përgjithshëm "SHEIKH ZAYED" në Vushtrri, rrjedhimisht me qëllim të zgjerimit të gamës së ofrimit të shërbimeve shëndetësore për komunën tuaj, përmes kësaj letre distribuimi, kërkojmë nga Ju, që bazuar në Ligjin NR.06/L-092 Për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe Rregulloren QRK Nr.09/2020 për Përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe Këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës, të merrni vendim nga Kuvendi Komunal për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, për raste të veçanta nga Certifikata e pronësisë nr.p-70202016-02358-7 me sipërfage 7380 m2 me përshkrim 00-2004 me kohëzgjatje prej 99 vitesh për shkak të natyrës së investimit.

Për çdo sqarim shtesë ose informatë tjetër relevante, mund të na kontaktoni.

Bashkëngjitur gjeni certifikatën e pronës.

Me respekt.

Republika e Kosovës
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada-Government*

Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës Univerzitetska Bolnička i Klinička Služba Kosova
**Hospital and University Clinical Service of Kosovo**
**Spitali i Përgjithshëm Sheikh Zayed- Vushtrri**
General Hospital Sheikh Zayed- Vushtrri

| | |
|---|---|
| DATA: | 20.12.2022 |
| PËR/ZA/TO: | Dr. Pranvera Zejnullahu – Raci, U.d. drejtor i përgjithshëm i SHSKUK-së |
| NGA/OD/FROM: | Dr. Shefkije Shatri – Drejtor Ekzekutiv i Spitalit "Shiekh Zayed" |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | Kërkesë! |
| PËR AKTIVITET/ZA AKTIVNOST/FOR ACTION | X |

E nderuara znj. Drejtoresh,

Si menaxhment i Spitalit "Sheikh Zayed" në Vushtrri siç ju kemi njoftuar verbalisht e kemi vlerësuar së bashku me donatorët nga Emiratet e Bashkuara Arabe, se objekti aktual i Spitalit nuk i përmbush nevojat për planifikimin tonë për shërbime të reja dhe për organizim të ri të punës. Duke e analizuar gjendjen dhe planin e punës kemi ardhu në përfundim se objekti aktual i QKMF-së në pajtim me mundësitë buxhetore të siguruar nga donatorët e Emirateve të Bashkuara Arave, duhet të rrënohet dhe të ndërtohet objekt i ri me lidhje fizike me objektin aktual të Spitalit. Në objektin e ri planifikojmë të organizojmë Emergjencën e Spitalit, Pediatrinë dhe Laboratorin, ku lidhja dhe qasja e automjeteve do të jetë shumë me e lehtë dhe më efikase. Po ashtu kemi planifikuar që në objektin e ri të barten të gjitha ambulancat specialistike si dhe administrata e Spitalit. Po ashtu në pjesën planifikuese është propozuar të ndërtohet parkingu nëntokësor ku do të ketë vend të mjaftueshëm për automjetet e punëtorëve të Spitalit. Me këtë organizim objekti aktual i Spitalit do të shërbejë vetëm për pacientet e hospitalizuar ndërsa pjesa e re e objektit do të organizojë gjithë veprimtarinë ditore të Spitalit.

Në këtë plan tonin është pajtuar edhe komuna e Vushtrrisë në parim si dhe donatori ku tani më kanë nisur matjet dhe planifikimet projektuese ku në bazë të tyre dhe kostos financiare do të vendosin se si do të veprojnë donatorët.

[illegible]

Me këtë rast ju lutemi që në pajtim me shkresën tonë të cilën e kemi dorëzuar në Komunës të parashtroni kërkesë ju si drejtor i përgjithshëm i SHSKUK te Komuna e Vushtrrisë për bartjen e pronës së komunës për nevojat e Spitalit.

Të bashkangjitur ju lutem gjeni shkresën e dorëzuar nga ana jonë te kryetari i Komunës së Vushtrrisë.

Me respekt!

Hospital and University Clinical Service of Kosovo Bolnička i Klinička Služba Kosova

Spitali i Përgjithshëm Sheikh Zayed- Vushtrri

General Hospital Sheikh Zayed- Vushtrri

| | | | |
|---|---|---|---|
| PËR/ZA/TO: | Z. Ferit Idrizi, Kryetar i Komunës së Vushtrrisë | | |
| NGA/OD/FROM: | Dr. Shefkije Shatri – Drejtor ekzekutiv i Spitalit Vushtrri | | |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | Kërkesë | | |
| Nr. i zyrës:<br>Br. kancelarije:<br>Room No.: | Lokacioni:<br>Kueni:<br>Extension: Drejtoria e Spitalit | Data:<br>Datum:<br>Date: | 31.10.2022 |
| PËR AKTIVITET/ZA AKTIVNOST/FOR ACTION | | | x |

I nderuar z. Kryetar,

Fillimisht me lejoni të ju falënderoj në emër timin dhe të menaxhmentit të Spitalit për mbështetjen dhe bashkëpunimin e vazhdueshëm që kemi gjetur te ju. Si menaxhment i Spitalit jemi të përkushtuar të kemi bashkëpunim të vazhdueshëm me juve si Komunë për vet faktin se ju shërbejmë qytetarëve të njëjtit vend. Prandaj duke ju referuar qëllimeve të përbashkëta dhe nevojave që kanë qytetarët tonë më lejoni që në emër të institucionit që menaxhoj. Spitalit "Sheikh Zayed" në Vushtrri, të ju drejtohem me kërkesën si në vijim:

Spitali "Sheikh Zayed" në Vushtrri siç jeni të njoftuar ka të planifikuar 175 punëtorë të profileve të ndryshme specialistike, infermierike, administrative e teknike. Aktualisht kemi funksional repartin e Kirurgjisë, Gjinekologjisë, Maternitetit, Pediatrisë, Internos, Emergjencës, Radiologjisë, Laboratorit dhe ambulantat specialistike të reparteve të cekura. Përveç kësaj kemi ambulanta specialistike ditore për dermatovenerologji, fiziatri, endokrinologji, urologji, kardiologji, gastroenterologji, pulmologji dhe reumatologji. Po ashtu kemi funksional edhe kabinetin e Kardiologjisë dhe Gastroenterologjisë. Krahas njësive specialistike mjekësore në të njëjtin objekt e kemi edhe administratën, sterilizimin, lavanderin, kuzhinën dhe shërbimet teknike. Duke ju referuar hapësirës që kemi, shërbimeve që ofrojmë dhe numrit të madh të pacientëve që marrin shërbime në Spitalin tonë, jemi të detyruar të mendojmë për zgjidhje alternative me qëllim të zgjerimit të hapësirës së Spitalit.

Në bisedat e përbashkëta jemi njoftuar për arritjet e sukseseve në kujdesin primar dhe zgjerimin e hapësirave shëndetësore duke ndërtuar edhe objektin e ri të mjekësisë familjare. Objekt që sipas njoftimeve përmbush nevojat për organizimin e mirëfilltë të një objekti shëndetësor si dhe planifikimin për bartjen e

[illegible]

[illegible] [illegible] nga donatorët [illegible] dhe të ndërtojmë objekti i ri me lidhje fizike me objektin aktual të Spitalit. [illegible] objektin e ri planifikojmë të organizojmë Emergjencën e Spitalit, ku lidhja dhe qasja e automjeteve do të jetë shumë me e lehtë dhe më efikase. Po ashtu kemi planifikuar që në objektin e ri të barten të gjitha ambulancat specialistike në të cilat brenda ditës frekuentojnë objektin mbi 500 pacientë e shoqërues gjë që rrit rrezikun për bartje të infeksionit për pacientët e shtrirë dhe ata post-operativ. Po ashtu planifikohet të bartet edhe administrata e Spitalit, ku në të njëjtën hapësirë planifikohet të zgjerohet reparti i Pediatrisë për shkak të nevojave të mëdha dhe numrit të madh të pacientëve. Ndërsa në pjesën planifikuese të ndërtohet parkingu nëntokësor ku do të ketë vend të mjaftueshëm për automjetet e punëtorëve të Spitalit. Me këtë organizim objekti aktual i Spitalit do të shërbejë vetëm për pacientet e hospitalizuar ndërsa pjesa e re e objektit do të organizojë gjithë veprimtarinë ditore të Spitalit.

I nderuar z. Kryetar, jemi koshient për peshën e kërkesës dhe mbështetjen e madhe që po e kërkojmë nga ju dhe nga Kuvendi i Komunës por po aq jemi koshient se kjo do të jetë një ndër punët më të mëdha dhe më të mira që do të bëhen në Komunën tonë. Përfituesi më i madh dhe i pa kontestueshëm do të jetë qytetari, pacienti, për çka do të mbaheni mend gjithmonë për këtë punë aq të madhe që e keni mundësuar për ta.

Duke ju falënderuar për mbështetjen e deri tanishme, shpresojmë dhe besojmë se kjo kërkesën e jona do të gjejë mbështetjen tuaj!

Me respekt







KEY PLAN

N

FUNDING AUTHORITY

دائــــرة الـــصـــحـــة
DEPARTMENT OF HEALTH

CLIENT

MINISTRY OF HEALTH
REPUBLIC OF KOSOVO

LEAD CONSULTANT

I·C·M·E·
HEALTHCARE

DESIGN CONSULTANT

دار العمران
DAR AL OMRAN

DAR AL OMRAN ARCHITECTS ENGINEERS CONSULTANTS
Abu Dhabi – UAE

LOCAL DESIGN CONSULTANT

MIFTARI CONSTRUCTION GROUP SH.P.K

| PROJECT NUMBER & TITLE | | | |
|---|---|---|---|
| SHEIKH ZAYED HOSPITAL REFURBISHMENT AND EXPANSION | | | |
| LOCATION | VUSHTRRI-KOSOVO | PLOT NO. | |

| DRAWING NAME | | | | |
|---|---|---|---|---|
| GROUND FLOOR (NEW EXTENSION) - FF&E - MEQ 1:110 | | | | |
| SCALE: 1:110.0 | | WHEN PRINTED AT A1 SHEET SIZE | | |
| ISSUE DATE | DESIGNED BY | CHECKED BY | APPROVED BY | DRAWN BY |
| 21 - JAN - 2026 | K.J.;K.D | | | K.D |
| DRAWING No. | | | | REV |
| A104 | | | | |




KEY PLAN

N

FUNDING AUTHORITY

دائـــرة الـصـحـــة
DEPARTMENT OF HEALTH

CLIENT

MINISTRY OF HEALTH
REPUBLIC OF KOSOVO

LEAD CONSULTANT

I·C·M·E·
HEALTHCARE

DESIGN CONSULTANT

DAR AL OMRAN ARCHITECTS
ENGINEERS CONSULTANTS
Abu Dhabi - UAE

دار العمران
DAR AL OMRAN

LOCAL DESIGN CONSULTANT

MIFTARI CONSTRUCTION
GROUP SH.P.K

MIFTARI

PROJECT NUMBER &TITLE

SHEIKH ZAYED HOSPITAL
REFURBISHMENT AND EXPANSION

| LOCATION | VUSHTRRI-KOSOVO | PLOT NO. | |
|---|---|---|---|

DRAWING NAME
FIRST FLOOR (NEW EXTENSION) - FF&E - MEQ

1:110,
1:1000

SCALE: 1 WHEN PRINTD AT A SHEET SIZE

| ISSUE DATE | DESIGNED BY | CHECKED BY | APPROVED BY | DRAWN BY |
|---|---|---|---|---|
| 21 - JAN - 2026 | K.J.,K.D | | | K.D |

| DRAWING No. | REV |
|---|---|
| A105 | |

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova – Republic of Kosovo
**Komuna e Vushtrrisë**
Opština Vučitrn – Municipality of Vushtrri

**Kuvendi i Komunës**

**Për: KPF-në dhe Kuvendin e Komunës**

**Propozues dhe Hartues: Kryesuesja e Kuvendit znj. Melihate Basholli-Latifi**______

**Çështja për trajtim: Propozim-vendim**

Në bazë të nenit 12.2 "d" të Ligjit nr. 03/L-40/2008 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 19 paragrafi 2 pika 1.4 të Statutit të Komunës, si dhe duke u bazuar në kërkesën e Asociacionit të Komunave të Kosovës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e rregullt mbajtur më ________**2026,** merr këtë:

# V E N D I M

**Për caktimin e anëtarëve të kuvendit të Komunës së Vushtrrisë në Kuvendin e Përgjithshëm të Asociacionin e Komunave të Kosovës**

**1.** Me këtë vendim emërtohen anëtarët e kuvendit të Komunës së Vushtrrisë të cilët do ta përfaqësojnë Kuvendin Komunal të Vushtrrisë në Kuvendin e përgjithshëm të Asociacionit të Komunave të Kosovës në përbërjen si në vijim:

**1.1.________________, anëtar/e e Kuvendit;**
**1.2.________________, anëtar/e e Kuvendit;**
**1.3.________________, anëtar/e e Kuvendit.**

**2.** Kryetari i Komunës përfaqëson Komunën e Vushtrrisë sipas detyrës zyrtare me përfaqësim direkt, ndërsa partitë politike të përfaqësuara në Kuvendin e Komunës së Vushtrrisë propozojnë nga një përfaqësues.

**3.** Anëtarët e emëruar në pikën 1 të këtij vendimi, emërohen me mandat të njëjtë si të anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë.

**4.** Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: kryetari i komunës, kryesuesja e kuvendit dhe anëtarët e kuvendit të cekur si në pikën 1 të këtij vendimi.

**5.** Ky vendim hynë në fuqi tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) dite pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Melihate Basholli-Latifi**

______________________

**Kryesuese e Kuvendit**

## Arsyetim

Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK) ka kërkuar që çdo komunë të emërojë delegatët e saj për përfaqësim në Kuvendin e Përgjithshëm të AKK-së, sipas Statutit dhe rregullave të brendshme të asociacionit.

Kryetari i Komunës përfaqëson Komunën e Vushtrrisë sipas detyrës zyrtare me përfaqësim direkt, ndërsa partitë politike të përfaqësuara në Kuvendin e Komunës së Vushtrrisë propozojnë nga një anëtarë, në përputhje me formulën e përfaqësimit proporcional (p.sh. një përfaqësues për çdo 10 anëtarë të kuvendit komunal).

Nga të cekurat më lartë, i propozohet Kuvendit të Komunës që ta aprovojë këtë propozim-vendim, ashtu siç është paraqitur në dispozitivin e tij.

Asociacioni I Komunave të Kosovës
Asocijacija Kosovskih Opština
Association of Kosovo Municipalities

**ASOCIACIONI I KOMUNAVE TË KOSOVËS**

| | |
|---|---|
| Për: | **Kryetarin e Komunës dhe Kryesuesin/en e Kuvendit të Komunës** |
| Nga: | **Sazan Ibrahimi – Drejtor Ekzekutiv, Asociacioni I Komunave të Kosovës** |
| Data: | **10 Shkurt 2026** |
| Subjekti: | **Formula për zgjedhjen e delegatëve të Komunës për Kuvend të AKK-së** |

**I nderuar Kryetar,**

**I/E nderuar Kryesues/e i/e Kuvendit të Komunës,**

Sipas Statutit të Asociacionit të Komunave të Kosovës, numri i delegatëve për Kuvend të AKK-së është caktuar në bazë të kritereve të shënuara në vijim:

Përveç Kryetarit të Komunës, komunat i delegojnë për çdo 10 anëtar të KK-së, 1 (një) përfaqësues në Kuvendin e AKK-së. Kërkohet edhe përfaqësimi i partive politike dhe përfaqësimi gjinor.

Në Kuvend marrin pjesë edhe përfaqësuesit e minoriteteve në pajtim të një marrëveshjeje të Kryetarëve të Komunave (numri dhe përkatësia në bazë të përfaqësimit të tyre në KK).

Komunat do t'i zgjedhin përfaqësuesit e tyre në Kuvendin e Komunës, në proporcion me numrin e votave që partia i ka fituar në Kuvendin Komunal.

Kjo formulë e përfaqësimit është aplikuar që nga fillimi.

**Me respekt,**

**Sazan Ibrahimi**

**Drejtor Ekzekutiv i Asociacionit të Komunave të Kosovës**

Rr."Gustav Mayer" Nr.5 Tel: 038/ 245 732 038/ 245 734 038 245 735 Fax: 038/ 245 733
**www.komunat-ks.net**

**Bastri Duraku**

| | |
|---|---|
| **From:** | Bujar Shatrolli |
| **Sent:** | Wednesday, February 11, 2026 11:06 AM |
| **To:** | Bastri Duraku; Mirjeta Duraku |
| **Subject:** | Fwd: Propozim - Formula për zgjedhjen e delegatëve të Komunës për Kuvend të AKK-së |
| **Attachments:** | Formula e zgjedhjes se delegatit per Kuvend te AKK-se.pdf |

Sent from my iPhone

Begin forwarded message:

> **From:** Safete Beqiri <safetebeqiri@komunat-ks.net>
> **Date:** February 11, 2026 at 11:04:11 GMT+1
> **To:** Ferit Idrizi <Ferit.Idrizi@rks-gov.net>, Bujar Shatrolli <bujar.shatrolli@rks-gov.net>
> **Subject: Propozim - Formula për zgjedhjen e delegatëve të Komunës për Kuvend të AKK-së**
>
> Caution! This message was sent from outside your organization. Allow sender | Block sen
>
> **I nderuar Kryetar,**
>
> Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK) ju fton që, në përputhje me Statutin dhe rregullat e brendshme të AKK-së, të emëroni delegatët e Komunës Suaj për përfaqësim në Kuvendin e Përgjithshëm të AKK-së.
> Bashkangjitur gjeni **Propozim-Formulën** për zgjedhjen e delegatëve të Komunës për Kuvendin e AKK-së.
> Në bazë të kësaj Propozim-Formule, si dhe duke u mbështetur në rezultatet e zgjedhjeve të fundit për Kuvendin Komunal,propozohet që Komuna Juaj të përfaqësohet nga:
>
> - PDK– një anëtar të Kuvendit Komunal
> - LVV – një anëtar i Kuvendit Komunal
> - LDK– një anëtar i Kuvendit Komunal
>
> Ju njoftojmë se kjo është vetëm **formulë orientuese/propozuese** e AKK-së. Megjithatë, dëshirojmë të theksojmë se vendimin final për përfaqësim e marrin Kuvendet Komunale përkatëse, dhe se delegimi i përfaqësuesve duhet të miratohet me vendim formal nga Kuvendi Komunal, në përputhje me procedurat ligjore dhe statutore.
>
> Ju lutemi që pas miratimit në Kuvendin Komunal, vendimin zyrtar me emrat e delegatëve të përzgjedhur ta dërgoni në adresën elektronike:safetebeqiri@komunat-ks.net
> Duke ju falënderuar për bashkëpunimin, ju dëshirojmë suksese dhe punë të mbarë!

Me respekt,

Safete Beqiri
Asistente e Administratës
Asociacioni I Komunave të Kosovës
Tel: +381 38 / 245-734
Fax: +381 38/245-733
www.komunat-ks.net
safetebeqiri@komunat-ks.net

Republika e Kosovës

Komuna Vushtrri

**Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale**

| | |
|---|---|
| **PËR/ZA/TO:** | **Komitetin për Politikë dhe Financa – Kuvendin Komunal** |
| **NGA /OD/FROM** | **Z. Lorik Maxhuni, Drejtor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale** |
| **PËRMES:** | **Kryetarit të Komunës z. Ferit Idrizi** |
| **TEMA/SUBKJEKAT/SUBJECT** | **Informatë për shërbimet shëndetësore për vitin 2025 në Komunën e Vushtrrisë** |
| **DATË/DATUM/DATE** | **06.02.2026** |

Të nderuar,

Po ju përcjelli informatën për shërbimet shëndetësore për vitin 2025 në Komunën e Vushtrrisë.

Ju faleminderit në mirëkuptim!

*Komuna  e Vushtrrisë* *Q.K.M.F''Dr.Safet Idrizi''Vushtrri*

**REPUBLIKA E KOSOVËS**

**KOMUNA E VUSHTRRISË**

**DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE PËRKUJDESJE SOCIALE**

# Informatë për shërbimet shëndetësore për vitin 2025 në  Komunën e Vushtrrisë

***Shkurt 2026***

## I- HYRJE

Informata për gjendjen në shëndetësi në kuadër të Kujdesit Parësor Shëndetësor (KPSH) të Komunës së Vushtrrisë, paraqet planin gjithëpërfshirës të organizmit dhe funksonimit të KPSH, me të cilin ofrohen informatat e nevojshme për shërbimet e ofruara.

D.SH.P.S dhe menaxhmenti i QKMF-së bazuar në Ligjin për Shëndetësi, U/A për K.P.Sh, Statutin e QKMF në Vushtrri dhe në zbatueshmëri me planin e veprimit janë të përkushtuar maksimalisht që të ofrojn shërbime shëndetësore cilësore, ku përfshihen ato promovuese, parandaluese, diagonstikuese, trajtuese dhe paliative, duke përfshirë në procesin e përkujdesjes shëndetësore për të gjitha komunitetet që jetojnë në komunën e Vushtrrisë.

Përkujdesja shëndetësore organizohet duke u bazuar në nevojat dhe kërkesat e popullatës, me synim përimirësimin e vazhdueshëm të ofrimit të shërbimeve shëndetësore.

Organizimi i KPSH bazohet në Ligjin për Shëndetësi, aktet nën ligjore të Ministrisë së Shëndetësisë, Statutin e Komunës dhe Statutin e QKMF-së. Me ligjin për vetqeverisjen lokale përgjegjësia për organizimin dhe kompetencat në KPSH i takojn nivelit lokal të qeverisjes.

QKMF-ja është përgjegjës për organizimin, implementimin e konceptit të Mjekësisë Familjare, si dhe sigurimin e vazhdimësisë të përkujdesjes shëndetësore për popullatën me objektivë kryesorë, përmirësimin e shëndetit të popullatës, duke ju ofruar shërbime të qasëshme, gjithëpërfshirëse si dhe shërbime të cilësisë së lartë.

## II- BASHKËPUNIMI ME DONATOR

Gjatë vitit 2025 Komuna Vushtrrisë - DSHPS dhe QKMF kemi arritur bashkëpunim të shkëlqyeshëm me donator për realizimin e projekteve me bashkëfinancim.

- Bashkëpunimi me donatorin AQH e Zvicrës, është duke vazhduar në kuadër të zhvillimit të edukimit të vazhdueshëm profesional.
- Bashkëfinancimi me OJQ AQH për renovimin e hyrjes së laboratorit sipas marrëveshjes 80% të vlerës të financuar nga donatori, kurse 20 % të vlerës nga Komuna e Vushtrrisë.
- Financimi për pajisje mjekësore nga Operatori Ipko me paisje mjekësore vlera e përafërt sipas marrëveshjes 17,000.00 €uro, ku janë të përfshira : 2 Ultrazë mobil, 2 karrige për pacient për Laborator për marrjen gjakut, dy firgorifer profesional për reagensa.
- Komuna e Vushtrrisë, përkatësisht Drejtoria e Shëndetësisë, ka realizuar një bashkëpunim të rëndësishëm me donatorin Islamic Relief Kosova, me qëllim të sigurimit të aparaturës së mamografisë për institucionet shëndetësore të komunës. Ky bashkëpunim paraqet një hap domethënës në avancimin e shërbimeve shëndetësore dhe në përmirësimin e diagnostikimit të hershëm të sëmundjeve të gjirit, veçanërisht për gratë e Komunës së Vushtrrisë.
- DSHPS Komuna Vushtrri dhe Islamic Relief me seli në Prishtinë ka vazhduar projektin i cili ka pasur nismën dhe funksionalizimin në vitin 2017, në bazë të nevojave dhe kërkësave të qyetarëve në fushën e shëndetësisë për projektin e vizitave shëndetësore në shtëpi, ku kemi përmisuar dhe rritur kapacitetet për funksionalizim më të mirëfillt, për përkujdesjen ndaj qytetarëve të ofrimit të shërbimeve shëndetësore në krahasim me vitet e kaluara, me numrin e stafit profesional mjekësor të angazhuar 7 ditë të javës /13 orë, me dy ekipe mjekësore të përbëra nga 1 mjek dhe dy infermier, me dy vetura.

  Po ashtu bazuar në marrëveshjen stafi aktual profesional është 7 mjek, 14 infermier, 2 teknik laborant dhe 1 asistent stomatologu.

- Në bashkëpunim me AMC kemi vazhduar projektin për vizitat shtëpiak për nëna dhe fëmijë deri në moshën 3 vjeçare dhe me të arriturat sipas planprogramit jemi shpërblyer inventar dhe pajisje te nevojshme per realizimin e projektit.

## III- RRJETI I INSTITUCIONEVE SHËNDETËSORE

Aktualisht kujdesi parësor shëndetësor në komunën e Vushtrrisë është i organizuar përmes institucioneve shëndetësore si në vijim:

**Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF) - institucioni themelor i KPSH-së,**

**10 Qendrat të Mjekësisë Familjare (QMF) - si njësi përbërëse të QKMF-së**

**9 Ambulanta të Mjekësisë Familjare (AMF) - si njësi përbërëse të QMF-së**

**Figura 1. Struktura organizative e KPSH-së në Vushtrri**



**QENDRA KRYESORE E MJEKËSISË FAMILJARE**

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF) ’’Dr.Safet Idrizi’’ në Vushtrri është institucioni shëndetësor kryesor që ofron dhe zbaton Kujdesin Parësor Shëndetësor publik në gjithë territorin e komunës, sipas U/A për KPSH. QKMF ka obligim ligjor që të kujdeset për qytetarët e komunës për sa i përket Kujdesit Parësor Shëndetësor, nën mbikqyrjen dhe mbështetjen e drejtepërdrejtë të Drejtorisë së Shëndetësisë (DSHPS), të cilës njeherit i raporton për të arriturat apo sfidat, duke i zgjedhur bashkarisht shqetësimet që hasen gjatë ofrimit të shërbimeve shëndetësore. DSHPS-së s’bashku me menaxhmentin e QKMF-së caktojnë dhe implementojn politikat shëndetësore për Komunën e Vushtrrisë.

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare është përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve shëndetësore për të gjithë qytetarët e komunës pa dallim etnije, gjinie, relegjioni, race etj.
Promovimin shëndetësor, parandalimin, mjekimin, shërimin dhe rehabilitimin,
Promovim: informim, komunikim dhe edukim në institucione, shkolla dhe komunitete,
Parandalim: imunizimin/vaksinimin, monitorim të rritjes dhe zhvillimit të fëmijëve përmes vizitave sistematike, mjekim: përcaktimin e diagnozës fillestare dhe kujdesin elementar shëndetësor, kujdesin akut përfshirë ofrimin e kujdesit urgjent, mbikqyrjen dhe transportin deri në institucionet përkatëse, rehabilitim: kujdesi paliativ/terminal.

**QKMF është e organizuar në dy departamente si :**

Departamentin e Mjekësisë Familjare

Departamentin e Administratës dhe Personelit

Barnatorja Qendrore

**Në kuadër të QKMF-së funksionojn edhe njësitë funksionale të ndara në sektore:**

Sektori i Mjekësisë Familjare

Sektori i Shëndetit publik

Njësia e SISH

Njësia e Vaksinimit dhe Imunizimit

Sektori i Shëndetit Oral Preventiv,

Sektori i Urgjencës

Sektori i Diagnostikës.




**LEGJENDA :**

**Q.K.M.F** – Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare

**M.F** – Qendra e Mjekësisë Familjare

**A.M.F** – Ambulanca e Mjekësisë Familjare

**Raporti vjetor i shërbimeve shëndetësore janar - dhjetor në QKMF 2025**

Tabela 1. Do të paraqesim në formë tabelare rrjetet e QMF dhe AMF-Janare-Dhjetor 2025 në kuadër të QKMF për vizitat mjekësore .

| | ***Janar-Dhjetor 2025*** | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Nr.** | ***Emri i sherbimit*** | ***Totali*** | ***Meshkuj*** | ***Femra*** | ***Pac. që kanë Particu*** | ***Sherbime*** | ***Referime*** | ***Malinje*** | ***Kronike*** | **Nga Mjeku Privat** | | ***Pa*** |
| | | | | | | | | | | **Inek.** | **Infuzi** | |
| **1** | *QKMF* | 65249 | 30264 | 34985 | 13754 | 210753 | 2954 | 105 | 3753 | 3243 | 4608 | |
| **2** | *Urgjenca* | 35528 | 16555 | 18973 | 6529 | 170824 | 4431 | 330 | 6476 | 1944 | 2804 | |
| **3** | *Laboratori* | 15360 | 6307 | 9053 | 4119 | 149996 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | |
| **4** | *Stomatologjia* | 7812 | 3659 | 4153 | 1179 | 31711 | 157 | 0 | 0 | 190 | 0 | |
| **5** | *RTG* | 5667 | 2649 | 3018 | 1655 | 16013 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | |
| **6** | *Rtg e dhembit* | 371 | 143 | 228 | 79 | 881 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | |
| **7** | *Vaksinimi* | 4966 | 2692 | 2274 | 0 | 12567 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | |
| **8** | *QMF-1* | 65614 | 30619 | 34995 | 18240 | 244779 | 5040 | 215 | 3676 | 2379 | 2609 | |
| **9** | *QMF-2* | 6157 | 2741 | 3416 | 1016 | 38083 | 410 | 0 | 466 | 580 | 458 | |
| **10** | *QMF-3* | 7567 | 3604 | 3963 | 1696 | 49689 | 42 | 0 | 1274 | 258 | 208 | |
| **11** | *QMF-AMF* | 23508 | 10674 | 12834 | 4203 | 95415 | 4105 | 103 | 2750 | 802 | 696 | |
| **12** | *Mamografia* | 77 | 0 | 77 | 0 | 390 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | |
| | **Gjithsejt** | *237876* | *109907* | *127969* | *52470* | *1021101* | *17139* | *753* | *18395* | *9396* | *11383* | |

**Tabela 2. QMF dhe AMF, 12 mujori për vizitat mjekësore dhe shërbime 2025.**

| | *QMF-AMF* | *Totali* | *M* | *F* | *Referimet* | *Participim* | *Shërbime tjera* | *Vizita me kartele* | *S.Malinje* | *S.Kronike* | Nga Mjeku F | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | | | | I.M | In |
| *QMF dhe AMF* | *QMF Lumadh* | 7381 | 3559 | 4251 | 291 | 1589 | 40719 | 555 | 41 | 492 | 534 | |
| | *QMF Smrekonicë* | 3287 | 1793 | 1655 | 713 | 713 | 12990 | 75 | 10 | 426 | 58 | |
| | *QMF Pantinë* | 2391 | 1131 | 1390 | 917 | 476 | 10345 | 0 | 33 | 501 | 28 | |
| | *QMF Druar* | 1918 | 983 | 1029 | 829 | 318 | 5886 | 61 | 3 | 37 | 12 | |
| | *QMF Novolan* | 839 | 464 | 418 | 103 | 1 | 2591 | 2 | 0 | 145 | 18 | |
| | *QMF Maxhunaj* | 3602 | 1937 | 1884 | 717 | 923 | 11674 | 0 | 0 | 370 | 69 | |
| | *QMF Dumnicë* | 549 | 256 | 316 | 187 | 47 | 2991 | 0 | 0 | 24 | 20 | |
| | *AMF Samadrexhë* | 1239 | 631 | 683 | 276 | 38 | 8501 | 183 | 0 | 296 | 37 | |
| | *AMF Strovc* | 739 | 356 | 414 | 204 | 82 | 2445 | 54 | 3 | 105 | 17 | |
| | *AMF Pasomë* | 569 | 282 | 303 | 6 | 6 | 2590 | 112 | 0 | 40 | 2 | |
| | *AMF Oshlan* | 368 | 208 | 166 | 15 | 3 | 554 | 23 | 0 | 0 | 2 | |
| | *AMF Beçiq* | 252 | 144 | 108 | 71 | 3 | 410 | 0 | 0 | 6 | 0 | |
| | *Amf Dubovc* | 64 | 35 | 29 | 5 | 0 | 97 | 0 | 0 | 2 | 0 | |
| | *AMF Ceceli* | 310 | 131 | 188 | 71 | 4 | 2316 | 0 | 0 | 53 | 5 | |
| | *Gjithsej:* | **23508** | **11910** | **12834** | **4405** | **4203** | **104109** | **1065** | **90** | **2497** | **802** | |

- ***SHËNDETI PUBLIK***

***Është përgjegjës për shëndetin publik, imunizim dhe vaksinim dhe për Sistemin Informativ Shëndetësor, ky sektor përcjell gjendjen epidemiologjike në bazë të raporteve kthyese nga IRSHP dhe bashkë me ta vepron në rast se kërkohet apo dyshohet në ndonjë epidemi.***

***Sëmundjet ngjitëse sipas IKSHPK Mitrovicë.***

**Tabela 4. Numri i rasteve te sëmundjeve ngjitëse sipas IKSHPK Mitrovicë për komunën e Vushtrrisë,**

| SËMUNDJA / KOMUNA | Pneumonia/ARI | ILI | Diarrhea ac | Varicella | Influenca A | Influenca B | COVID-19 | Sindroma meningeale: Meningjit serosa | Sindroma meningeale: Meningoencephalit ac. | **Morbilli | Parotitis epidemica | Pertussis | Hepatit ac. B | Hepatit ac. C | Helmimet me ushqim | Brucelloza | Tularemi | Salmonelloza | E.coli | IST | HIV | TB | Infeksionet streptokokike të gr | Sëm.t jera ngjitëse | Erizipela | Totali |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| MITROVICË | 700 | 9225 | 7820 | 354 | 145 | 240 | 1 | 2 | 2 | | 3 | 2 | 5 | 3 | 74 | | | 8 | | 3 | 1 | 18 | | 108 | 2 | 18716 |
| MITROVICË E V. | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| SKËNDERAJ | 166 | 1044 | 1658 | 69 | | | | 1 | | 1 | | | | | 167 | | | | | 1 | | 2 | | | | 3109 |
| VUSHTRRI | 339 | 1435 | 1262 | 152 | | | 1 | 4 | 1 | | 5 | 3 | 2 | 1 | 30 | 3 | 3 | 2 | 7 | | | 19 | 3 | 423 | | 3695 |
| Z. POTOK | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| ZVEÇAN | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| TOTALI | 1205 | 11704 | 10740 | 575 | 145 | 240 | 2 | 7 | 3 | 1 | 8 | 5 | 7 | 4 | 271 | 3 | 3 | 10 | 7 | 4 | 1 | 39 | 3 | 531 | 2 | 25520 |

*Sëmundjet tjera ngjitëse: , Herpes zoster, Mykozat, Mononucleoza

** Raste të importuara - Malarie, Mpox, Morbiill

- ***Sektori i Vaksnimit dhe imunizimit :***

***Vaksnimi i rregullt tek fëmijët dhe të moshuarit:***

Shërbimi i vaksinimit gjatë kësaj periudhe ka qenë i furnizuar me vaksina mjaftueshëm dhe është kryer në bazë të planit në qytet si dhe në fshatra.

**Tabela 4. Paraqet administrimin e vaksinave në 6 qendrat e KPSH si më poshtë:**

| Raporti i Shërbimit të Vaksinimit 2025 | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Totali | M | F | QKMF | QMF-1 | QMF-2 | Lumadh | Maxhunaj | Pantine | Smrekonic | Sher |
| Janar | 383 | 202 | 181 | 186 | 103 | 32 | 28 | 17 | 17 | 0 | |
| Shkurt | 338 | 196 | 142 | 181 | 105 | 21 | 17 | 0 | 14 | 0 | |
| Mars | 405 | 231 | 174 | 174 | 116 | 38 | 28 | 10 | 19 | 23 | |
| Prill | 481 | 258 | 223 | 216 | 145 | 47 | 29 | 11 | 19 | 14 | |
| Maj | 455 | 225 | 230 | 217 | 138 | 36 | 32 | 17 | 15 | 0 | |
| Qershor | 461 | 246 | 215 | 221 | 169 | 32 | 9 | 3 | 15 | 12 | |
| Korrik | 464 | 255 | 209 | 232 | 136 | 29 | 31 | 18 | 3 | 15 | |
| Gusht | 383 | 187 | 196 | 179 | 143 | 22 | 19 | 7 | 13 | 0 | |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Shator | 445 | 268 | 177 | 205 | 158 | 32 | 26 | 14 | 10 | 0 |
| Tetor | 418 | 213 | 205 | 186 | 150 | 32 | 27 | 14 | 9 | 0 |
| Nentor | 353 | 197 | 156 | 160 | 130 | 26 | 21 | 7 | 9 | 0 |
| Dhjetor | 380 | 214 | 166 | 180 | 125 | 25 | 22 | 11 | 13 | 4 |
| **Gjithsej** | **4966** | **2692** | **2274** | **2337** | **1618** | **372** | **289** | **129** | **156** | **68** |

**Tabela 6. Paraqet Vaksinat kundër gripit sezonal që janë administruar:**

| *Nr.* | **Përshkrimi** | **Vaksina** |
|---|---|---|
| **1** | Vaksina kundër gripit sezoal | 2430 |

Menaxhimi i zingjirit te ftohtë është sipas standardeve, paisjet për standardizim dhe arritjen e kushteve maksimale të respektimit të zingjirit te ftohtë është në nivelin e duhur.

***Tabela nr.7 Pasqyra e përfshirjes së nxënësve të vaksinuar 2025:***

| Pasqyra e përfshirjes së nxënësve në vaksinim | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | Nxënës të planifikuar | | Kanë refuzuar | | Vaksina të administruara | |
| SHFMU | Nr.nxënësve | % | Nr.nxënësve | % | Nr.nxënësve | |
| **Klasa I** | 941 | 100% | 40 | 4.25% | 901 | 95.75 % |
| **Klasa VI** | 945 | 100% | 119 | 12.59 % | 826 | 87.41% |
| **Klasa XII** | 660 | 100% | 10 | 1.51 % | 650 | 98.46 % |
| **Totali** | 2546 | 100% | 169 | 6.63 % | 826 | 93.36% |

**Për herë të dytë është administruar vaksina HPV te vajzat e moshës 12 vjeçare dhe tek djemët të moshës 12 vjeçar.**

**Ka pasur hezitim për marrjen e vaksinës në fjalë, por fal angazhimit të ekipës rezultati ka qenë i i kënaqshëm, por në këtë drejtim duhet të punohet ende.**

**Të planifikuar kanë qenë 945 nxenese, të vaksinuara janë 422 femra dhe 404 djem statistikat me përqindje janë të paraqitura në tabelë nr.7 të klasëve të VI.**

**Vizitat sistematike të nxënësve të klasave të para, pesta dhe të nënta në SHFMU-të të Komunës së Vushtrrisë.**

**Qëllimet e vizitave sistematike**

1. Vlerësimi i nivelit të rritjes dhe zhvillimit të grupmoshës së caktuar, përkatësisht nxënësve të klasave të para, pesta dhe të nënta të shkollave fillore .
2. Njohja dhe identifikimi i veçorive specifike të problemeve shëndetësore të këtyre grupmosha, që do të mundëson zbulimin e hershëm të sëmundjeve dhe anomalive/çrregullimeve eventuale të fëmijët.
3. Dizajnimi dhe organizimi i intervenimeve me natyrë preventive, të bazuara në shkolla dhe komunitet.
4. Krijimi i një baze të te dhënave nga rezultatet e vizitave të realizuara e cila do të mbështesë modifikimin dhe përpilimin e politikave shëndetësore më favorizuese për fëmijët.

**Parametrat e vlerësuar:**

Është vlerësuar zhvillimi i përgjithshëm psikofizik dhe shëndeti oral

Kronologjia e aktiviteteve

**Tabela 8. Pasqyra e përfshirjes së nxënësve në vizita sistematike**

| Pasqyra e përfshirjes së nxënësve në vizita sistematike | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | |
| **SHFMU** | **Nxënës të planifikuar për vizita sistematike** | | **Munguar** | | **Vizita të realizuara** | |
| | **Nr. I nxënësve** | **%** | **Nr. I nxënësve** | **%** | **Nr. I nxënësve** | **%** |
| Klasat I | 883 | 100 | 9 | 1% | 874 | 99% |
| Klasat V | 891 | 100 | 34 | 4% | 857 | 96% |
| Klasat IX | 949 | 100 | 58 | 6% | 891 | 94% |
| **Gjithsejtë** | **2723** | **100** | **101** | **4%** | **2622** | **96%** |

Tabela nr. 1- Pasqyrë e përfshirjes së nxënësve në vizita sistematike

Nga gjithsejtë 2723 nxënës të planifikuar për vizita , vizita të realizuara janë 2622 apo 96%, ndërsa numri i nxënësve të cilët kanë munguar është 101 apo 4% .

Shkalla e realizimit të vizitave është paraqitur në tabelën dhe në grafikoni nr.1.




Grafiku nr. 1- Shkalla e realizimit të vizitave sistematike të nxënësve të klasave të para,pesta dhe të nënta.

**Raporti gjinor i nxënësve të vizituar** :

| Raporti gjinor i nxënësve të përfshirë në vizita sistematike | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | |
| **SHFMU** | **Nxënës të vizituar** | | **Meshkuj** | | **Femra** | |
| | **Nr. I nxënësve** | **%** | **Nr. I nxënësve** | **%** | **Nr. I nxënësve** | **%** |
| Klasat I | 874 | 100 | 495 | 57% | 379 | 43% |
| Klasat V | 857 | 100 | 448 | 52% | 409 | 48% |
| Klasat IX | 891 | 100 | 452 | 51% | 439 | 49% |
| **Gjithsejtë** | **2622** | **100** | **1395** | **53%** | **1227** | **47%** |

Tabela nr. 2. - Raporti gjinor i nxënësve të vizituar

Janë vizituar gjithsejtë **Meshkuj 1395 (53%) dhe vajza 1227 (47%).** Struktura gjinore e nxënësve të vizituar , paraqitet në tabelën nr. 2. dhe në grafikun nr. 2.




Grafiku nr. 2- Struktura gjinore e nxënësve të klasave të para , pesta dhe të nënta të Shkollave Fillore.

## VLERËSIMI I REZULTATEVE

**Nga vlerësimi i rezultateve të dala nga vizitat sistematike të nxënësve të klasave të para,pesta dhe të nënta ,mund të konstatohet se në përgjithësi kemi të bëjmë me një kategori të popullatës( nxënës) të shëndoshë ,përjashtimisht problemeve të shëndetit oral , patologjive refraktare të syve .**

**Përndryshe ,shkalla e përgjithshme e shprehur në përqindje e parametrave të vlerësuar me veçori patologjike në shumicën e parametrave është shumë e vogël përjashtimisht dyshimit në çrregullimet refraktare të syve,mbipeshës, kariesit të dhëmbëve të qumështit dhe higjienës jo të mirë orale dhe rasteve të dyshuara me VCC.**

Higjiena orale e nxënësve nuk është e mire, e shprehur në përqindje nga numri total I nxënësve të kontrolluar ,del se 48.4% e tyre janë me nivel të ulët të higjienës orale. Gjendja e mukozës dhe gingivave me veçori patologjike prezanton të jetë 1.1% nga numri total i nxënësve të vizituar.

Sa i përket zhvillimit të përgjithshëm psikofizik , veçori patologjike në shkallë më të madhe janë konstatuar të të pamurit e të cilat kanë të bëjnë kryesisht me anomali refraktare( ametropia).

Nga numri i përgjithshëm i nxënësve të kontrolluar (2622 nxënës) , shkalla e përgjithshme e veçorive patologjike të të pamurit arrin në **17.7%(**465 nxënës),ndërsa numri i nxënësve të cilët bartin syze për korrektim të refrakcionit është 163, përkatësisht 6.2%.

Statusi psikik- Nga numri i përgjithshëm i nxënësve të kontrolluar, në aspektin psikik, nga numri total i nxënësve të ekzaminuar (2622), si raste të dyshimta me veçori patologjike janë 59 nxënës (2.3%).Veçoritë patologjike të identifikuara adresohen kryesisht në drejtim të çrregullimit të mësuarit dhe mungesës së vëmendjes.

Gjatë ekzaminimit të të dëgjuarit nuk kemi gjetur raste patologjike të cilat do të konsideroheshin si shumë relevante dhe të besueshme ,për shkak se nuk kemi pasur hapësirat adekuate për te kryer ekzaminimet për dëgjim . Janë të dyshuar 15 nxënës (0.6%) .

Zemra- nga numri i përgjithshëm i nxënësve të kontrolluar, 9 nxënës (0.3%) janë të dyshuar për veçori patologjike të zemrës.

Gjatë evoluimit të projektit , të SWOT analiza u përmenden disa rreziqe të cilat do të reflektonin dukshëm në mundësinë e mos arritjes së rezultatit të pritur apo zëvendësimin e tij me ndonjë rezultat tjetër, atëherë shtrohet pyetja se cili do të duhej të ishte menaxhimi i supozimeve dhe rreziqeve në këtë rast:

1. Supozimet dhe rreziqet e rëndësishme veç janë identifikuar(sidomos pika 2,3,4 dhe 5);

2. Të minimizohen gjasat e rrezikut apo të eliminohet rreziku( në këtë rast rreziku për mos arritje të rezultatit të dëshiruar është nga faktori njeri, gjegjësisht nga të gjitha palët e interesit : drejtori i shkollës; mësimdhënësi, prindi si dhe nga ekipi zbatues i projektit).

3. Meqenëse neve në këtë rast po na mungon informata kthyese mbi numrin e nxënësve të cilët i kemi referuar si raste të dyshimta ,atëherë që të minimizohet apo të eliminohet rreziku ,hartuesi dhe zbatuesi i projektit duhet që më fillimin e vitit të ri shkollor serish të bëjë ri monitorim për secilin rast të dyshuar dhe në secilën shkollë në mënyrë që rastet eventuale të cilat kanë qenë të referuara për ekzaminim të mëtejmë të identifikohen dhe të realizohen këto ekzaminime.

## VI . REKOMANDIMET

Duke u bazuar në rezultatet e nxjerra nga vizitat sistematike ,janë nxjerrë rekomandimet si në vijim:

1. Promovimi i shëndetit oral dhe i kujdesit shëndetësor parandalues për ruajtjen e shëndetit të dhëmbëve nëpër shkolla, çerdhe dhe Qendrat e Mjekësisë Familjare,duke demonstruar teknikën e pastrimit të dhëmbëve,me qellim të parandalimit të kariesit të dhëmbëve.;
2. Vulosja e dhëmbëve të përhershëm dhe dhëmbëve të qumështit;
3. Fluorizimi i dhëmbëve;
4. Rritja e numrit të mjekëve Stomatolog në QKMF ku do të ofrohen shërbimet e stomatologjisë preventive dhe kurative më të avancuara të cilat janë më se të domosdoshme;
5. Hapja e ordinancave stomatologjike nëpër disa QMF-re në zonat rurale;

6. Organizimi i kampanjave për edukimin dhe këshillimin e prindërve,fëmijëve parashkollor , fëmijëve nëpër kopshte të tyre dhe nxënësve nëpër shkolla lidhur me mënyrën e drejtë dhe të shëndetshme të ruajtjes së dhëmbëve dhe të ushqyerit e shëndetshëm;
7. Intensifikimimi i bashkëpunimit ndërmjet infermiereve të QKMF- ve dhe infermiereve për edukim të komunitetit me Institutin e Shëndetit Publik ,si dhe shpërndarja e broshurave për ushqyeshmërinë dhe të ushqyerit e drejtë;
8. Promovimi i stilit të shëndetshëm të jetës;
9. Inicimi i një bashkëpunimi ndërmjet mësimdhënësve dhe profesionistëve shëndetësor për hulumtimin ,paraqitjen dhe menaxhimin e rasteve me çrregullime shëndetësore;
10. Vizitat sistematike të vazhdohen edhe në vitin e ardhshëm , për klasën e I, V, IX.
11. Të shikohet mundësia e përmirësimit të higjienës në shkolla duke rregulluar infrastrukturën e nyejve sanitare,rrjetit të kanalizimit dhe furnizimin e rregullt me ujë.
12. Edukimi i fëmijëve për bartje të çantës dhe të qëndrimit në bankë.
13. Përqendrimi mbi shkaqet rrënjësore të problemeve të identifikuara dhe hartimi i strategjisë për adresim të sakët të problemeve duke maksimalizuar përpjekjet për parandalim të devijimeve të cilat janë të parandalueshme dhe për përmirësim të gjendjes.

## ROLI DHE RËNDËSIA E SISTEMIT INFORMATIV SHËNDETËSOR

Sistemi Informativ Shëndetësor (SISH) paraqet një komponent thelbësor në funksionimin e shërbimeve shëndetësore parësore. Ai mundëson:

- Regjistrimin elektronik të pacientëve
- Evidentimin e vizitave mjekësore dhe stomatologjike
- Menaxhimin e të dhënave për imunizim dhe vaksinim
- Përgatitjen e raporteve mujore dhe vjetore
- Monitorimin e sëmundjeve kronike dhe ngjitëse

Gjatë vitit 2025, SISH ka qenë mjeti kryesor për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave shëndetësore në QKMF Vushtrri dhe njësitë vartëse.

## FUNKSIONIMI I SISH NË QKMF VUSHTRRI

Në vitin 2025, Sistemi Informativ Shëndetësor është përdorur në mënyrë të vazhdueshme dhe active në të gjitha sektorët e QKMF Vushtrri, përfshirë:

- Mjekësinë Familjare
- Shërbimet Stomatologjike
- Tretmanin dhe shërbimet infermierore
- Infuzionet
- Lidhetoret
- Imunizimin dhe Vaksinimin

Sistemi ka funksionuar si platformë unike për regjistrimin e shërbimeve dhe ka kontribuar në standardizimin e punës dhe rritjen e transparencës institucionale.

---

## SHPËRNDARJA DHE AKTIVIZIMI I SISTEMIT BHIS

### Qendrat e Mjekësisë Familjare (QMF)

Gjatë vitit 2025, sistemi BHIS ka qenë i aktivizuar dhe funksional në këto QMF:

- QMF 1 Vushtrri
- QMF 2 Vushtrri
- QMF 3 Vushtrri
- QMF Lumadh
- QMF Pantinë
- QMF Smrekonicë
- QMF Maxhunaj
- QMF Druar
- QMF Novolan
- QMF Dumnicë

Në të gjitha këto qendra është funksional edhe moduli i BHIS, duke mundësuar raportim të saktë dhe në kohë reale.

### Ambulancat e Mjekësisë Familjare (AMF)

Sistemi BHIS është aktiv edhe në këto AMF:

- AMF Samadrexh
- AMF Strovc
- AMF Ceceli
- AMF Pasomë
- AMF Oshlan
- AMF Beçiq nuk është funksionale
- AMF Dubovc nuk është funksionale

Aktivizimi i sistemit në AMF ka ndikuar në përmirësimin e mbledhjes së të dhënave në zonat rurale.

---

## MIRËMBAJTJA TEKNIKE DHE SIGURIA

Gjatë vitit 2025 janë realizuar aktivitete të shumta teknike, të cilat përfshijnë:

- Montimin e kamerave të sigurisë
- Konfigurimin e sistemeve të monitorimit
- Mirëmbajtjen dhe testimin e pajisjeve

Këto aktivitete janë kryer në:

- QMF 1 Vushtrri
- QMF 2 Vushtrri

Kjo ka ndikuar në:

- Rritjen e sigurisë së objekteve shëndetësore
- Mbrojtjen e stafit dhe pacientëve

- Parandalimin e dëmtimeve dhe incidenteve

- **SEKTORI I SHËNDETIT ORAL**

***Në sektorin e shëndetit oral preventiv janë vizituar gjithsejt 8694 pacient dhe ka dhënë* 39608 *shërbime. Këtu përfshihet këshilla mjekësore, nxjerrja e dhëmbëve, shërimi, bllombimi dhe pastrimi i gurëzve në dhëmbë. Punohet nga ora $07^h$ deri në ora $20^h$ në QKMF dhe në QMF-1, ndërsa në QMF-2 dhe QMF-3 nga ora $07^h$ deri në ora $14^h$, QMF Lumadh dhe QMF Pantinë. Kujdestaria mbahet në QMF-1 në ditën e shtunë nga ora $07^h$ deri ne ora $19^h$.***

**Shërbimet për nxjerrjen e dhëmbit**: Caktimi i diagnozës, dhënia e anestezionit, eks. Dhëmbit, tamponade e alveolës, këshilla për pacientin.
**Shërmbimet për vizita:** caktimi i diagnozës, aplikim local me udhëzim për rtg dhe terapia e përgjithshme.

**Shërbimet për shërimin e karriesit:** caktimi i diagnozës, dhënia e anestezionit, preparimi i kavitetit, vendosja e shtresës ( me ose pa kalcimol), vendosja e bllombës dhe polirimi dhe korigjimi I pikave kontaktuese.

**Shërbimet te pulpitet e dhëmbëve:** caktimi i diagnozës, dhënia e anestezionit, preparimi i kavitetit deri në hyrje të kanaleve, eksterpimi i pulpës, mbushja e kanalit dhe vendosja e bllombës.

**Shërmbimet te gjakëderdhja pas nxerrjes së dhëmbit**: caktimi i diagnozës, dhënia e anestezionit, kiretazha e alveolës, vendosja e hemostatikut dhe tamponade e alveolës.
**Trajntimi i gingiviteve**: largimi i pigmenteve të buta dhe të forta me kavitron dhe past me brush.
***Bazuar në statistikat sipas regjistrit të popullësise të vitit 2024 në ASK komuna e Vushtrrise ka gjithësej 61528 banor, KPSH në Vushtrri ka gjithësejt 10 stomatolog, sipas U/A 6000 banor për një stomatolog.***

**Tabela 9. Paraqet Shërbime në sektorin e shëndetit oral preventive duke përfshi të gjitha qendrat:**

| Raporti 12 mujor i sherbimit te Stomatologjise 2025 | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Muji** | **Totali** | **M** | **F** | **Prej tyre te para** | **Vizita serike** | **Pa mjekim** | **Me mjekim** | **Dhëmbë të nxjerrë** | **Intervenime tjera** | **Sherbimet** | **Partic** |
| Janar | 843 | 414 | 429 | 848 | 2 | 2 | 341 | 189 | 201 | 4244 | |
| Shkurt | 706 | 323 | 383 | 706 | 6 | 0 | 231 | 120 | 229 | 3161 | |
| Mars | 476 | 226 | 250 | 485 | 0 | 2 | 137 | 110 | 167 | 2139 | |
| Prill | 775 | 372 | 403 | 772 | 5 | 4 | 256 | 175 | 218 | 3281 | |
| Maj | 697 | 328 | 369 | 698 | 0 | 1 | 186 | 151 | 155 | 2976 | |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Qershor | 505 | 226 | 279 | 505 | 2 | 1 | 198 | 108 | 138 | 2114 |
| Korrik | 713 | 353 | 360 | 701 | 0 | 0 | 275 | 151 | 163 | 3134 |
| Gusht | 639 | 324 | 315 | 639 | 0 | 2 | 281 | 133 | 114 | 2900 |
| Shator | 585 | 270 | 315 | 585 | 1 | 5 | 195 | 171 | 162 | 2801 |
Nga muaji janar 2023 projekti konkretisht realizohet me përpikëri sipas marrëveshjes ku kemi 6 ekipe mjekësore të përbërë nga 1 mjek dhe 2 infermier. Puna për ofrimin e shërbimeve mjekësore ditore është kryer sipas këtij plani dy ekipe mjekësore ( 2 mjek dhe 4 infermier), njëri ekip i cili e organizon punën për dhënien e shërbimeve mjekësore në vise urbane, kurse tjetri në vise rurale, me dy automjete, terapinë dhe materialin e nevojshëm për ofrimin e shërbimeve mjekësore, si këshillimin (pacientët me sëmundje kronike, pacientët me sëmundje malinje, shtatzënat dhe lehonat etj.), vizitat mjekësore, marrjen e anamnezës, matjen e tensionit, matjen e glukozës, matjen e saturimit, matjen e pulsit, matjen e temperaturës, përshkrimin e terapisë sipas nevojës, EKG, dhënien e terapisë paranterale ( intravenoze dhe intramuskulare), kateterizimin, pastrim dhe fashim të plagës deri në shërim, referime tek nivelet tjera të kujdesit shëndetësor sipas nevojës.
Orari i punës është 7/13 orë, që do të thotë se punohet 7 ditë të javës me orar 13 orë duke përfshirë edhe vikendet, festat etj.

- Për realizimin e projektit momentalisht janë të angazhuar këto resurse humane:

| Pozita profesionale | Numri i nëpunësve |
|---|---|
| **Doktor të Mjekësisë** | 7 |
| **Infermier të Përgjithshëm** | 14 |
| **Teknik laborant** | 2 |
| **Asistent stomatologu** | 1 |

***Ofrimi i shërbimeve mjekësore për vizitat shtëpiak sipas marrëveshjes së Komunës së Vushtrrisë dhe Islamic Relief Worldvide me seli në Prishtinë.***

- Bazuar në marrëveshjen mes Komunës së Vushtrrisë dhe IRË Kosova, unë jam angazhuar si organ mbikëqyrës, andaj sipas marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Islamic Relief Ëorldëide-Zyra në Kosovë dhe Komuna Vushtrri , në kuadër të realizimit të projektit paraqes raportin janar dhjetor 2025:

**Tabela nr.32 paraqet Raportin janar – dhjetor 2025, i punës për projektin ofrimi i shërbimeve shëndetësore në kujdesi shtëpiak IRW-Komuna Vushtrri**

| Nr. | Periudha kohore | Numri total i vizitave | Meshkuj | Femra | Vizita Shtepiake | Numri I vizitave të pacientëve mbi 65 vjeç | Numri i vizitave lehonave | Numri I vizitave të fëmijëve deri 3 vjeç | Shërbime në vizita shtëpiake | Totali i Shërbimeve |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Janar | 2130 | 947 | 1183 | 1294 | 971 | 45 | 110 | 2257 | 3227 |
| 2 | Shkurt | 2217 | 958 | 1259 | 1032 | 877 | 36 | 116 | 2041 | 5675 |
| 3 | Mars | 2070 | 888 | 1182 | 1148 | 867 | 35 | 111 | 2068 | 4611 |
| | **Totali, TM1** | **6417** | **2793** | **3624** | **3474** | **2715** | **116** | **337** | **6366** | **13513** |
| 4 | Prill | 3021 | 1202 | 1819 | 1074 | 1111 | 28 | 91 | 1908 | 9503 |
| 5 | Maj | 2840 | 1156 | 1684 | 1604 | 750 | 25 | 99 | 2062 | 10788 |
| 6 | Qershor | 1837 | 707 | 1130 | 1336 | 651 | 12 | 52 | 1382 | 4438 |
| | **Totali, TM2** | **7698** | **3065** | **4633** | **4014** | **2512** | **65** | **242** | **5352** | **24729** |
| 7 | Korrik | 2679 | 1044 | 1635 | 1244 | 930 | 35 | 99 | 2058 | 9806 |
| 8 | Gusht | 1578 | 626 | 952 | 1260 | 727 | 10 | 115 | 4401 | 5786 |
| 9 | Shtator | 1354 | 562 | 792 | 1059 | 657 | 18 | 84 | 4229 | 5111 |
| | **Totali, TM3** | **5611** | **2232** | **3379** | **3563** | **2314** | **63** | **298** | **10688** | **20703** |
| 10 | Tetor | 1280 | 531 | 749 | 1169 | 671 | 14 | 79 | 4436 | 4940 |
| 11 | Nentor | 1434 | 586 | 848 | 942 | 612 | 12 | 70 | 3094 | 5883 |
| 12 | Dhjetor | 1407 | 610 | 797 | 992 | 674 | 13 | 53 | 432 | 5949 |
| | **Totali, TM4** | **4121** | **1727** | **2394** | **3103** | **1957** | **39** | **202** | **7962** | **16772** |
| | **Totali vjetor** | **23847** | **9817** | **14030** | **14154** | **9498** | **283** | **1079** | **30368** | **75717** |

- ***DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS***

***Departamenti i Administratës në QKMF, kryen punët sipas planprogramit të paraparë duke respektuar të gjitha procedurat ligjore, si planifikimi preliminar i Buxhetit, Paga dhe Meditje, Mallra dhe Shërbime, Investime Kapitale. Paraqitja e kërkesave dhe specifikacioneve, inicimi i aktiviteteve, ndërsa vështirësitë dhe ngecjet në disa raste kanë qenë te pamundësia që është shkaktuar në procedurat e prokurimit, realizimin e specifikacionit, qasja në e-prokurim .***

***QKMF duke zbatuar Udhëzimin administrative për bashkëpagesat në KPSH, krijon të hyra vetanake.***

***Tabela nr.33 paraqet në formë tabelare të hyrat vetanake 2025:***

| Nr. | **Viti fiskal I të hyrave vetanake janar dhjetor 2025** | **Vlera totale e të hyrave** |
|---|---|---|
| 1 | **Të hyrat vetanake** | **73,488.50 €uro** |
| Vlera | | **73,488.50 €uro** |

***Tabela nr.34 paraqet në formë tabelare të hyrat vetanake 2024/2025, diferencën në rritje:***

| Nr. | Vlera totale e të hyrave 2025 | Vlera totale e të hyrave 2024 | Krahasimi |
|---|---|---|---|
| 1 | **73,488.50 €uro** | **61,263.00 €uro** | **12225.50 €uro** |

- **Shërbimi teknik dhe mbështetës**

***Autoparku***

***Autoparku ka gjithësejt 9 vozitësa. Vozitësat e autoparkut janë të angazhuar në sektorin e urgjencës, të cilët mbajnë kujdestari 12 orëshe dhe janë të koordinuar me stafin professional të ugjencës.***

***QKMF në Vushtrri po ashtu kryen edhe shërbimin e transportit të pacientëve me sëmundje të veshkëve të cilët i transporton në Spitalin e Dializës në Mitrovicë për marrjen e shërbimeve të dializës, po ashtu i transporton prapë në shtëpi, punon në dy ndërrime dhe bënë transportin e***

*26 pacientëve të komunës së Vushtrrisë, në vise rurale dhe urbane për Dializë në Mitrovicë. Po ashtu kemi 3 pacient me gjendje të rëndë të cilët transportohen me autoambulancë.*
*Me autorizim të kryetarit të komunës, gjithnjë bazuar në nevojat e qytetarëve të komunës së Vushtrrisë, ne kemi transportuar edhe pacientët me sëmundje të rënda jasht shtetit të Kosovës e që gjatë kësaj periudhe kemi transportuar 5 pacient, Shqipëri, Maqedoni dhe anasjelltas.*

*Aotuparku vozitës në bazë të fletëudhëzimit nga Mjeku kujdestar në Sektorin e Kujdesit Urgjent në QKMF Vushtrrri gjatë periudhës janar-dhjetor 2025, ka trasferuar pacientët në Emergjencën e Spitalit Sheikh Zayed në Vushtrri dhe në disa raste ka transferuar pacientët në Emergjencën e SSHKUK-së Prishtinë, dhe në bazë të nevojave bëjm transportin nga SSHKUK në Vushtrri.*

## Përfundim

Shprehim falënderim të veçantë për të gjithë stafin profesional mjekësor dhe administrativ të QKMF-së "Dr. Safet Idrizi", për kontributin e vazhdueshëm dhe angazhimin e tyre të palodhshëm gjatë gjithë kohës. Pavarësisht rrezikut të vazhdueshëm nga sëmundjet ngjitëse, stafi nuk ka kursyer asnjëherë veten dhe ka ofruar shërbime shëndetësore me përkushtim dhe profesionalizëm.

Arritja e objektivave për ofrimin e shërbimeve shëndetësore cilësore bazohet në planifikim të mirëfilltë, organizim efikas, udhëheqje të qëndrueshme dhe kontroll të vazhdueshëm, me theks të veçantë në bashkëpunimin e ndërsjellë. Vetëm përmes unitetit dhe punës së përbashkët mund të realizojmë me sukses objektivat tona të përbashkëta.

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN
Nr. / Br. 5930/26
Nr. i fq. / Br. st. -2-
Data: / Datum: 09.02.2026
VUSHTRRI - VUČITRN

**Republike e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
**Komuna e Vushtrrisë**
*Opština Vučitrn / Municipality Vushtrri*
**Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit**

| | |
|---|---|
| DATË/A | 06.02.2025 |
| REFERENC-Ë: | Nr. 35/2025 |
| PËR/ZA/TO: | **KPF Komiteti për Politikë dhe Financa** |
| PËRMES | Karyetari i Komunës<br>**Ferit Idrizi** |
| NGA/OD/FROM: | **Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit**<br>Drilon Jusufi |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | Informatë lidhur me Lejet Ndërtimore; Kushte Ndërtimore dhe Leje Rrënimi |

Të nderuar,

Bazuar në evidencën zyrtare të Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, ju njoftojmë se gjatë vitit 2025, në Komunën e Vushtrrisë janë parashtruar gjithsej:

- **81 kërkesa për Leje Ndërtimore,**
- **72 kërkesa për Kushte Ndërtimore,**
- **9 kërkesa për Leje Rrënimi.**

Të gjitha kërkesat janë trajtuar nga autoriteti kompetent, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe procedurat administrative përkatëse.

**Kërkesat për Leje Ndërtimore (81 kërkesa)**

Prej numrit të përgjithshëm të kërkesave për leje ndërtimore:

- Në 63 kërkesa janë nxjerrë vendime për Leje Ndërtimore, prej të cilave:
- 29 vendime për Leje Ndërtimore i përkasin Kategorisë I,
- 34 vendime për Leje Ndërtimore i përkasin Kategorisë II.
- 2 kërkesa janë refuzuar me vendim,
- 1 kërkesë është hedhur poshtë,

- 15 kërkesa janë ende në procedurë, për shkak se aplikuesit nuk kanë kompletuar dokumentacionin dhe projektin teknik sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.

**Kërkesat për Kushte Ndërtimore (72 kërkesa)**

- 28 kërkesa janë përfunduar me Vendime për Kushte Ndërtimore të Kategorisë I,
- 35 kërkesa janë përfunduar me Vendime për Kushte Ndërtimore të Kategorisë II,
- 8 kërkesa janë hedhur poshtë,
- 3 kërkesa janë ende në procedurë shqyrtimi.

**Kërkesat për Leje Rrënimi (9 kërkesa)**

- 7 kërkesa janë përfunduar me Vendim për Leje Rrënimi,
- 2 kërkesa janë hedhur poshtë me vendim.

Procedura e dhënies së lejeve ndërtimore, kushteve ndërtimore dhe lejeve të rrënimit realizohet në përputhje me Ligjin për Ndërtim dhe aktet nënligjore përkatëse, ndërsa vendimi përfundimtar merret pas përmbushjes së plotë të kushteve ligjore dhe kompletimit të dokumentacionit teknik nga pala aplikuese.

Me respekt,

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kuvendi i Komunës

---

**Datë:** **06.02. 2026**

**Për:** **KPF –në dhe Kuvendin Komunal**

**Propozues:** **Kryetari i Komunës, Ferit Idrizi** ________________

**Hartues:** **Koordinatori i certifikuar për sistemin e menaxhimit të performancës, Islam Latifi** ________________

**Për shqyrtim: Raporti i sistemit të menaxhimit të performancës për vitin 2024**

---

Të nderuar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), në bashkëpunim me të gjitha komunat e Republikës së Kosovës dhe me partnerët e MAPL-së, ka publikuar raportin e performancës komunale për vitin 2024 i cili prezanton rezultatet e punës së komunave në 16 fusha të kompetencave që janë nën përgjegjësi të tyre, përmes 93 treguesve sa ka gjithsej Sistemi për Menaxhimin e Performancës Komunale ndërsa Komunën e Vushtrrisë e ka renditur me një përqindje mesatare 73.27 %.

Raporti përfshin periudhën janar-dhjetor 2024 dhe është tërësisht i bazuar në metodologjinë standarde dhe dokumentin kryesor të sistemit të performancës komunale, dokumente këto të diskutuara dhe të formuluara gjatë viteve të fundit, si dhe Ligjit Nr. 08/l-103 për Sistemin e Menaxhimit të Performancës së Komunave.

Vlerësimi i treguesve të aplikueshëm është bërë në koordinim me zyrtarët komunal, me të cilët para procesit të matjes është realizuar një konsultim i përgjithshëm, duke evidentuar të gjithë treguesit e mundshëm ku edhe mund të bëhet matja e tyre.

shërben edhe për nevoja të Grantit të Performancës Komunale, pasi tërësia e treguesve të këtij granti, shërbehet me të dhënat e raportit të performancës komunale.

Edhe në këtë cikël të matjes dhe vlerësimit të punës së komunave, shtrirja e të dhënave reflekton të arriturat e komunave në kuadër të treguesëve, rezultateve (nënobjektivave) dhe *fushave* sipas kompetencave vetanake përkatëse.

Matja e performancës së komunave rezulton me të dhëna që pasqyrojnë shkallën e përmbushjes së standardeve të shërbimeve nga ana e komunave. Ndër vite kanë ndryshuar elementet e matjes së performancës ngase numri i treguesve ka ardhur gjithnjë duke u rritur. Qëllimi i zgjerimit të fushave dhe treguesve ka qenë që të maten sa më shumë shërbime të mundshme të cilat ofrohen nga ana e institucioneve lokale.

**Metodologjia**

MAPL ka përcaktuar dhe normuar metodologjinë për përgatitjen, mbledhjen, përpunimin, verifikimin dhe raportimin e të dhënave në SMPK. Udhëzimet për mbledhje dhe raportim të të dhënave janë dhënë përmes: trajnimeve për koordinatorët komunal për performancë dhe zyrtarët raportues. Në hap me këtë janë përgatitur udhëzimet e shkruara të cilat shpjegojnë në detaje gjithë skenarin e funksionimit të SMPK-në.

Procesi i matjes së performancës ka kaluar nëpër fazat e mëposhtme:

- Konsolidimin e procesit të raportimit, koordinimin me zyrtarët komunal dhe themelimin e komisioneve përgjegjëse për vlerësim;
- Hapjen e thirrjes për raportim në komuna;
- Pranimin e të dhënave të raportuara nga komuna;
- Verifikimit të të dhënave në fazën e konsultimit paraprak,
- Vlerësimit kushteve formale të raportimit;
- Verifikimit të dhënave me mostër
- Nxjerrjen dhe komunikimin preliminar të rezultateve të performancës në komuna;
- Përmbylljen e periudhës së ankesave;
- Finalizimin e raportit;

Raportimi dhe dokumentimi i të dhënave për SMPK është bërë në Sistemin Elektronik të SMPK-së. Për përdorimin e këtij sistemi janë dhënë udhëzimet dhe janë ofruar trajnimet nga MAPL dhe DEMOS. Procesi i mbledhjes, dokumentimit dhe raportimit të të dhënave brenda institucioneve të ndryshme komunale është koordinuar nga koordinatori komunal për performancë. Të dhënat e raportuara janë autorizuar nga kryetarët e komunave. Dokumentimit përmes monitorimit të ueb-faqeve zyrtare;

Procesi i verifikimit ka kaluar nëpër fazën e verifikimit të rregullt dhe përfundimtar.

Verifikimi i rregullt ka kaluar në tri stade: verifikimi në fazën e konsultimit paraprak, verifikimit për pranueshmërinë e të dhënave dhe verifikimit me mostër.

Në fazën e verifikimit përmes konsultimit paraprak, janë identifikuar të dhënat me gabime ose të pakompletuara. Komunat janë udhëzuar që të plotësojnë këto të dhëna duke i mbështetur me dokumentet referuese.

Në fazën e verifikimit për pranueshmërinë është verifikuar respektimi afateve kohore për raportim dhe respektimi i autorizimeve nga zyrtarët përgjegjës në komunë.

Në fazën e verifikimit me mostër është zbatuar Metodologjia e verifikimit, duke aplikuar kriteret për përzgjedhje të treguesve në pajtim me këtë dokument.




# RAPORTI I PERFORMANCËS SË KOMUNAVE JANAR-DHJETOR 2024

Prishtinë 2025

Institucioni:

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

**Mbikëqyrja:**

Drin Haraçia, Drejtor i Departamentit për Performancë, MAPL

**Autor:**

Lazar Mitic, Zyrtar për Matje dhe Vlerësim të Performancës, MAPL

Blerta Sejdiu, Zyrtare për Matje dhe Vlerësim të Performancës, MAPL

**Kontrolluar nga:** Haxhi Krasniqi, Udhëheqës i Divizionit për Performancë Komunale

**Mbeldhja, analizmi dhe verifikimi i të dhënave:**

Haxhi Krasniqi, Udhëheqësi për Performancë Komunale, MAPL

Lazar Mitic, Zyrtar për Matje dhe Vlerësim të Performancës, MAPL

Edina Ibishi, Zyrtare për Matje dhe Vlerësim të Performancës, MAPL

Blerta Sejdiu, Zyrtare për Matje dhe Vlerësim të Performancës, MAPL

Fatos Ajvazi, Zyrtar për Matje dhe Vlerësim të Performancës, MAPL

*Të drejtat autoriale*

*Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e dokumentit nuk mund të kopjohet, shumëzohet dhe të përdoret, në cilën do formë (elektronike dhe fizike) apo të përshkruhet pa lejen me shkrim të MAPL-së.*

**Përmbajtja**

SHKURTESAT: 4
HYRJE 5
METODOLOGJIA 5
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE 6

**KAPITULLI I 8**
1. ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PERFORMANCËS 8
2. PERFORMANCA E KOMUNAVE 2020-2024 8
3. REZULTATET E VITIT TË VLERËSIMIT 10

**KAPITULLI II 14**
Pjesa e veçantë - Performanca e komunave 2024 14

**REZULTATET E KOMUNAVE SIPAS FUSHAVE DHE TREGUESVE 14**
FUSHA 1: SHËRBIMET PUBLIKE ADMINISTRATIVE 15
FUSHA 2 – TRANSPARENCA KOMUNALE 16
FUSHA 3 – PËRGJEGJSHMËRIA KOMUNALE 17
FUSHA 4 - BARAZIA NË PUNËSIM, SHËRBIME SOCIALE DHE FAMILJARE 19
FUSHA 5 – KULTURË, RINI DHE SPORT 19
FUSHA 6 – MENAXHIMI I FATKEQËSIVE 20
FUSHA 7 – PLANIFIKIMI HAPËSINOR 21
FUSHA 8 – HAPËSIRAT PUBLIKE 22
FUSHA 9 – INFRASTRUKTURA RRUGORE 23
FUSHA 10 – TRANSPORTI PUBLIK 24
FUSHA 11 – SHËRBIME PUBLIKE 25
FUSHA 12 – MBROJTJA E MJEDISIT 26
FUSHA 13 – PËRFAQËSIMI GJINOR 27
FUSHA 14 - ARSIMI PARAUNIVERSITAR 28
FUSHA 15 – KUJDESI PRIMAR SHËNDETËSOR 30
FUSHA 16– ZHVILLIMI EKONOMIK LOKAL 30

**KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME 32**

SHTOJCË: PËRQINDJA E TREGUESVE SIPAS FUSHAVE 35

## Shkurtesat:

| | |
|---|---|
| SMPK | Sistemi i Menaxhimit të Performancës Komunale |
| MAPL | Ministria e Administrimit të pushtetit lokal |
| DPK | Divizionin për Performancë Komunale |
| DEMOS | Decentralisation and Municipal Support |
| GPK | Granti i Performancës Komunale |
| SEMPK | Sistemi Elektronik i Menaxhimit të Performancës Komunale |

## Hyrje

Raporti i performancës komunale për vitin 2024 pasqyron rezultatet e punës së komunave në 16 fusha, të vlerësuara përmes treguesve të Sistemit për Menaxhimin e Performancës Komunale. Vlerësimi është bërë në bashkëpunim me zyrtarët komunalë, duke konsultuar përpara procesit të matjes për treguesit e mundshëm dhe pezulluar disa prej tyre. Raporti është hartuar dhe vlerësuar përmes Sistemit Elektronik të Menaxhimit të Performancës Komunale, duke përfshirë dokumentet referuese të të dhënave të raportuara.

Raporti analizon dy aspekte kryesore: 1) Mënyrën e qeverisjes së komunave sipas legjislacionit në fuqi, dhe 2) Ofrimin e shërbimeve në aspektin sasior dhe cilësor.

Të dhënat ndihmojnë në analizën e trendeve të zhvillimit të komunave dhe përmirësimin e sektorëve më pak të zhvilluar. Gjithashtu, raporti shërben si mjet vetëkontrolli për administratën komunale, duke rritur kapacitetet planifikuese dhe përmirësuar përgjegjshmërinë e zyrtarëve. Përdoret për të informuar qytetarët për pritjet e shërbimeve.

Raporti është hartuar në përputhje me Ligjin Nr. 08/L-103 dhe Udhëzimin Administrativ Nr. 01/2023 për Menaxhimin e Performancës Komunale. Raporti publikohet çdo vit pas miratimit nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë. Matja, vlerësimi dhe verifikimi i të dhënave janë udhëhequr sipas legjislacionit dhe udhëzimeve të përcaktuara.

## Metodologjia

MAPL ka përcaktuar dhe normuar metodologjinë për përgatitjen, mbledhjen, përpunimin, verifikimin dhe raportimin e të dhënave në SMPK.

Udhëzimet për mbledhje dhe raportim të të dhënave janë dhënë përmes: trajnimeve për koordinatorët komunal për performancë dhe zyrtarët raportues. Në hap me këtë janë përgatitur udhëzimet e shkruara të cilat shpjegojnë në detaje gjithë skenarin e funksionimit të SMPK-në.

Procesi i matjes së performancës ka kaluar nëpër fazat e mëposhtme:

- Konsolidimin e procesit të raportimit, koordinimin me zyrtarët komunal dhe themelimin e komisioneve përgjegjëse për vlerësim;
- Hapjen e thirrjes për raportim në komuna;
- Pranimin e të dhënave të raportuara nga komuna;
- Verifikimit të të dhënave në fazën e konsultimit paraprak,
- Vlerësimit kushteve formale të raportimit;
- Verifikimit të dhënave me mostër
- Nxjerrjen dhe komunikimin preliminar të rezultateve të performancës në komuna;
- Përmbylljen e periudhës së ankesave;
- Finalizimin e raportit;

Raportimi dhe dokumentimi i të dhënave për SMPK është bërë në Sistemin Elektronik të SMPK-së. Për përdorimin e këtij sistemi janë dhënë udhëzimet dhe ofruar trajnimet nga MAPL dhe DEMOS. Procesi i mbledhjes, dokumentimit dhe raportimit të të dhënave brenda institucioneve të ndryshme komunale është koordinuar nga koordinatori komunal për performancë. Të dhënat e raportuara janë autorizuar nga kryetarët e komunave.

Dokumentimit përmes monitorimit të ueb-faqeve zyrtare;

- Shqyrtimit të dokumenteve zyrtare të bashkëlidhura me formularët e plotësuar në sistemin elektronik;
- Sqarimeve të ofruara nga koordinatorët në Sistemin Elektronik të Performancës;
- Krahasimit të të dhënave me dokumente të tjera zyrtare të institucioneve publike;
- Për të dhëna të caktuara janë kontaktuar direkt zyrtarët përgjegjës në komuna

Procesi i verifikimit ka kaluar nëpër fazën e *verifikimit të rregullt dhe përfundimtar.*

**Verifikimi i rregullt** ka kaluar në tri stade: *verifikimi në fazën e konsultimit paraprak, verifikimit për pranueshmërinë e të dhënave dhe verifikimit me mostër.*

Në fazën e verifikimit përmes konsultimit paraprak, janë identifikuar të dhënat me gabime ose të pakompletuara. Komunat janë udhëzuar që të plotësojnë këto të dhëna duke i mbështetur me dokumentet referuese.

Në fazën e verifikimit për pranueshmërinë është verifikuar respektimi afateve kohore për raportim dhe respektimi i autorizimeve nga zyrtarët përgjegjës në komunë.

Në fazën e verifikimit me mostër është zbatuar Metodologjia e verifikimit, duke aplikuar kriteret për përzgjedhje të treguesve në pajtim me këtë dokument.

**Verifikimi përfundimtar** është zbatuar në terren nga komisioni i themeluar me vendim të SP-së me nr. 02-377, sipas kritereve të përcaktaura në Metodologjinë për verifikim, si pjesë e dokumentit kryesor për SMPK.

## Përmbledhje ekzekutive

Raporti i Performancës së Komunave të Kosovës për vitin 2024 ofron një vlerësim të hollësishëm të punës së komunave në ofrimin e shërbimeve për qytetarët dhe mënyrën e qeverisjes, duke analizuar përmbushjen e detyrimeve ligjore ndaj qytetarëve. Ky raport përmbledh rezultatet e performancës në 16 fusha kryesore, duke përfshirë shërbimet administrative, qeverisjen transparente, llogaridhënien, barazinë në punësim, arsimin, shëndetësinë, transportin publik, planifikimin hapësinor, menaxhimin e fatkeqësive, infrastrukturën rrugore, dhe sektorë të tjerë të rëndësishëm për zhvillimin socio-ekonomik dhe mirëqenien lokale. Vlerësimi i performancës realizohet në kuadër të Sistemit të Menaxhimit të Performancës Komunale (SMPK), një platformë e standardizuar për mbledhjen dhe verifikimin e të dhënave, duke mundësuar një qasje të unifikuar dhe të qëndrueshme për vlerësimin e arritjeve të komunave.

Procesi i matjes së performancës përfshinë 38 komuna, të cilat raportuan për 93 tregues të SMPK-së. Gjetjet kryesore të raportit për vitin 2024 tregojnë një përmirësim të lehtë në performancën e përgjithshme të komunave krahasuar me vitin paraprak, me një rritje prej 7.26%. Nëse krahasojmë të arriturat e përgjithshme ndër vite, vërehet se mesatarja variaton nga 57.06% deri në 65.50%.

Duhet theksuar se elementet e matjes së performancës kanë ndryshuar ndër vite, për shkak të përfshirjes së risive brenda SMPK-së, përkatësisht reduktimit të treguesve të caktuar. Ndryshimet në fusha dhe tregues janë bërë në disa tregues ku komunat kanë arritur një standard të mirë të funksionimit, duke i bërë këta tregues të panevojshëm për matje të mëtejshme. Nga ana tjetër,

ekzistojnë parametra të caktuar për të cilët komunat akoma qëndrojnë në një nivel të ulët zhvillimi. Për këtë arsye, treguesit e matjes duhet të mbeten të pranishëm në një periudhë afatgjatë.

Sa i përket performancës specifike sipas fushave, komunat treguan një nivel të kënaqshëm në ofrimin e shërbimeve administrative për qytetarët, me një performancë të përgjithshme prej 87.15%, duke dëshmuar efikasitet të lartë në trajtimin e kërkesave brenda afateve të përcaktuara ligjore. Nga ana tjetër, fushat si përfaqësimi i barabartë gjinor, barazia në punësim, arsimi parauniversitar, transporti publik dhe mbrojtja e mjedisit vazhdojnë të shfaqin sfida të ndjeshme, me përqindje nën mesataren e përgjithshme. Kjo reflekton nevojën për përmirësim dhe për burime mbështetëse në këto fusha të kompetencës.

Në fusha të tjera, siç është transparenca komunale, raporti tregon për një rritje në krahasim me vitin e kaluar, me një rezultat të përgjithshëm prej 84.82%. Rritja kryesisht lidhet me performancën e duhur në përmbushjen e indikatorëve për publikimin e dokumenteve dhe transmetimin e mbledhjeve të kuvendeve komunale në kohë reale. Megjithëse pjesa më e madhe e komunave ka treguar përpjekje për të siguruar qasje më të gjerë në informacione për qytetarët, disa sfida mbeten, sidomos në veprimet që synojnë përfshirjen e drejtpërdrejtë të qytetarëve në proceset e vendimmarrjes.

Përmirësime janë shprehur edhe në fushën e arsimit parauniversitar, me një trend pozitiv në ofrimin e shtrirjes adekuate të infrastrukturës arsimore, objekte dhe hapësira të pajisura me mjete bashkëkohore për zhvillimin e aktiviteteve mësimore në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar, përfshirë edhe edukimin e hershëm. Ky progres është rezultat i komunave në investimevet të bëra në infrastrukturën arsimore.

Përmirësime të tjera janë evidentuar në fushën e përgjegjshmërisë komunale. Në këtë fushë komunat kanë treguar respektim të afateve ligjore në proceset e Kuvendit Komunal. Megjithatë, sfidë e mëtejme mbetet pjesëmarrja e qytetarëve në konsultime publike,publikimi i raporteve për procese të konsultimeve publike, funksionimi i këshillave lokal dhe niveli i adresimit të rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit.

Rezultatet e raportit nxjerrin në pah një larmi të madhe në performancën e komunave dhe identifikojnë fushat ku nevojiten ndërhyrje për përmirësime strukturore dhe operacionale. Andaj, të dhënat e raportit duhet të merren për referencë nga vendimmarrësit dhe institucionet lokale, në përpjekje për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve dhe për të arritur një qeverisje të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse në nivel lokal.

## Kapitulli I

## 1. Aspekte të përgjithshme të performancës

Matja e performancës së komunave është proces i rregullt që zbatohet nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në bashkëpunim me të gjitha strukturat përgjegjëse në komunë, duke përfshirë zyrtarët raportues, koordinatorët e performancë dhe kryetarët e komunave, si autorizues të fundit të të dhënave të raportuara nga komunat.

Ky proces i matjes zbatohet brenda kornizës së kompetencave të komunave, siç përcaktohet në bazë të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje lokale ka përcaktuar në mënyrë taksative kompetencat e komunave në fusha të shumta të qeverisjes lokale, përfshirë: shërbimet publike, infrastrukturën lokale, mirëmbajtjen e rrugëve dhe hapësirave publike, ndriçimin publik, zhvillimin ekonomik lokal, planifikimin urban dhe rural, shfrytëzimin e tokës dhe ndërtimin, furnizimin me ujë të pijshëm, rrjetin e kanalizimit, mbrojtjen e mjedisit, menaxhimin e mbeturinave, ofrimin e arsimit parauniversitar, shëndetësinë primare, shërbime të mirëqenies sociale, aktivitetet kulturore, si dhe shumë çështje të tjera të përcaktuara shprehimisht me ligj.

Sistemi për Menaxhimin e Performancës Komunale (SMPK) mundëson që rezultatet e fituara të shërbejnë si mjet identifikimi për aspektet e forta dhe të dobëta të qeverisjes lokale, duke lejuar që informacionet e grumbulluara të ndihmojnë në ndërtimin e strategjive për përmirësim dhe zhvillim të qëndrueshëm. Matja e vitit 2024 është realizuar në 16 fusha të kompetencave komunale, me gjithsej 93 tregues. Elementet e matjes së performancës shprehin grupin e të drejtave dhe obligimeve që komunat i ushtrojnë në shërbim të qytetarëve mbi bazën e kompetencave ligjore. Indikatorët e përdorur japin informacione të rëndësishme për nivelin e shërbimeve të ofruara. Të dhënat e fituara japin indikacione të rëndësishme për menaxhmetin e komunës për të shtrirë prioritetet në sektorët më pak të zhvilluar.

Edhe për vitin 2024, procesi i matjes së performancës komunale u realizua përmes Sistemit Elektronik i menaxhimit të Performancës, në të cilin kanë qasje të gjithë zyrtarët raportues të komunave dhe ministrisë. Digjitalizimi i këtij procesi ka mundësuar një formë interaktive të komunikimit, për të qartësuar të gjitha të dhënat diskutabile dhe për të rritur shkallën e dokumentimit. Njëherësh sistemi mundëson gjurmimin e të gjithë hapave të vlerësimit dhe ruan të gjitha dokumentet relevante mbi të cilat bazohet raportimi.

## 2. Performanca e komunave 2020-2024

Në vitin 2024 , kërkesës për raportim të performancës u janë përgjigjur 33[1] komuna. Rezultatet tregojnë se niveli i arritjeve të komunave ndër vite varion nga 57.06% në vitin 2020 në 65.50% në vitin 2024. Në përgjithësi, performanca e komunave ka mbetur konstante ndër vite, me ndryshime shumë të vogla nga një vit në tjetrin, duke reflektuar një gjendje të ngjashme në efikasitetin dhe cilësinë e shërbimeve të ofruara, pa përmirësime të dukshme në nivel të përgjithshëm.
Sidoqoftë, niveli i tanishëm i performancës në treguesit e SMPK-së, është rezultat i ndikimit pozitiv të Sistemit për Menaxhimin e Performancës Komunale (SMPK) dhe Grantit për Performancë Komunale.

[1] Komunat Leposaviq, Zveçan, Zubin Potok, Kllkokot dhe Shtërpcë nuk kanë raportuar.

Faktorë të tjerë ndërlidhen me rritjen e buxhetit të komunave, por edhe përmirësimit të aspekteve administrative në përgjithësi. Treguesit në fushën e përgjegjshmërisë komunale, kontrollit dhe transparencës në proceset e menaxhimit po ashtu kanë kontribuar në identifikimin dhe adresimin e çështjeve të dobëta, duke forcuar kështu besimin e qytetarëve në institucionet lokale. Këta faktorë së bashku kanë ndihmuar në arritjen e rezultateve më të mira dhe në ofrimin e shërbimeve më cilësore për qytetarët.

Më poshtë janë paraqitur përqindjet mesatare nga viti 2020 deri në vitin 2024, si në vijim:

| Viti | 2020 | 2021 | 2022 | 2023 | 2024 |
|---|---|---|---|---|---|
| % | 57.06 | 56.8 | 59.38 | 58.24 | 65.50 |

***Tab.1.*** Tabela krahasimore e performancës 2020-2023

Sa i përket ndryshimeve të perfromancës në fushat e SMPK-së, tabela në vijim tregon të dhënat nga viti 2020 deri në vlerësimet e fundit për vitin 2024. Duhet theksuar së me rishikimin e SMPK-së të implementuar në vitin 2023, fusha e parkingjeve publike është larguar nga matja, derisa fusha e ujit të pijshëm, kanalizimit dhe mbeturinave janë integruar në një fushë të vetme – shërbimet publike. Detajet e performancës janë si në vijim:

| Fusha | 2020 | 2021 | 2022 | Fusha | 2023 | 2024 |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Shërbimet publike administrative | 70.47 | 81.66 | 88.04 | Shërbimet publike administrative | 80 | 87.85 |
| Transparenca Komunale | 72.93 | 66.92 | 86.11 | Transparenca komunale | 73.02 | 84.82 |
| Përgjegjshmëria komunale | 62.64 | 53.97 | 62.41 | Përgjegjshmëria komunale | 63.79 | 71.33 |
| Barazia në punësim, shërbimet sociale dhe familjare | 57.7 | 55.09 | 60.3 | Barazia në punësim, shërbimet sociale dhe familjare | 49.71 | 58.11 |
| Kulturë, rini, sport | 67.99 | 74.81 | 83.67 | Kulturë, rini, sport | 62.7 | 93.39 |
| Menaxhimi i fatkeqësive | 77.19 | 61.67 | 53.68 | Menaxhimi i fatkeqësive | 69.3 | 54.21 |
| Planifikimi hapësinor komunal | 45.2 | 50.35 | 55.37 | Planifikimi hapësinor komunal | 67.9 | 61.88 |
| Hapësirat publike | 51.58 | 50.35 | 47.84 | Hapësirat publike | 51.59 | 71.62 |
| Infrastruktura rrugore | 47.67 | 52.04 | 55.05 | Infrastruktura rrugore | 42.45 | 57.08 |
| Transporti publik | 64.13 | 56.64 | 47.41 | Transporti publik | 46.93 | 43.10 |
| Parkingjet publike | 40.41 | 47.04 | 47.35 | *E larguar nga SMPK* | | |
| Uji i pijshëm | 73.1 | 67.35 | 74.6 | | | |
| Kanalizimi | 36.51 | 35.49 | 39.74 | Shërbimet publike | 58.05 | 90.60 |
| Mbeturinat | 68.36 | 70.15 | 69.84 | | | |
| Mbrojtja e Mjedisit | 65.64 | 63.61 | 52.19 | Mbrojtja e Mjedisit | 52.56 | 63.69 |
| Përfaqësimi gjinor | | 38.02 | 39.2 | Përfaqësimi gjinor | 39.66 | 49.77 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Arsimi parauniversitar | 66.6 | 58.39 | 58.3 | Arsimi parauniversitar | 48.78 | 56.33 |
| Shëndetësia primare | 51.19 | 51.14 | 50.81 | Kujdesi parësor shëndetësor | 68.61 | 60.55 |
| Zhvillimi Ekonomik Lokal | 59.35 | 44.55 | 56.38 | Zhvillimi ekonomik lokal | 56.75 | 43.66 |

***Tab.2.*** *Performanca e fushave të performancës 2020-2024*

Sipas të dhënave të mësipërme, fushat si shërbimet publike administrative dhe transparenca komunale ka shënuar një ulje të lehtë në vitin 2023, por në vitin 2024 ka shënuar ngritje. Nga ana tjetër, përgjegjshmëria komunale ka pasur një ndryshim, me ulje në vitin 2021, por vitet pasuese kanë shënuar një nivel më të qëndrueshëm të rezultateve.

Të dhënat tregojnë se më sfiduese mbeten fushat si barazia në punësim dhe shërbimet sociale, në të cilat nuk vërehet një trend pozitiv gjatë viteve. Gjithashtu, aktivitetet në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit kanë rënë ndjeshëm në vitin 2023, duke sugjeruar një angazhim më të madh të komunave në vitet në vijim. Rënie të performancës vërehet edhe në fushën e zhvillimit ekonomik lokal dhe në kujdesin parësor shëndetësor. Ndërkaq, përmirësime gjatë vitit të fundit vërehen në fushat e arsimit parauniversitar dhe hapësirat publike.

## 3. Rezultatet e vitit të vlerësimit (2024)

Të dhënat për vitin 2024 tregojnë se performanca e përgjithshme e komunave në 16 fusha me 93 tregues të matjes është 65.50%, që do të thotë se komunat kanë ofruar shërbime në përqindje më të lartë për 7.26% krahasuar me vitin 2023.
Referuar % sipas fushave, nevoja më e madhe për rritjen e performancës shprehet në këto fusha: përfaqësim të barabartë gjinor (49.77%), transport publik (43.10%), zhvillim ekonomik lokal (43.66%).Më poshtë është paraqitur figura me % e arritur të 16 fushave të matjes:




***Fig. 1.** Performanca sipas fushave, 2024*

Figura e mësipërme tregon se përqindja më e lartë shprehet në fushat: kulturë, rini dhe sport, shërbimet publike, shërbimet publike administrative, transparenca komunale, hapësirat publike dhe përgjegjshmëria komunale. Me përqindje më të ulët janë fusha: përfaqësimi gjinor, zhvillimi ekonomik lokal dhe transporti publik.

***Ndarja e fushave sipas kategorive dhe niveleve të performances -*** Në vijim është paraqitur figura me të arriturat e komunave në fusha të kompetencave për të cilat bëhet matja e performancës për vitin 2024.

Performanca maksimale sipas fushës specifike është 93.39% tek kulturë, rini dhe sport, kurse më e ulëta shprehet tek transporti publik 43.10%. Kategorizimi i fushave është bërë sipas nivelit të performancës të ndarë në tri nivele: e ulët < 50%, e mesëm 50-65% dhe e lartë % 71-94% si vijon:

| **Performancë (< 50%)** | | **Performancë (50-65%)** | | **Performancë (>70%)** | |
|---|---|---|---|---|---|
| Përfaqësimi gjinor | 49.77 | Mbrojtja e mjedisit | 63.69 | Kulturë, rini dhe sport | 93.39 |
| Zhvillimi ekonomik lokal | 43.66 | Planifikimi hapsinor komunal | 61.88 | Shërbimet publike | 90.60 |
| Transporti publik | 43.10 | Kujdesi parësor shëndetësor | 60.55 | Shërbimet publike administrative | 89.81 |
| | | Arsimi parauniversitar | 56.33 | Transparenca komunale | 87.15 |
| | | Infrastruktura rrugore | 57.08 | Hapësirat publike | 71.62 |
| | | Barazia në punësim, shërbimet sociale dhe familjare | 58.11 | Përgjegjshmëria komunale | 71.33 |
| | | Menaxhimi i fatkeqësive | 54.21 | | |

***Tab.3.*** *Kategorizimi i fushave sipas nivelit të performancës*

Elementet e Sistemit të Menaxhimit të Performancës Komunale sigurojnë informata edhe për procedura dhe aspekte ligjore të një shërbimi publik, për këtë arsye kategorizimi i fushave për nga niveli arritjeve është bërë duke marrë parasysh qëllimin e treguesve, ngjashmëritë në mes të tyre, përmbajtjes dhe llojit të fushës së kompetencës. Së këndejmi, grupimi i fushave në vijim merr parasysh këto segmente:

*1) Standardet e qeverisjes së mirë dhe*
*2) Ofrimin e shërbimeve publike.*

***1) Standardet e qeverisjes së mirë,*** përfshijnë të dhëna rreth respektimit të parimeve të ligjshmërisë, transparencës, llogaridhënies, përfshirjes aktive të qytetarëve, standardeve të konsultimit publik si dhe çështje të ngjashme. Treguesit e kësaj kategorie kryesisht mbulojnë aktivitetet në fushën e zhvillimit ekonomik lokal, planifikimin e pronës, punësimin, rregullativën ligjore për të drejtat e komuniteteve, personave me aftësi të veçanta, përfaqësimit gjinor shërbimeve sociale etj.




***Fig.2.*** *Performanca e komunave në fushat e matjes së shërbimeve publike gjatë vitit 2024*

Nga figura 2 vërejmë që në kuadër të fushave të qeverisjes, në vitin 2024 mesatarja është 66.38%, nga 60.47% sa ishte në vitin 2023.

Në kuadër të ***Transparencës komunal***e, niveli i përgjithshëm i të arriturave shprehet me 84.82% nga 73.02 sa ishte në vitin 2023, apo 11.08% më e lartë.
Transparenca komunale lidhet ngushtë me fushën e ***përgjegjshmërisë komunale,*** e cila vlerësohet me numrin më të madh të treguesve në kuadër të SMPK-së. Komunat qëndrojnë mirë në treguesit e përgjegjshmërisë komunale. Kjo fushë rezulton me 71.33%, duke shënuar rritje prej 7.54% krahasuar me vitin paraprak 63.79%. Edhe më tutje komunat qëndrojnë jo mirë në zbatimin e rregullave për standardet minimale të konsultimit publik. Rëndësia e zbatimit të këtyre standardeve qëndron në

përmirësimin e planifikimit të politikave, mbështetjen e tyre në informata të vlefshme dhe nevoja reale, për të siguruar shpërndarje të drejtë të investimeve me qëllim të zhvillimit socio-ekonomik lokal.

Në kuadër të veprimeve që ***ndikojnë në zhvillimin ekonomik lokal*** komunat kanë pësuar rënie. Kjo fushë rezulton me 43.66% duke shënuar një rënie krahasuar me vitin 2023 sa ishte 56.75%..

***Barazia në punësim, shërbimet sociale dhe familjare*** **-** Në kuadër të kësaj fushe janë matur veprimet e komunave për ofrimin e banimit social, si dhe kujdesin institucional ndaj grupeve të cenueshme. Po ashtu janë mbledhur të dhëna për punësimin e personave me aftësi të veçanta dhe punësimin e pjesëtarëve të komuniteteve joshumicë bazuar në të drejtat ligjore të tyre. Performanca e përgjithshme në këtë fushë është 58.11%, krahasuar me 49.71% në vitin paraprak.

***Transporti publik*** mbetet ndër fushat me performancën më të ulët, me 43.10%. Niveli i të arriturave nuk shënon ndonjë progres gjatë viteve, çka e bën atë një ndër fushat më sfiduese për institucionet lokale.

***2) Fushat me tregues për ofrimin e shërbimeve publike.***

Në kuadër të këtyre fushave bëjnë pjesë tregues për lloje të ndryshme të ofrimit të shërbimeve nga ana e komunave, si në: menaxhim të mbeturinave, furnizim me ujë, mbrojtje të ambientit, kanalizim, planifikim urban, aktivitete kulturore, arsim, shëndetësi, infrastrukturë rrugore, trotuare, ndriçim publik, mirëmbajtje të hapësirave publike, shtigje të biçikletave, parkingje publike, shenjëzim të rrugëve etj.  Nga figura 4 rezulton që në kuadër të treguesve të shërbimeve publike, mesatarja e përgjithshme e arritur është 65.25%.




***Fig.3.*** *Performanca e komunave në fushat e matjes së shërbimeve publike gjatë vitit 2024*

Fusha Kulturë, Rini dhe Sport dhe Shërbimet Publike tregojnë rezultate më të mira krahasuar me fushat e tjera. Gjithashtu, komunat kanë arritur rezultate pozitive në fushën e planifikimit hapësinor, duke shënuar një rritje të dukshme krahasuar me vitet e mëparshme.

Në fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit komunat treguan rezultate në përqindje prej 93.39%. Nga ana tjetër, fusha e Arsimit Parauniversitar, si kompetencë vetanake komunale, ka një renditje jo të mirë, me një nivel arritjeje prej 56.33%. Gjithashtu, të dhënat flasin për rezultate jo të mjaftueshme në fushën e Infrastrukturës Rrugore, e cila ka një vlerë prej 57.08 %, si dhe në atë të transportit publik me 43.10%.

***Fusha e Arsimit parauniversitar*** mbledh tregues të shumtë për kompetencat e komunave në krijimin e kushteve për edukimin dhe arsimimin e nxënësve, prioritetet e vëna në këtë sektor përmes planifikimit të buxhetit, nivelin e planifikimit dhe realizimit të orëve mësimore, rezultatet e nxënësve, kushtet teknike dhe higjienike në shkolla, pajisjet e klasave me mjete pune, digjitalizimin e shkollave, aspektet e sigurisë, kriteret për kualifikimin dhe licencimin e mësimdhënësve, mbingarkesën në klasa, hapësirat shkollore etj. Në këtë fushë komunat kanë treguar performancë në shkallë prej 56.33%. Nisur nga niveli parafillor, të dhënat flasin për përfshirje tejet të ulët të fëmijëve nëpër çerdhe, e sidomos në zonat rurale, për shkak të mungesës së investimeve në këto zona.

Në fushën e ***shëndetësisë primare*** janë ofruar të dhëna për infrastrukturën dhe hapësirat e destinuara për shëndetësinë primare, resurset dhe personelin e mjaftueshëm, si dhe ofrimin e shërbimeve nga niveli komunal. Sipas të dhënave të raportuara nga komunat, në përgjithësi kjo fushë ka nivel prej 60.55%.

## Kapitulli II

PJESA E VEÇANTË - PERFORMANCA E KOMUNAVE 2024

# 1. Rezultatet e komunave sipas fushave dhe treguesve

Matja e performancës në vitin 2024 ka pasur në fokus pasqyrimin e të arriturave për 38 komuna. Kërkesës për raportim i janë përgjigjur 33[2] komuna, megjithëse shkalla e pavlefshmërisë së të dhënave ishte mjaft e shprehur në disa komuna.

Shkalla e ofrimit të shërbimeve dhe respektimit të standardeve të qeverisjes ndryshon nga njëra komunë në tjetrën, varësisht nga fusha e kompetencave që matet. Në nivelin e performancës mund të ndikojnë faktorë të shumtë, si: prioritetet e vëna nga komuna brenda fushave për të cilat ushtrohet matja, mënyra dhe cilësia e planifikimit të punëve, realizimi në raport me planifikimin, realizimi në raport me mundësitë dhe pengesat e caktuara, kapacitetet dhe resurset, kompleksiteti i çështjeve, cilësia e raportimit të të dhënave në SMPK, si dhe faktorë të tjerë relevant.

Në vijim të këtij raporti, janë paraqitur detaje të të arriturave të komunave sipas fushave dhe treguesve përkatës. Llogaritja e rezultatit përfundimtar të fushave të matjes, merr për bazë edhe vlerën 0 për të dhënat e të cilave janë shpallur të pavlefshme. Kjo është bërë për arsye se edhe keqraportimi konsiderohet performancë e dobët, gjë që duhet të ndikoj në rezultatin përfundimtar të komunave që nuk kanë ofruar të dhëna. Kjo reflekton edhe në krahasimet në mes të komunave si dhe vlerësimet e bëra për qëllime të Grantit për Performancë.

[2] Komunat Leposaviq, Zveçan, Zubin Potok, Kllkokot dhe Shtërpcë nuk kanë raportuar.

## Fusha 1: Shërbimet publike administrative

Kjo fushë përbëhet nga katër tregues, ku përfshihen shërbimet publike administrative (SHPA) dhe efikasiteti i organeve komunale në shqyrtimin e kërkesave të qytetarëve, personave fizik dhe juridik, për çështjet që lidhen me kompetencat e tyre të cilat kalojnë nëpërmjet Qendrës për Shërbimin e Qytetarëve. Njëkohësisht, kjo fushë matë gatishmërinë e komunave për të ofruar shërbime administrative në formën online apo përmes e-kioskut.

Krahasuar me 16 fushat e tjera, në vitin 2024 kjo fushë radhitet e treta për nga performanca, me nivel të përgjithshëm prej 87.75%. Komunat Obiliq, Prizren, Hani i Elezit, Mamushë dhe Junik kanë nivelin maksimal të realizimit të këtij shërbimi prej 100%.

| Treguesit | % |
|---|---|
| Kërkesat administrative të shqyrtuara gjatë vitit | 96.85 |
| Kërkesat administrative të shqyrtuara brenda afateve ligjore | 92.43 |
| Shërbimet administrative të ofruara në mënyrë elektronike nga komuna | 83.03 |
| Shërbimet administrative të thjeshtuara për zvoglimin e barrës administrative në nivel komunal | 79.09 |

**Tab.4.** *Treguesit e performancës në fushën e shërbimeve administrative*

Të dhënat tregojnë se komunat në masë të madhe i kanë shqyrtuar kërkesat administrative të cilat u janë parashtruar. Gjatë vitit 2024 komunave u janë parashtruar 1,792,743 kërkesa për shqyrtim, nga të cilat janë shqyrtuar 1,742,875 kërkesa. Mesatarja e trajtimit të kërkesave për komunë është 54,464 kërkesa. Këtu përfshihen kërkesat për leje të ndryshme komunale, dokumentet e gjendjes civile, kërkesat për qasje në informata, kërkesat qytetare për financim dhe adresim në organet përgjegjëse të komunës.




***Fig.4*** *Krahasimi i performancës së komunave në fushën e shërbimeve administrative*

Sipas figurës së mësipërme, shihet se përqindja më e lartë në përmbushjen e treguesve është në komunat: Obiliq, Prizren, Hani i Elezit, Mamushë, Junik me 100%, kurse më ulët qëndrojnë komunat Graçanica 25%, Ranillug 49.80% dhe Partesh 50%.

## Fusha 2 – Transparenca Komunale

Në këtë fushë janë aplikuar 7 tregues me 21 të dhëna të cilat japin informata për publikimin e akteve, planeve, buxhetit, kritereve të ueb-faqeve, qasjen në dokumentet publike, publicitetin e seancave të kuvendit, etj. Performanca e përgjithshme e arritur është 84.82%, për dallim nga viti paraprak ku ishte 73.02%. Sa u përket performancës sipas tregueseve, përqindja më e lartë është në lejimin e qasjes së qytetarëve në dokumentet zyrtare shprehur me 94.52%. Në vijim është paraqitur tabela me treguesit e matur të transparencës për periudhën raportuese:

| **Treguesit** | % |
|---|---|
| Mbledhjet e kuvendit të bëra publike dhe transmetuara drejtpërdrejtë online | 93.75 |
| Niveli i qasjes në dokumente publike nga qytetarët | 94.52 |
| Përmbushja e kritereve të faqes zyrtare elektronike të komunës | 93.94 |
| Publikimi i akteve të miratuara në kuvendin komunal në faqen zyrtare të komunës | 93.54 |
| Publikimi i akteve me karakter të përgjithshëm, të miratuara nga kryetari i komunës, në faqen zyrtare të komunës | 89.80 |
| Publikimi i dokumenteve për planifikim dhe shpenzim të buxhetit | 89.70 |
| Publikimi i dokumenteve të prokurimit publik të komunës | 75.38 |

**Tab.5.** *Treguesit e performancës në fushën e transparencës komunale*

Nga figura e mësipërme shihet se treguesi për transmetimin online të mbledhjeve të kuvendit del në nivel 93.75%, krahasuar me vitin paraprak prej 72.15%. Tetë kriteret e matura për ueb-faqe komunale del të jenë përmbushur në masën 93.94%, ndërsa aktet e kuvendit të komunës janë publikuar në shkallë prej 93.54%. Të dhënat tregojnë për trend pozitiv në publikimin e akteve me karakter të përgjithshëm të aprovuara nga kryetarët e komunave, shprehur në përqindje prej 89.80% ose 8.16% më shumë se në vitin 2023.




***Fig.5*** *Krahasimi i performancës së komunave në fushën e transparencës*

Figura e mësipërme tregon për 33 komuna të cilat kanë treguar performancë në mes 10-100% në fushën e transparencës, prej të cilave: Rahovec (100%), Obiliq (100 %), Vushtrri (100 %), Lipjan (100

%), Prizren (100%), Hani i Elezit (100%), Deçan (100%), Mitrovicë e Jugut (100%), Istog (100%) dhe Junik (100%).

## Fusha 3 – Përgjegjshmëria Komunale

Përgjegjshmëria komunale ka gjithsej 18 tregues, të aplikuar në vitin 2024. Kjo fushë ka një performancë të përgjithshme prej 71.33%. Në kuadër të kësaj fushe, performanca më e lartë është shprehur në publikimin e njoftimeve për mbajtjen e 2 takimeve publike prej 93.75%. Treguesit e kësaj fushe theksojnë të arriturat e komunave në 5 shtylla të qeverisjes së mirë, duke përfshirë: pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset vendimmarrëse, llogaridhënien, respektimin e procedurave të prokurimit publik, ndërmarrjen e masave antikorrupsion, si dhe menaxhimin e burimeve njerëzore.

Sa i përket aktiviteteve për fuqizimin e pjesëmarrjes në vendimmarrje, të dhënat për treguesit e performancës janë si në vijim:

| Treguesit | % |
|---|---|
| Publikimi i njoftimeve për mbajtjen e 2 takimeve publike | 93.75 |
| Pjesëmarrja e qytetarëve në konsultime publike | 28.75 |
| Adresimi i kërkesave të qytetarëve në takimet për buxhet | 78.61 |
| Aktet komunale dhe dokumentet e politikave lokale të konsultuara me publikun | 49.60 |
| Dëgjime publike për KAB, buxhet komunal dhe buxhetimi me pjesëmarrje | 76.59 |
| Publikimi i raporteve për procese të konsultimeve publike | 46.48 |
| Funksionimi i këshillave lokal | 38.61 |

**Tab.6.** *Treguesit e përgjegjshmërisë për fuqizimin e pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje*

Referuar të dhënave të mësipërme, pjesëmarrja e qytetarëve në konsultime publike edhe në vitin 2024 mbetet e ulët, përkundër standardit të SMPK-së për 3% të popullsisë së komunës. Ky standard është përmbushur në shkallën 28.75% krahasuar me vitin paraprak që ishte 26.08%, apo 2.67%më e lartë se në vitin paraprak, megjithatë përqindja konsiderohet e ulët. Gjithashtu, funksionalizimi i këshillave të fshatrave mbetet sfidë e cila duhet adresuar në periudhat e ardhshme.

Krahas kësaj, komunat kanë ndërmarrë veprime të tjera në funksion të forcimit të llogaridhënies dhe trajtimit të çështjeve thelbësore siç është miratimi me kohë i buxhetit në kuvendet komunale. Treguesit për këtë pjesë të performancës reflektojnë të arriturat si në vijim:

| Treguesit | % |
|---|---|
| Miratimi me kohë i propozim buxhetit vjetor komunal | 77.50 |
| Diskutime për raportet tre-mujore buxhetore nga Kuvendi Komunal | 73.59 |
| Diskutim për raportin e performancës komunale nga kuvendi komunal për vitin paraprak | 53.13 |
| Diskutimi i raportit të auditorit të jashtëm dhe planit të veprimit për adresim të rekomandimeve në Kuvendin Komunale | 68.75 |
| Mbledhjet e Kuvendit Komunal me pjesëmarrje të kryetarit të komunës | 58.46 |

**Tab.7.** *Treguesit e përgjegjshmërisë për forcimin e llogaridhënies*

Sa i përket nivelit të zbatimit të planit të prokurimit, bazuar në shumën e shpenzuar kundrejt shumës së planifikuar, performanca rezulton në masën 78.78%. Treguesi i për nivelin e adresimit te rekomandimeve të ZKA-së ka përqindjen prej 34.86%.Treguesi niveli i pagesave brenda afateve ligjore prej 30 ditës në përqindje i shprehur 76.00%.

| **Treguesit** | % |
|---|---|
| Niveli i zbatimit të planit të prokurimit | 78.78 |
| Niveli i pagesave të procesuara brenda afatit ligjor prej 30 ditëve | 76.00 |
| Niveli i adresimit të rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit | 34.86 |

**Tab.8.** *Treguesit e përgjegjshmërisë në fushën e prokurimit dhe zbatimit të rekomandimeve të auditorit*

Ligji për zyrtarët publik ka përcaktuar një numër obligimesh për institucionet e administratës shtetërore, përfshirë komunat, në zbatimin e masave administrative ndaj zyrtarëve të cilëve u janë iniciuar procedura penale për veprat penale të kryera gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre. Po ashtu, komunat obligohen të hartojnë planet e integritetit, në mënyrë që të forcojnë transparencën dhe llogaridhënien në veprimtarinë e tyre. Treguesit e performancës në këtë drejtim pasqyrohen me këto rezultate:

| **Treguesit** | % |
|---|---|
| Raportimi i planit vjetor të planit të integritetit ne kuvendin komunal | 43.75 |
| Pezullimi i zyrtarëve komunal në raport me akt-akuzat e ngritura ndaj tyre | 96.88 |

**Tab.9.** *Treguesit e përgjegjshmërisë për masat antikorrupsion dhe integritet*

Në 14 treguesit e kësaj fushe, 20 komuna kanë treguar performancë mbi 70%, 8 komuna nga 50-70%, derisa pjesa tjetër e komunave janë nën 50%. Në vijim është paraqitur figura krahasimore e rezultateve të kësaj fushe sipas komunave:




***Fig 6.*** *Krahasimi i performancës së komunave në fushën e përgjegjshmërisë*

## Fusha 4 - Barazia në Punësim, Shërbime Sociale dhe Familjare

Kjo fushë prej dy rezultateve dhe katër treguesve mbulon përfaqësimin e grupeve të ndryshme në punësim komunal, si dhe shërbimet sociale të grupeve më me nevojë në komuna. Në kuadër të punësimit treguesit matin nivelin e punësimit të personave me aftësi të veçanta në institucionet komunale, si dhe përqindjen e përfshirjes së komuniteteve jo shumicë. Performanca e përgjithshme në këtë fushë prej 58.11%.

| Treguesit | % |
|---|---|
| Të punësuar me nevoja të veçanta në institucione komunale | 34.57 |
| Zyrtarë Publik të punësuar nga komunitetet jo shumicë në institucionet komunale | 66.56 |
| Familje me nevojë të cilave iu është siguruar banimi social | 65.44 |
| Fëmijë me nevojë për strehim që iu është siguruar strehimi | 70.57 |
| Programi trevjeçar komunal i banimit social | 60.94 |

**Tab.10.** *Treguesit e fushës së Barazisë në Punësim, Shërbimeve Sociale dhe Familjare*

Sipas të dhënave niveli i përmbushjes së kuotës për të punësuar me nevoja të veçanta mbetet i ulët, referuar kriterit të përcaktuar në Ligjin Nr. 05L-051 për mbrojtje nga diskriminimi. Më poshtë, janë pasqyruar të arriturat për secilën komunë në kuadër të kësaj fushe. Përqindje më e lartë është shënuar në dy tregues, familje në nevojë të cilave iu është siguruar banimi social, në masën 65.44% dhe fëmijëve në nevoje që iu është siguruar strehimi familjar, në përqindjen prej 70.57%.




***FIg.7.** Krahasimi i performancës së komunave në fushën e Barazisë në Punësim, Shërbimeve Sociale dhe Familjare*

## Fusha 5 – Kulturë, Rini dhe Sport

Në kuadër të kësaj fushe maten aktivitetet komunale kulturore, rinore dhe sportive, si një nga kompetencat vetanake të komunave. Fusha mbulon edhe shërbimet e ofruara nga komunat që kanë të bëjnë me kulturën, rininë dhe sportin, përfshirë hapësirat sportive. Treguesit, aktivitete të kulturës rinisë dhe sportit të mbështetura me buxhet komunal sipas përqindjes janë në vlerë prej 96.75% kurse

hapësirat për aktivitete sportive krahasuar me numrin e banoreve në komuna shprehen me 90.03%. Në vijim është paraqitur tabela me treguesit e performancës së kësaj fushe:

| Treguesit | % |
|---|---|
| Hapësira për aktivitete të sportit për numër të banorëve | 90.03 |
| Aktivitete të kulturës, rinisë dhe sportit të organizuara me buxhet komunal | 96.75 |

**Tab.11.** *Treguesit e performancës në fushën e kulturës*

Të arriturat për secilën komunë në kuadër të kësaj fushe janë si vijon:




***Fig.8*** *Të dhënat krahasimore në mes komunave në fushën e kulturës*

## Fusha 6 – Menaxhimi i fatkeqësive

Kjo fushë matë planifikimin, organizimin dhe udhëheqjen e sistemit të organizuar të komunës për tu përgjigjur ndaj dukurive të shkaktuara nga fuqitë e pakontrolluara dhe nga fuqitë tjera. Fusha ka vetëm një rezultat dhe dy tregues, që kryesisht vlerësojnë realizimin e planit për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore, si dhe nivelin e përgjigjeve të institucioneve komunale ndaj rasteve të paraqitura në këtë fushë. Performanca e përgjithshme në këtë fushë është 54.21%. Rezultate maksimale prej 100 % në vitin 2024 kanë arritur dy komuna në menaxhim efikas të faktëkeqësive, ndërsa në nivel minimal mbeten 20 komuna, kurse mbi mesatare të vendit janë 8 komuna.

| Treguesit | % |
|---|---|
| Niveli i realizimit të planit komunal për reagim emergjent | 15.00 |
| Intervenimet për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera | 93.41 |

**Tab.12.** *Treguesit e performancës në fushën e menaxhimit të fatkeqësive*

Të arriturat për secilën komunë në kuadër të kësaj fushe janë si vijon:




***Fig.9*** *Të dhënat krahasimore në mes komunave në menaxhimit të fatkeqësive*

## Fusha 7 – Planifikimi Hapësinor

Kjo fushë matë zhvillimin hapësinor komunal nëpërmjet instrumenteve të planifikimit hapësinor, por edhe nivelin e planifikimit të ndërtimeve komunale. Kjo fushë ka një performancë të përgjithshme prej 61.88%.

| **Treguesit** | % |
|---|---|
| Territori i komunës i rregulluar sipas planeve hapësinore komununale | 44.55 |
| Kërkesa të shqyrtuara për leje të ndërtimit | 87.56 |
| Objekte të inspektuara me leje të ndërtimit | 70.87 |

**Tab.13.** *Treguesit e performancës në fushën e planifikimit hapësinor*

Sipërfaqja e territorit të komunës e mbuluar me plane rregulluese të hollësishme është në shkallë prej 44.55%. Sa i përket lejeve ndërtimore nga komunat u shqyrtuan me kohë 87.56%. Sipas të dhënave, ndërtesat e reja për të cilat u lëshuan leje ndërtimi inspektuar në shkallë prej 70.87%. Të dhënat krahasimore sipas komunave janë si vijon:




***FIg.10.*** *Të dhënat krahasimore në mes komunave në fushën e planifikimit hapësinor*

## Fusha 8 – Hapësirat Publike

Kjo fushë matë hapësirat publike të cilat janë me interes për qytetarët, menaxhohen nga komunat dhe të cilat ndikojnë në cilësinë dhe standardin e jetesës së qytetarëve. Performanca e përgjithshme sipas të dhënave të ofruara nga komunat është 71.62%. Në bazë të Ligjit për vetëqeverisje lokale, komunat ndër të tjera janë kompetente për ofrimin dhe mirëmbajtjen e parqeve dhe hapësirave publike. Sipas të dhënave për vitin 2024 rreth 84.16% të hapësirave publike mirëmbahen rregullisht, ndërsa 81.71% të hapësirave publike janë të përcjella me ndriçim publik. Sipërfaqe të gjelbra për kokë banori në m2 janë 48.99% në  nivel vendi. Në vijim është paraqitur përqindja sipas treguesve:

| **Treguesit** | % |
|---|---|
| Sipërfaqja e hapësirave të gjelbra publike në m² për kokë banori | 48.99 |
| Sipërfaqja e hapësirave publike që mirëmbahen rregullisht | 84.16 |
| Hapësirat publike të pajisura me ndriçim publik | 81.71 |

**Tab.14.** *Treguesit e performancës në fushën e hapësirave publike*

Përpos nivelit të hapësirave të gjelbra për kokë banori, kjo fushë matë edhe sipërfaqen e hapësirave publike të cilat mirëmbahen rregullisht nga komunat, si dhe numrin e hapësirave publike të përcjella me ndriçim publik. Për nivelin e përmbushjes së treguesve referojuni figurës së mësipërme.




***FIg.11.*** *Të dhënat krahasimore në mes komunave në fushën e hapësirave publike*

Sipas të dhënave të raportuara nga Komunat në nivel maksimal prej 100% janë 7 komuna të cilat e kanë ofruar këtë shërbim për qytetarët e vet, ndërsa për 4 komuna ende mbetet sfidë ofrimi i këtij shërbimi.

## Fusha 9 – Infrastruktura Rrugore

Kjo fushë matë rrugët komunale dhe infrastrukturën përcjellëse që janë nën kompetencën e komunës. Kjo fushë përmban tregues të pasqyrojnë rezultatet e komunave në aspektin e mirëmbatjes së rrugëve gjatë dimrit dhe verës, pastaj riasfaltimin e rrugëve, shtigjet me biçikleta, shoqërimin e rrugëve me trotuare, ndriçim publik dhe shenjëzim vertikal dhe horizontal. Performanca e përgjithshme vlerësohet në shkallë prej 57.08%. Përqindja e treguesve të kësaj fushe që pasqyrojnë mirëmbajtjen e rrugëve është si në vijim:

| **Treguesit** | % |
|---|---|
| Rrugët lokale të mirëmbajtura gjatë sezonës së verës | 66.45 |
| Rrugët lokale të mirëmbajtura gjatë sezonës së dimrit | 73.13 |

**Tab.15.** *Treguesit e mirëmbajtjes së infrastrukturës rrugore*

Sa i përket projekteve të realizuara infrastrukturore në këtë fushë, treguesit pasqyrohen si në vijim:

| **Treguesit** | % |
|---|---|
| Gjatësia e rrugëve lokale të pajisura me trotuare | 28.96 |
| Gjatësia e rrugëve lokale të pajisura me ndriçim publik | 60.03 |
| Gjatësia e rrugëve lokale të pajisura me shenjëzim vertikal dhe horizontal | 64.54 |
| Rrugët me shteg të biçikletave | 17.60 |
| Rrugë lokale të riasfaltuara | 50.69 |

**Tab.16.** *Treguesit e investimeve në projekte të infrastrukturës rrugore*

Në kuadër të këtyre treguesve, komunat duhet të orientojnë investimet në krijimin e shtigjeve për biçikleta, rregullimin e trotuareve dhe ndriçimit publik, të cilat pasqyrohen me vlera më të ulëta.

Performanca e komunave në nivel të fushës është paraqitur si më poshtë:




***Fig.12.*** *Të dhënat krahasimore në mes të komunave në fushën e infrastrukturës rrugore*

## Fusha 10 – Transporti Publik

Kjo fushë matë ofrimin e transportit publik për qytetarët e komunës. Kjo fushë ka një performancë të përgjithshme prej 43.10%.

| Treguesit | % |
|---|---|
| Realizimi i planit komunal për transport lokal publik (planit të mobilitetit) | 29.21 |
| Vendbanimet e përfshira në transportin lokal publik | 31.34 |
| Vendndalimet e shënjëzuara për automjetet e transportit publik | 68.76 |

***Tab.17.*** *Treguesit e performancës në fushën e transportit publik lokal*

Në kuadër të kësaj fushe performanca për tre tregues është pasqyruar në grafikun më lart. Sipas të dhënave vendbanimet e përfshira në transportin lokal publik 31.34%, kurse vendndalimet e shenjëzuara për automjetet e transportit publik qëndrojnë në nivelin 68.76%. Në nivel të ulet është përmbushur plani për transport publik i cili në përqindje është 29.21% .

Në vijim është paraqitur performanca e fushës përqindje për secilën nga komunat e Kosovës:




***Fig.13.*** *Të dhënat krahasimore në mes të komunave në fushën e transportit publik*

## Fusha 11 – Shërbime Publike

Kjo fushë përfshinë pesë 5 tregues të ofrimit të shërbimeve publike. Performanca në nivel të fushës është 90.60%. Përqindja sipas treguesve është si në vijim:

| **Treguesit** | % |
|---|---|
| Realizimi i Planit për investime kapitale në sistemin e ujësjellësit | 82.03 |
| Realizimi i Panit për investime kapitale në sistemin e kanalizimit | 92.26 |
| Realizimi i planit komunal për menaxhimin e mbeturinave | 90.03 |
| Realizimi i orarit për mbledhjen e mbeturinave | 99.78 |
| Inkasimi i mjeteve për mbledhjen e mbeturinave | 88.92 |

**Tab.18.** *Treguesit e performancës në fushën e shërbimeve publike*

Sipas tabelës së mësipërmes, treguesi me perfromancës më të lartë ka të bëjë me zbatimin e orarit për mbledhjen e mbeturinave në një vlerë prej 99.78%, pastaj inkasomi i të hyrave nga mbledhja e mbeturinave, 88.92%. Treguesit e realizimin e planit komunal për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e kanalizimit 92.26% dhe realizimin e planit komunal për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të ujësjellësit 82.03% .

Në vijim është paraqitur arritjet e komunave në këtë fushë në përqindje.




***Fig.14.*** *Të dhënat krahasimore në mes të komunave në fushën e shërbimeve publike*

## Fusha 12 – Mbrojtja e Mjedisit

Kjo fushë matë veprimet e komunës përkatëse për mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit natyror dhe jetësor (urban dhe rural) nga dëmtimi, degradimi apo ndotja si pasojë e veprimtarisë njerëzore ose të ndikimit natyror. Kjo fushë ka një performancë të përgjithshme prej 63.69%.  Përqindja e treguesve të kësaj fushe është si në vijim:

| **Treguesit** | % |
|---|---|
| Realizimi i Planit Lokal të Veprimit në Mjedis | 13.51 |
| Lejet mjedisore komunale të lëshuara | 90.33 |
| Ndërtesat e reja që e kanë zbatuar lejen mjedisore komunale | 87.23 |

**Tab.20.** *Treguesit e performancës në fushën e mbrojtjes së mjedisit*

Realizimi i planit të veprimit të mjedis del të jetë arritur në masën prej 13.51. Lejet mjedisore të lëshuar ishin në shkallën 90.33%, ndërsa ndërtesat e reja që kanë zbatuar lejet mjedisore komunale del në shkallë mjaftë të ulët prej 87.23%.



***Fig.15.*** *Të dhënat krahasimore në fushën e mjedisit*

Komunat Hani i Elezit dhe Deçan kanë arritur vlerën maksimale prej 100%. Në grafikun më sipër paraqiten edhe komunat që kanë treguar rezultate të larta në këtë fushë, ndërsa mesatarja e vendit është 63.69%. Mbi mesataren renditen 20 komuna, ndërsa 10 komuna janë renditur nën mesataren e vendit për këtë fushë.

## Fusha 13 – Përfaqësimi Gjinor

Përfaqësimi gjinor matet më gjerësisht në këtë fushë duke përfshirë qasjen e të dy gjinive në programet për zhvillim social, ekonomik, si dhe në aktiviteteve komunale. Po ashtu, treguesit matin shkallën e përfaqësimit të të dy gjinive në institucionet lokale dhe trupat e kuvendeve komunale. Me gjithë progresin e komunave ndër vite në sigurimin e përfaqësimit të barabartë në trupat e kuvendeve dhe në komisionet komunale, të dhënat për treguesit e caktuar ndikojnë në përqindjen e përgjithshme që kjo fushë të renditet mjaft të ulët, 49.77%. Në vijim, është paraqitur figura e përfaqësimit gjinor sipas treguesve:

| **Treguesit** | % |
|---|---|
| Gratë e punësuara në institucione/administratën komunale | 86.48 |
| Gratë në pozita udhëheqëse në institucionet arsimore, shëndetësore e kulturore/sportive | 35.86 |
| Gratë e emëruara në pozita politike në komunë | 59.84 |
| Barazia gjinore tek anëtarët e komiteteve komunale | 96.88 |
| Barazia gjinore tek përbërja e këshillave lokale | 15.31 |

**Tab.21.** *Përfaqësimi i grave në trupat komunale*

Sipas të dhënave të raportuara nga 33 komuna, niveli i të punësuarve gra në institucione komunale është 84.48% në raport me kriterin 50x50. Po ashtu, Gratë të emëruara në pozita politike, është arritur 59.84% e kriterit ligjor. Sipas të dhënave të përfaqësimit të grave në pozitat udhëheqëse në institucionet arsimore, shëndetësore dhe kulturore/sportive, 35.86% të përmbushjes së kriterit ligjor.

Në vijim janë paraqitur treguesit e përfaqësimit gjinor në programet komunale

| **Treguesit** | % |
|---|---|
| Buxhetimi dhe shpenzimi i përgjegjshëm gjinor | 87.50 |
| Barazia gjinore në buxhetim për punësim dhe ndërmarrësi të grave | 60.04 |
| Pjesëmarrja e grave në konsultime publike | 62.49 |
| Realizimi i planit komunal për barazi gjinore | 69.75 |

**Tab.22.** *Përfaqësimi i grave në trupat komunale*

Barazia gjinore në buxhetim për punësim dhe ndërmarrësi të grave pasqyrohet me përqindje më të ulët krahasuar me treguesit e tjerë (60.04%). Po ashtu, hartimi i planit për baraza gjinore ka përqindje më të ulët, derisa komunat më mirë rezultojnë në buxhetimin dhe shpenzimin e përgjegjshëm gjinor në një vlerë prej 87.50%. Tregues të tjerë që paraqesin përfaqësimin e barabartë gjinor janë si në vijim:

| Treguesit | % |
|---|---|
| Përfaqësimi gjinor tek emërtimet e rrugëve | 13.32 |
| Regjistrimi i pronësisë në emër të dy gjinive | 27.64 |

**Tab.23.** *Përfaqësimi gjinor në procese të rëndësishme shoqërore në komunë*

Sa i përket të arriturave sipas komunave, në vijim është paraqitur figura krahasuese:




***FIg.16.*** *Krahasimet sipas komunave në fushën e barazisë gjinor*

## Fusha 14 - Arsimi Parauniversitar

Kjo fushë synon rezultate në hapësira për çerdhe dhe shkolla të pajisura me kabinete për internet, masa të efiçencës së energjisë, rekrutimin e personelit arsimor, licencimin e mësimdhënësve, mjetet e konkretizimit, pajisjet e shkollave me mjete mësimore, kabinete të TIK-ut, si dhe kushtet e sigurisë në shkollë. Kjo fushë ka performancën e përgjithshme në nivel prej 56.33% Në përgjithësi, në treguesit e arsimit të dhënat e raportuara nga komunat nuk kanë qenë të plota, kështu që përqindjet e fituara mund të paraqesin një vlera relative të saktësisë.

| Treguesit | % |
|---|---|
| Shkolla me masa të efiçencë së energjisë | 41.91 |
| Siguria në institucionet e arsimit parauniversitar | 77.91 |
| Plotësimi i kushteve të kërkuara me infrastrukturë, pajisje dhe mjete në institucionet e arsimit parauniversitar | 24.22 |

***Tab.24.*** *Infrastruktura arsimore*

Të dhënat tregojnë se komunat duhet të angazhohen në sigurimin e masave të efiqiencës në institucionet shkollor, pastaj ofrimit të sigurisë në shkola efiqiences, por edhe plotësimit të kushteve me infrastrukturë, pajisje dhe mjete mësimore.

Tregues të tjerë të kësaj fushe janë si në vijim:

| Treguesit | % |
|---|---|
| Niveli i pajtueshmërisë me raportin e synuar nxënës për mësimdhënës | 54.72 |

***Tab.25.*** *Vijueshmëria dhe rezultatet e shkollimit parauniversitar*

Sipas të dhënave, braktisja e shkollës nga nxënësit, ku paraqitet shkalla inverse ka shënuar vlerën në 83.49%, Ndërsa shkalla e realizimit te orëve te planifikuara sipas kalendarit vjetor te arsimit është përmbushur 63.95%. Kalueshmëria ne testin e maturës kombëtare ka vlerën 67.25%. Fëmijë që vijojnë kopshtet ne zona rurale dhe urbane 24.37, kjo mbetet e ulet edhe përkundër përpjekjeve nga komunat.

| Treguesit | % |
|---|---|
| Fëmijë që vijojnë kopshtin | 24.37 |
| Mesatarja në rezultatet e testit të arritshmërisë për klasat e 9-ta | 50.03 |
| Kalueshmëria në maturën kombëtare për klasat 12 -të (ndarja sipas gjinisë) | 67.25 |
| Braktisja e shkollës nga nxënësit (shkalla inverse) | 83.49 |
| Shkalla e realizimit të orëve të planifikuara sipas kalendarit vjetor të arsimit | 63.95 |

| Treguesit | % |
|---|---|
| Trajtimi i kërkesave për vlerësimin pedagogjik të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore nga komisioni i DKA | 74.72 |
| Shkalla e sigurimit të mbështetjes me pedagog - asistent ndihmës për fëmijët / nxënësit me nevoja të veçanta në klasat e rregullta | 54.84 |

Sa i përket të dhënave krahasimore të përgjithshme për komuna, në vijim është paraqitur figura me të arriturat e kësaj fushe:




***Fig.17.*** *Krahasimet sipas komunave në fushën e arsimit parauniversitar*

## Fusha 15 – Kujdesi primar shëndetësor

Kjo fushë matë infrastrukturën dhe hapësirat e destinuara për shëndetësinë primare, resurset dhe personelin e mjaftueshëm, si dhe ofrimin e shërbimeve nga niveli komunal. Sipas të dhënave të raportuara nga komunave, kjo fushë ka nivel të ulët të performancës në përgjithësi, apo 60.55%. Në vijim është paraqitur figura me % e performancës sipas treguesve në këtë fushë:

| Treguesit | % |
|---|---|
| Njësitë e shëndetësisë primare me pajisje dhe shërbime laboratorike sipas udhëzimit administrativ | 63.64 |
| Niveli i pajtueshmërisë me ekipet e mjekësisë familjare dhe shëndetit oral | 32.55 |
| Fëmijë të përfshirë në program të imunizimit | 83.43 |
| Ofrimi i kujdesit shëndetësor specifik për gra dhe fëmijë | 87.50 |

**Tab.26.** *% e treguesve në fushën e shëndetësisë primare*

Pasqyra e mësipërme e të dhënave tregon se gjithsej përfshirja e fëmijëve në programin e imunizimit është arritur në shkallën prej 83.43%. Gjithashtu, ofrimi i kujdesit shëndetësor specialistik për gra e fëmijë është përmbushur në 87.50%.

Në vijim është paraqitur performanca e fushës përqindje për secilën nga komunat e Kosovës:




***Fig.18.*** *Krahasimet sipas komunave në fushën e shëndetësisë primare*

## Fusha 16 – Zhvillimi Ekonomik Lokal

Kjo fushë mate aktivitetet e planifikuara dhe të zbatuara për zhvillimin e aktivitetit ekonomik në nivel lokal duke mobilizuar pronat komunale, dhe përditësim i rregullt i regjistrit të tatimpaguesve si dhe shkallë e lartë e inkasimit e tatimit në prone. Kjo fushë ka performancën e përgjithshme prej 43.66%, në vitin 2024.

| Treguesit | % |
|---|---|
| Strategjia për zhvillim ekonomik lokal | 55.65 |

| | |
|---|---|
| Përgatitja dhe publikimi i listës së pronave komunale të planifikuar për dhënie në shfrytëzim | 76.56 |
| Niveli i azhurnimit të regjistrit të tatimit në pronë | 31.78 |
| Niveli i mbledhjes së faturës së tatimit në pronë (pa borxhe, interesa, ndëshkime) | 10.64 |

**Tab.27.** *% e treguesve në fushën e zhvillimit ekonomik lokal*

Fusha e Zhvillimit Ekonomik Lokal është prezantuar nga 4 tregues ne grafikun me lartë. Plani per zhvillim ekonomik lokal është përmbushur nga komunat 55.65%. Kurse niveli i mbledhjes se faturës se tatimit ne prone pa borxhe interes dhe ndëshkime është përmbushur në 10.64%, Përgatitja dhe publikimi i listës se pronave komunale ne shfrytëzim është përmbushur ne 76.56%, Kurse niveli i azhurnimit te regjistrit te tatimit ne prone është përmbushur ne 31.78%.




***Fig.19.** Krahasimet sipas komunave në fushën e zhvillimit ekonomik lokal*

Sipas figurës së mësipërme vërejmë se mbi mesataren e vendit për vitin 2024 janë 14 komuna, kurse nën mesatare janë 15 komuna. Komuna e Ferizajit ka arritur rezultatin më të lartë prej 90.72% të treguesve për këtë fushë, renditet e dyta komuna e Lipjanit me 86.21%. Kurse e fundit ne realizimin e treguesve mbetet komuna e Graçanicës.

## Konkluzione dhe rekomandime

Një nga prioritetet kryesore nga ky raport është forcimi i sistemit të raportimit dhe verifikimit të të dhënave në Sistemin e Menaxhimit të Performancës Komunale (SMPK). Për këtë arsye, rekomandohet që Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal të organizojë trajnime shtesë për koordinatorët, zyrtarë komunalë të performancës dhe nje administrim më efikas nga drejtoritë komunule, me qëllim që të sigurohet një kuptim i plotë i procedurave të raportimit dhe shmangies së të dhënave të pavlefshme. Po ashtu, është e nevojshme të hartohen udhëzime të standardizuara për dokumentimin e të dhënave dhe të krijohen mekanizma për konsultime paraprake me komunat, në mënyrë që të garantohet cilësia e raportimit para finalizimit të rezultateve. Një tjetër element thelbësor është nxitja e qeverisjes së mirë. Komunat duhet të angazhohen në zbatimin e plotë të standardeve minimale të konsultimit publik, duke mundësuar pjesëmarrjen aktive të qytetarëve në vendimmarrje. Përfshirja më e gjerë e qytetarëve në proceset buxhetore dhe në hartimin e planeve zhvillimore do të kontribuojë drejtpërdrejt në forcimin e llogaridhënies dhe transparencës.
Përveç kësaj, rekomandohet që komunat të rrisin efikasitetin në përdorimin e fondeve publike. Ky qëllim mund të arrihet duke fokusuar investimet në projekte kapitale që adresojnë boshllëqet më të theksuara strukturore, si transporti publik, infrastruktura rrugore apo ndërtimi i çerdheve dhe shkollave të reja. Njëkohësisht, duhet përmirësuar zbatimi i planit të prokurimit dhe mbikëqyrja e kontratave për të siguruar që fondet publike përdoren në mënyrë transparente dhe efektive.

Vlerësimi i performancës komunale për vitin 2024 nxjerr të gjetura të shumta për 16 fusha të kompetencave komunale. Përfundimet e këtij raporti theksojnë një numër të madh të çështjeve, të cilat duhet të merren parasysh dhe trajtohen me prioritet nga organet e pushtetit lokal:

Në fushën e ***shërbimeve publike administrative***, rekomandohet që komunat të zgjerojnë më tej ofrimin e shërbimeve elektronike për qytetarët, duke i bërë ato të qasshme në mënyrë online. Thjeshtimi i procedurave administrative mbetet një domosdoshmëri për të zvogëluar barrën burokratike, ndërsa vendosja e standardeve të njëjta për kohën e trajtimit të kërkesave do të sigurojë një qasje më të barabartë dhe efikase në të gjitha komunat.

Në fushën e ***transparencës komunale***, është e domosdoshme të sigurohet publikimi i të gjitha dokumenteve kryesore si buxhetet, planet komunale dhe vendimet e kuvendit, në format të hapur dhe të lehtë për t'u lexuar nga qytetarët. Transmetimi online i seancave të kuvendeve komunale duhet të bëhet praktikë e detyrueshme, ndërsa raportet periodike mbi proceset e konsultimeve publike duhet të publikohen rregullisht, duke dëshmuar ndikimin e qytetarëve në vendimmarrje.

Sa i përket ***përgjegjshmërisë komunale***, rekomandohet rritja e përqindjes së qytetarëve që marrin pjesë në konsultimet publike, në përputhje me standardin e SMPK-së. Funksionalizimi i këshillave lokalë duhet të trajtohet si prioritet, pasi ato janë mekanizma të rëndësishëm të demokracisë vendore. Gjithashtu, komunat duhet të përmirësojnë nivelin e adresimit të rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit, i cili aktualisht mbetet i ulët. Monitorimi i pagesave brenda afateve ligjore është gjithashtu i nevojshëm për të shmangur vonesat dhe për të rritur efikasitetin financiar.

Në fushën e ***barazisë në punësim dhe shërbimeve sociale***, është e nevojshme që komunat të zbatojnë realisht kuotat për punësimin e personave me aftësi të kufizuara dhe të sigurojnë mbështetje për komunitetet joshumicë. Investimet në banimin social dhe përkujdesja për familjet në nevojë duhet të forcohen, ndërsa fëmijët që kanë nevojë për strehim duhet të kenë mbështetje të garantuar përmes programeve të dedikuara.

Fusha e ***kulturës, rinisë dhe sportit*** ka treguar rezultate të mira, por rekomandohet që komunat të sigurojnë financim të qëndrueshëm për organizatat kulturore lokale dhe të nxisin partneritete me

sektorin privat për të përmirësuar ofertën e aktiviteteve kulturore dhe sportive. Për më tepër, duhet të krijohen hapësira të reja sportive dhe kulturore, duke iu dhënë prioritet zonave që kanë mungesa të theksuara.

Në fushën e ***menaxhimit të fatkeqësive***, komunat duhet të hartojnë dhe zbatojnë plane të mirëfillta për reagim emergjent, pasi aktualisht niveli i realizimit mbetet i ulët. Trajnimet për stafin komunal mbi menaxhimin e rreziqeve dhe fuqizimi i koordinimit ndërkomunal për ndërhyrje të shpejta janë hapa të domosdoshëm për të rritur sigurinë e qytetarëve.

Sa i përket ***planifikimit hapësinor***, rekomandohet rritja e mbulimit të territorit të komunave me plane rregulluese të hollësishme, pasi kjo ndikon drejtpërdrejt në zhvillimin urban dhe rural të qëndrueshëm. Kontrolli i rreptë i ndërtimeve të reja për respektimin e lejeve ndërtimore duhet të jetë prioritet, ndërsa integrimi i planifikimit hapësinor me strategjitë e zhvillimit ekonomik lokal do të sigurojë zhvillim të balancuar.

Në fushën e ***hapësirave publike***, komunat duhet të punojnë në rritjen e sipërfaqeve të gjelbra për kokë banori dhe të sigurojnë mirëmbajtje të rregullt të parqeve dhe ndriçimit publik. Investimet në hapësira rekreative dhe shëtitore janë të rëndësishme për të rritur cilësinë e jetesës së qytetarëve, sidomos në zonat urbane të mbipopulluara.

Sa i përket ***infrastrukturës rrugore***, rekomandohet orientimi i investimeve drejt ndërtimit të trotuareve, shtigjeve për biçikleta dhe përmirësimit të ndriçimit publik, që aktualisht mbeten të mangëta. Riasfaltimi i rregullt i rrugëve lokale dhe mirëmbajtja e tyre gjatë stinëve janë po ashtu të domosdoshme. Një fokus i veçantë duhet të jetë vendosja e shenjëzimit horizontal dhe vertikal në të gjitha rrugët lokale për të rritur sigurinë në trafik.

Në fushën e ***transportit publik***, komunat duhet të hartojnë dhe zbatojnë plane të mobilitetit lokal, të zgjerojnë rrjetin e transportit publik për të përfshirë më shumë vendbanime dhe të vendosin infrastrukturë të përshtatshme për stacionet dhe ndalesat e transportit. Kjo do të përmirësonte ndjeshëm qasjen e qytetarëve në shërbimet komunale dhe do të ndikonte në uljen e trafikut privat.

Në fushën e ***shërbimeve publike***, përfshirë ujin, kanalizimin dhe menaxhimin e mbeturinave, komunat duhet të përfundojnë projektet e ujësjellësit dhe kanalizimit, sidomos në zonat rurale. Përmirësimi i sistemit të inkasimit të pagesave për shërbimin e mbeturinave dhe përdorimi i teknologjive moderne për riciklim dhe menaxhim të qëndrueshëm të tyre janë hapa që duhet të ndërmerren në të ardhmen.

Në fushën e ***mbrojtjes së mjedisit***, rekomandohet hartimi dhe zbatimi i planeve lokale për mjedisin, pasi aktualisht ato janë realizuar vetëm në një shkallë shumë të ulët. Monitorimi i vazhdueshëm i ndërtimeve për respektimin e lejeve mjedisore duhet të forcohet, ndërsa ndërgjegjësimi i qytetarëve për rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit është thelbësor për zhvillimin e qëndrueshëm.

Sa i përket ***përfaqësimit gjinor***, komunat duhet të rrisin numrin e grave në pozita vendimmarrëse në administratë dhe të mbështesin programet që promovojnë barazinë gjinore në nivel lokal. Fushatat vetëdijësuese për rolin e grave në politikën vendore janë të domosdoshme për të rritur përfshirjen e tyre aktive.

Në fushën e ***arsimit parauniversitar***, rekomandohet zgjerimi i rrjetit të çerdheve dhe shkollave, sidomos në zonat rurale, për të siguruar qasje më të barabartë në arsim. Përmirësimi i kushteve teknike dhe higjienike në shkolla, digjitalizimi i tyre dhe pajisja me mjete bashkëkohore mësimore janë investime që duhet të jenë prioritet. Një fokus i veçantë duhet të jetë reduktimi i mbingarkesës në klasa, që mund të arrihet përmes ndërtimit të objekteve të reja shkollore.

Në fushën e ***kujdesit parësor shëndetësor***, komunat duhet të investojnë në ngritjen e kapaciteteve për ofrimin e shërbimeve shëndetësore, përfshirë ndërtimin e qendrave të reja të mjekësisë familjare dhe furnizimin me pajisje moderne. Rritja e numrit të personelit shëndetësor në nivel komunal është e domosdoshme, ndërsa duhet të hartohen plane të veçanta për ofrimin e kujdesit shëndetësor në zonat rurale dhe më pak të zhvilluara.

Në fund, në ***fushën e zhvillimit ekonomik lokal***, rekomandohet hartimi i strategjive të qarta për të tërhequr investime private, krijimi i zonave ekonomike dhe mbështetja për ndërmarrjet e vogla e të mesme. Përfshirja e komunave në projekte të partneritetit publik-privat do të mundësonte zhvillim më të qëndrueshëm ekonomik dhe krijimin e vendeve të reja të punës.

**Shtojcë:** *% e treguesve sipas fushave*

| Fushat | Treguesit | % | % |
|---|---|---|---|
| **Fusha 1:**<br><br>Shërbimet publike administrative | Kërkesat administrative të shqyrtuara gjatë vitit | 96.85 | 87.85 |
| | Kërkesat administrative të shqyrtuara brenda afateve ligjore | 92.43 | |
| | Shërbimet administrative të ofruara në mënyrë elektronike nga komuna | 83.03 | |
| | Shërbimet administrative të thjeshtuara për zvoglimin e barrës administrative në nivel komunal | 79.09 | |
| **Fusha 2:**<br><br>Transparenca komunale | **Treguesit** | % | % |
| | Mbledhjet e kuvendit të bëra publike dhe transmetuara drejtpërdrejtë online | 93.75 | 84.82 |
| | Niveli i qasjes në dokumente publike nga qytetarët | 94.52 | |
| | Përmbushja e kritereve të faqes zyrtare elektronike të komunës | 93.94 | |
| | Publikimi i akteve të miratuara në kuvendin komunal në faqen zyrtare të komunës | 93.54 | |
| | Publikimi i akteve me karakter të përgjithshëm, të miratuara nga kryetari i komunës, në faqen zyrtare të komunës | 89.80 | |
| | Publikimi i dokumenteve për planifikim dhe shpenzim të buxhetit | 89.70 | |
| | Publikimi i dokumenteve të prokurimit publik të komunës | 75.38 | |
| **Fusha 3:**<br><br>Përgjegjshmëria komunale | **Treguesit** | % | % |
| | Publikimi i njoftimeve për mbajtjen e 2 takimeve publike | 93.75 | 71.33 |
| | Pjesëmarrja e qytetarëve në konsultime publike | 28.75 | |
| | Adresimi i kërkesave të qytetarëve në takimet për buxhet | 78.61 | |
| | Aktet komunale dhe dokumentet e politikave lokale të konsultuara me publikun | 49.60 | |
| | Dëgjime publike për KAB, buxhet komunal dhe buxhetimi me pjesëmarrje | 76.59 | |
| | Publikimi i raporteve për procese të konsultimeve publike | 46.48 | |
| | Funksionimi i këshillave lokal | 38.61 | |
| | Miratimi me kohë i propozim buxhetit vjetor komunal | 77.50 | |
| | Diskutime për raportet tre-mujore buxhetore nga Kuvendi Komunal | 73.59 | |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | Diskutim për raportin e performancës komunale nga kuvendi komunal për vitin paraprak | 53.13 | |
| | Diskutimi i raportit të auditorit të jashtëm dhe planit të veprimit për adresim të rekomandimeve në Kuvendin Komunale | 68.75 | |
| | Mbledhjet e Kuvendit Komunal me pjesëmarrje të kryetarit të komunës | 58.46 | |
| | Niveli i zbatimit të planit të prokurimit | 78.78 | |
| | Niveli i pagesave të procesuara brenda afatit ligjor prej 30 ditëve | 76.00 | |
| | Niveli i adresimit të rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit | 34.86 | |
| | Raportimi i planit vjetor të planit të integritetit ne kuvendin komunal | 43.75 | |
| | Pezullimi i zyrtarëve komunal në raport me akt-akuzat e ngritura ndaj tyre | 96.88 | |
| | Përgatitja e planit për zhvillimin e personelit | 97.91 | |
| **Fusha 4:** Barazia në Punësim, Shërbime Sociale dhe Familjare | **Treguesit** | % | % |
| | Të punësuar me nevoja të veçanta në institucione komunale | 34.57 | 58.11 |
| | Zyrtarë Publik të punësuar nga komunitetet jo shumicë në institucionet komunale | 66.56 | |
| | Familje me nevojë të cilave iu është siguruar banimi social | 65.44 | |
| | Fëmijë me nevojë për strehim që iu është siguruar strehimi | 70.57 | |
| | Programi trevjeçar komunal i banimit social | 60.94 | |
| **Fusha 5:** Kulturë, Rini dhe Sport | **Treguesit** | % | % |
| | Hapësira për aktivitete të sportit për numër të banorëve | 90.03 | 93.39 |
| | Aktivitete të kulturës, rinisë dhe sportit të organizuara me buxhet komunal | 96.75 | |
| **Fusha 6:** Menaxhimi i fatkeqësive | **Treguesit** | % | % |
| | Niveli i realizimit të planit komunal për Reagim Emergjent | 15.00 | 54.21 |
| | Intervenimet për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera | 93.41 | |
| **Fusha 7:** Planifikimi Hapësinor | **Treguesit** | % | % |
| | Territori i komunës i rregulluar sipas planeve hapësinore komununale | 48.99 | 61.88 |
| | Kërkesa të shqyrtuara për leje të ndërtimit | 84.16 | |
| | Objekte të inspektuara me leje të ndërtimit | 81.71 | |
| **Fusha 8:** | **Treguesit** | % | % |

| | | | |
|---|---|---|---|
| Hapësirat Publike | Sipërfaqja e hapësirave të gjelbra publike në m² për kokë banori | 48.99 | 71.62 |
| | Sipërfaqja e hapësirave publike që mirëmbahen rregullisht | 84.16 | |
| | Hapësirat publike të pajisura me ndriçim publik | 81.71 | |
| **Fusha 9:** Infrastruktura Rrugore | **Treguesit** | % | % |
| | Rrugët lokale të mirëmbajtura gjatë sezonës së verës | 66.45 | 57.08 |
| | Rrugët lokale të mirëmbajtura gjatë sezonës së dimrit | 73.13 | |
| | Gjatësia e rrugëve lokale të pajisura me trotuare | 28.96 | |
| | Gjatësia e rrugëve lokale të pajisura me ndriçim publik | 60.03 | |
| | Gjatësia e rrugëve lokale të pajisura me shenjëzim vertikal dhe horizontal | 64.54 | |
| | Rrugët me shteg të biçikletave | 17.60 | |
| | Rrugë lokale të riasfaltuara | 50.69 | |
| **Fusha 10:** Transporti Publik | **Treguesit** | % | % |
| | Realizimi i planit komunal për transport lokal publik (planit të mobilitetit) | 29.21 | 43.10 |
| | Vendbanimet e përfshira në transportin lokal publik | 31.34 | |
| | Vendndalimet e shënjëzuara për automjetet e transportit publik | 68.76 | |
| **Fusha 11:** Shërbime Publike | **Treguesit** | % | % |
| | Realizimi i Planit për investime kapitale në sistemin e ujësjellësit | 82.03 | 90.60 |
| | Realizimi i Panit për investime kapitale në sistemin e kanalizimit | 92.26 | |
| | Realizimi i planit komunal për menaxhimin e mbeturinave | 90.03 | |
| | Realizimi i orarit për mbledhjen e mbeturinave | 99.78 | |
| | Inkasimi i mjeteve për mbledhjen e mbeturinave | 88.92 | |
| **Fusha 12:** Mbrojtja e Mjedisit | **Treguesit** | % | % |
| | Realizimi i Planit Lokal të Veprimit në Mjedis | 13.51 | 63.69 |
| | Lejet mjedisore komunale të lëshuara | 90.33 | |
| | Ndërtesat e reja që e kanë zbatuar lejen mjedisore komunale | 87.23 | |
| **Fusha 13:** Përfaqësimi Gjinor | **Treguesit** | % | % |
| | Gratë e punësuara në institucione/administratën komunale | 86.48 | 49.77 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | Gratë në pozita udhëheqëse në institucionet arsimore, shëndetësore e kulturore/sportive | 35.86 | |
| | Gratë e emëruara në pozita politike në komunë | 59.84 | |
| | Barazia gjinore tek anëtarët e komiteteve komunale | 96.88 | |
| | Barazia gjinore tek përbërja e këshillave lokale | 15.31 | |
| | Buxhetimi dhe shpenzimi i përgjegjshëm gjinor | 87.50 | |
| | Barazia gjinore në buxhetim për punësim dhe ndërmarrësi të grave | 60.04 | |
| | Pjesëmarrja e grave në konsultime publike | 62.49 | |
| | Realizimi i planit komunal për barazi gjinore | 69.75 | |
| | Përfaqësimi gjinor tek emërtimet e rrugëve | 13.32 | |
| | Regjistrimi i pronësisë në emër të dy gjinive | 27.64 | |
| **Fusha 14:** Arsimi parauniversitar | **Treguesit** | % | % |
| | Shkolla me masa të efiçencë së energjisë | 41.91 | 56.33 |
| | Siguria në institucionet e arsimit parauniversitar | 77.91 | |
| | Plotësimi i kushteve të kërkuara me infrastrukturë, pajisje dhe mjete në institucionet e arsimit parauniversitar | 24.22 | |
| | Niveli i pajtueshmërisë me raportin e synuar nxënës për mësimdhënës | 54.72 | |
| | Fëmijë që vijojnë kopshtin | 24.37 | |
| | Mesatarja në rezultatet e testit të arritshmërisë për klasat e 9-ta | 50.03 | |
| | Kalueshmëria në maturën kombëtare për klasat 12 -të (ndarja sipas gjinisë) | 67.25 | |
| | Braktisja e shkollës nga nxënësit (shkalla inverse) | 83.49 | |
| | Shkalla e realizimit të orëve të planifikuara sipas kalendarit vjetor të arsimit | 63.95 | |
| | Trajtimi i kërkesave për vlerësimin pedagogjik të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore nga komisioni i DKA | 74.72 | |
| | Shkalla e sigurimit të mbështetjes me pedagog - asistent ndihmës për fëmijët / nxënësit me nevoja të veçanta në klasat e rregullta | 54.84 | |
| **Fusha 15:** | **Treguesit** | % | % |

| | | | |
|---|---|---|---|
| Fusha 15 – Kujdesi primar shëndetësor | Njësitë e shëndetësisë primare me pajisje dhe shërbime laboratorike sipas udhëzimit administrativ | 63.64 | 60.55 |
| | Niveli i pajtueshmërisë me ekipet e mjekësisë familjare dhe shëndetit oral | 32.55 | |
| | Fëmijë të përfshirë në program të imunizimit | 83.43 | |
| | Ofrimi i kujdesit shëndetësor specifik për gra dhe fëmijë | 87.50 | |
| **Fusha 16:**<br><br>Zhvillimi Ekonomik Lokal | **Treguesit** | % | % |
| | Strategjia për zhvillim ekonomik lokal | 55.65 | 43.66 |
| | Përgatitja dhe publikimi i listës së pronave komunale të planifikuar për dhënie në shfrytëzim | 76.56 | |
| | Niveli i azhurnimit të regjistrit të tatimit në pronë | 31.78 | |
| | Niveli i mbledhjes së faturës së tatimit në pronë (pa borxhe, interesa, ndëshkime) | 10.64 | |